In Albanian, *llahtari* (noun) and *i / e llahtarisur* (adjective) mean *great fear, dreadful, tremendous, terrifying*. While Lasgush gives us another use: as a noun meaning *λαχτάρα*, same as in Greek, *great desire, craving, yearning*, and the adjective with the same meaning. Furthermore, he coins the verb *llaftaronj* (*λαχταρώ*), that does not exist in Albanian.

2. It is also impressive that Georgios Drosinis (1859 – 1951) was part of Lasgush’s

readings. There are two poems of Drosinis that Lasgush used as an inspiration (and / or translated). The first one is “Vasha me drapër” (“The girl with the sickle”), and second one is “Vesa dhe loti” (“The dew and the tear”). The original text of Drosinis goes:

Φύσα, ἀγεράκι τῆς ἀγῆς,
Κ’ ἔλα νὰ μὲ δροσίης,
Καὶ σὺ, Ἥλιε, ἀπ’ τὸ βουνὸ μὴ βγῆς,
Γιατὶ θὰ μὲ μαυρίσης.

Τὰ στάχυα γέρνουνε βαριά,
Δρεπάνι καρτεροῦνε,
Μπῆκαν στὸ θέρος τὰ χωριά,
Τ’ ἀλώνια ἀνθοβολοῦνε.

Κι’ ἄν εἶμαι κόρη ζηλευτή,
Τὸν ἀργαλειὸ θ’ ἀφήσω.
Ἔχω πατέρα δουλευτῆ,
Καὶ πάω γιὰ νὰ θερίσω.

Μ’ ἓνα δρεπάνι κοφτερὸ
Θερίζω τὰ σιτάρια,
Μὲ μιὰ ματιὰ μου στὸ χορὸ
Θερίζω παλικάρια!⁹⁹

While Lasgush goes:

Vasha me drapër¹⁰⁰

Fryn er’ e bukur në mëngjes,
Sikur vesohet qjelli,
Un’ ika shelgjeve përmes,
Mos të më zërë dielli.

⁹⁹ ΔΡΟΣΙΝΗ, Γ. (1997), Αμαρυλλίς, in: Απαντα, τόμος τέταρτος, Αθήναι 1997, pp. 341-342.

¹⁰⁰ PORADECI, L., (2010) Vepra 1, fq. 241.

Sepse po thyen gjer përdhe
 Kallinj zërmërë-plotë,
 Rëndon korriku dhe nëdr ne
 Me drith-e afsh të ngrohtë

Jam vash-e rritur në shtëpi,
 Me vegël me shigjetë,
 po kam t'im-at në varfëri
 dhe dal të korr dhe vetë.

Kur bje kallinjve drapri im,
 Qit zjarr si vetëtimat;
 Kur syri im shtje një vështrim,
 Godet në zemër trimat.

On the manuscript page of this poem Lasgush recognizes the authorship and gives the reference of the book: “Created based on the Greek [text] of Georgios Drosynis by Lasgush Poradeci. August 17th, 1930.”

The same attribution appears on the next poem, “The dew and the tear”:

Εἶπ' ἡ δροσιά στὸ δάκρυ γεμάτη περηφάνεια:
 - Στὴ γῆ παραρριγμένο ἢ μοῖρα σ' ἔχει φέρη!
 Δὲ μοιάζεις σὺ μ' ἐμένα, τὴν κόρη τὴν οὐράνια,
 Τὴν ἀδελφὴ τοῦ ἀνέμου, τῶν λουλουδιῶν τὸ ταῖρι.

Κ' εἶπε τὸ δάκρυ: - Ἀλήθεια! γεννιέμαι ἀπὸ τὸν πόνο
 Καὶ βγαίνω ἀπ' τῶν ἀνθρώπων τὸ μάτι τὸ κλαμένο.
 ἐσὺ ἀπ' τ' οὐράνια στὴ γῆ σταλάζεις μόνο –
 ἐγὼ ἀπ' τῆ γῆ ἐδῶ κάτω στὸν οὐρανὸ πηγαίνω!¹⁰¹

In the version of Lasgush (where the artistic changes of Lasgush have been written in italics):

¹⁰¹ ΔΡΟΣΙΝΗ, Γ. (1997), Ἀμαρυλλίς, in: Ἄπαντα, τόμος τέταρτος, Ἀθήναι 1997, p. 365.

Vesa dhe loti¹⁰²

I mburrej vesa lotit *më një të shkrepur djelli*:
 Përdhe ndaj *baltësirës* ty fati i zi të flaku;
 S'më shëmbëllen ti mua që jam një bijë qjelli'
 Që jam e motr' e erës dhe shoqe e çdo *zambaku*.

Dhe loti tha: Vërteta! më lindi dhëmbj' e zezë,
 Dhe dal nga syr' i vuar i *zembrës* njerzore:
 Po kur se ti prej qjellit pikon vetëm përdhezë,
 Un' ik nga balt' e rëndë drejt *kaltërsish* qjellore.

Where does mere translation differ from original creation? This is a wide discussion. My goal is not to show if Lasgush has borrowed or translated the poems, but to give an example of literary influence from Greek into Albanian.

3. “Kamadeva”: the last poem of Lasgush

This third example is moderately complicated. It seems unclear when did Lasgush finished the poem “Kamadeva”. Luan Topçiu¹⁰³ gives us the year 1958, while Moikom Zeqo says that Lasgush took years to write the poem. In 1981 Zeqo published some fragments of “Kamadeva” in the periodical newspaper “Drita”. This poem is the longest and most complicated work of Lasgush. It could be described as a novel in verses, considering the length and the plot.

While translating the work *Serpent and Lily* of Nikos Kazantzakis into Albanian, it was impossible not to notice some similarities that we noticed between the prose of Kazantzakis and the poem “Kamadeva” of Lasgush. The table below shows the most important similarities between the two works.

¹⁰² PORADECI, L., (2010) Vepra 1, fq. 283.

¹⁰³ Topçiu, L., (2000), Tekstualizëm dhe stil (mbi poezinë e Lasgush Poradecit), pp. 36-37.

Table 1

Author	Nikos Kazantzakis	Lasgush Poradeci
Title of the work	<i>Serpent and Lilly</i>	“Kamadeva” (Kama, god of erotic love, desire and pleasure, son of Dharma or Brahma)
Name of the author	Karma Nirvami (pseudonym only in this book; strong declaration about)	Lasgush Poradeci (lifelong pseudonym)
Similarities		
Influences of eastern religion and philosophy	Deliberate use of Brahmanism and Buddhist cosmotheory in this book	Deliberate use of Brahmanism and Buddhist cosmotheory in most of his work
Protagonist	<i>The painter</i>	<i>The writing personae</i>
Deuteragonist	<i>The lover (Lilly)</i>	<i>The lover (Lilly)</i>
Linear narration	The protagonist recalls how he met the Lover → he invites her → the first meeting → they separate temporarily → they meet again → sexual intercourse → death prevails	The protagonist recalls how he met the Lover → he invites her → the first meeting → they separate temporarily → they meet again → sexual intercourse → final separation (death prevails)
Keywords in both works	Lily	Lily
	Demon that envies love / life	Kamadeva, demon that envies love / life
	the shadow of death hovers about	the shadow of death hovers about
	<i>λαχταρώ / λαχτάρα</i> (craving, feverish desire)	llaftari / llaftarë (craving, feverish desire)
	strong sexual desire	Kamadeva (the Indian cupid, god of erotic love)
	violet (flower, the hidden, timid desire)	violet (flower, the hidden, timid desire)
	lovers bend over each other (in continuity)	lovers bend over each other (in continuity)
	elements of byzantine liturgy and hymnology	elements of byzantine hymnology
Differences		
Style	Psychological prose	Metric poetry
Origin / inspiration	Not known (Influenced by R. M. Rielke and Gabriele d’Annunzio)	Inspiration from Dante (probably from <i>Vita Nuova</i> , where Dante meets Beatrice, separates, meets her again, for the last time, before her death)

In conclusion, what is cultural influence, translation, borrowing, inspiration, recycling of ideas? Difficult to say. I would not dare to judge if in the case of Drosinis there is a translation or a new poetic work. What is important, in the context of the Greek-Albanian relations and exchanges, is the continuous communication between Greek and Albanian communities, cultures, languages. That is why this conference and the new collaboration between the Faculty of Foreign Languages, University of Tirana, and the Faculty of Translation and Interpretation of the Ionian University are an important step, a higher step of communication and bilateral influences, to the possible extent.

BIBLIOGRAPHY

1. Poradeci, Lasgush: *Vepra 1*, Tiranë 2010.
2. Topçiu, Luan: *Tekstualizëm dhe stil (mbi poezinë e Lasgush Poradecit)*, Tiranë, 2000.
3. Δροσίνη, Γεωργίου: Άμαρυλλίς, στο: *Άπαντα*, τόμος τέταρτος, Αθήναι 1997.

PROF. ASOC. DR. ALMA PINARI & MSC. (PHDS) ELVIRA XHAMANI
DEGA E GJUHËS RUSE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
UNIVERSITETI I TIRANËS
alma.pinari@unitir.edu.al & elvira.xhamani@unitir.edu.al

**INTERPRETIMI I NJË VEPRE ARTISTIKE NË GJUHË TË HUAJ,
SI NJË MJET FORMIMI I KOMPETENCËS NDËRKULTURORE
NË STUDIMIN E ASAJ GJUHE TË HUAJ**

ABSTRAKT

Në këtë kumtesë do të trajtohet interpretimi i një teksti letrar si një mjet për formimin e kompetencës ndërkulturore. Do të merren në analizë punime shkencore të gjuhëtarëve të ndryshëm të huaj dhe të vendit, por edhe të filozofëve të huaj, të cilët gjithashtu i kanë kushtuar vëmendje të mjaftueshme edukimit të individit përmes letërsisë artistike. Si rezultat i analizës, del se një nga detyrat më të rëndësishme socio-pedagogjike është formimi i shkrim-leximit ndërkulturor të studentëve, i cili mund të realizohet përmes studimit dhe interpretimit të teksteve letrare. Ky punim merr një rëndësi të veçantë për faktin se kohët e fundit, gjithnjë e më shumë po konsiderohet si domosdoshmëri dhe si çështje akute edukimi i një specialisti që do të jetë në gjendje të mendojë globalisht, të kuptojë veten dhe të perceptojë në mënyrë adekuate një kulturë të huaj. Meqenëse integrimi i një kulture të gjuhës së huaj në një tjetër tashmë po merr përmasa globale dhe në një periudhë shumë të shkurtër kohore, kjo qasje është shumë e rëndësishme në studimin e gjuhëve të huaja për të krijuar një dialog kompetent të kulturave dhe komunikimit ndërkulturor.

Fjalë kyçe: *interpretim, kompetencë ndërkulturore, detyre socio-pedagogjike, identifikimi, reflektimi.*

INTERPRETATION OF A LITERARY WORK INTO A FOREIGN LANGUAGE AS A MEANS OF FORMING INTERCULTURAL COMPETENCE IN LEARNING THIS FOREIGN LANGUAGE

ABSTRACT

In this paper, the interpretation of a literary text as a tool for the formation of intercultural competence will be addressed. Scientific works of various foreign and local linguists, but also of foreign philosophers, who have also paid sufficient attention to the education of the individual through artistic literature, will be analysed.

As a result of the analysis, it appears that one of the most important socio-pedagogical tasks is the formation of students' intercultural literacy, which can be recreated through the study and interpretation of literary texts. This paper takes on a special importance, due to the fact that recently, it is increasingly being considered as a necessity and as an acute issue to educate a specialist who will be able to think globally, understand himself and adequately perceive a foreign culture. Since the integration of one foreign language culture into another is already taking global proportions and in a very short period of time, this approach is very important in the study of foreign languages to create a competent dialogue of cultures and intercultural communication.

Keywords: *interpretation, intercultural competence, socio-pedagogical tasks, identification, reflection.*

Në botën moderne, me integrimin e një bashkësie kulturore në tjetri, çështja e dialogut të kulturave ndërmjet tyre po bëhet gjithnjë e më e mprehtë. Që ky dialog të zhvillohet sa më suksesshëm, është shumë e rëndësishme të kultivohet, toleranca ndaj një kulture dhe gjuhe të huaj. Praktika na tregon, që vetëm njohja e gjuhës së një populli tjetër, njohurit mbi traditat, zakonet dhe njohuritë mbi vendin janë të pa mjaftueshme, por është e nevojshme të perceptohet një kulturë gjuhësore e huaj në nivelin mendor në mënyrë që procesi i integritimit në një mjedis tjetër kulturor të zhvillohet plotësisht. Dihet se gjuha e çdo kombi është habitati natyror i kulturës së tij. Praktikisht të gjitha gjuhët e botës janë në kontakt të ngushtë me njëra-tjetrën, por në të njëjtën kohë ato përpiqen të ruajnë origjinalitetin e tyre. Është ky identitet që mbart veçoritë dalluese të vlerave kulturore të çdo populli. Tiparet dalluese të vlerave kulturore janë të përfaqësuara në shumë vepra arti,

përmes të cilave mund të kuptohen vlerat e vërteta shpirtërore të njerëzve dhe të vendit në tërësi. Falë shkrimtarëve të tillë si Nekrasovi, Lermontovi, Pushkini, Gogoli, Tolstoi, Çehovi dhe Dostoevski, e gjithë bota mësoi për realizmin dhe patriotizmin rus. Por jo gjithmonë leximi i teksteve letrare ndihmon për të kuptuar plotësisht një kulturë të huaj dhe për të kultivuar tolerancë. Kjo kërkon të kuptuarit dhe zbulimin e kuptimit kryesor të veprës. Në këtë drejtim, interpretimi i teksteve letrare është një komponent i rëndësishëm në formimin e kompetencës ndërkulturore. Mësimi i teknikave të interpretimit të një teksti letrar është hallka më e rëndësishme në formimin e kulturës së leximit, kulturës së përgjithshme të një personaliteti gjuhësor. Kur studion një gjuhë të huaj, interpretimi i një teksti letrar rezulton të jetë i lidhur me zgjidhjen e një sërë problemesh metodologjike: komunikimi i informacionit për vendin e gjuhës që studiohet, prezantimi i gjuhës mësimore dhe materialit të të folurit, zhvillimi i shijes estetike, etj. Gjuhëtari rus, Demjankov në artikullin e tij “Interpretimi gjuhësor i tekstit: strategjitë universale dhe kombëtare” vëren se në shoqërinë moderne fjala *interpretim* përdoret shpesh në të folurin e përditshëm dhe madje është bërë modë. **Shembulli që ai jep tregon se fjala *interpretim* ka një lloj konotacioni negativ.**¹⁰⁴ *Kjo nuk është një e vërtetë e padiskutueshme, është thjesht një interpretim.* “Duke iu qasur interpretimit jo vetëm si mjet, por edhe si objekt i filologjisë, kritika letrare, filozofia e gjuhës dhe gjuhësia fitojnë një gjuhë të përbashkët, interesa të përbashkëta dhe material të përbashkët kërkimor. Interpretimi në filologji përfshin dy aspekte: i pari: për të kuptuar veten dhe nga ana tjetër, për të shpjeguar dhe/ose vërtetuar këtë kuptim për të tjerët. K. A. Rogova, studiuesja e parë dhe specialistja kryesore në stilistikën e teksteve ruse, shprehet se “Interpretimi është zbulimi i kuptimit të tekstit. Procesi i interpretimit është i ndërlidhur dhe siguron komunikim dhe mirëkuptim”¹⁰⁵. Filozofi francez, një nga përfaqësuesit kryesorë të hermeneutikës filozofike, Paul Ricoeur, e lidh interpretimin me një vepër të veçantë të të menduarit, “që konsiston në deshifrimin e kuptimit pas kuptimit të dukshëm, në zbulimin e niveleve të kuptimit të përmbajtura në kuptimin e drejtpërdrejtë”. Kështu, mund të themi se interpretimi i një vepre artistike nuk është vetëm një proces teknik që të lejon të interpretosh fjalët e autorit dhe të zbulosh kuptimin, por është gjithashtu një aktivitet krijues i lexuesit, i cili varet nga niveli i tij intelektual.

Ne dëshirojmë t’i kushtojmë vëmendje përkufizimit të konceptit të produktit artistik, i cili jepet nga A. B. Jesin, duke thënë se një vepër letrare është një vepër artistike në kuptimin e ngushtë të fjalës, domethënë është një nga format

¹⁰⁴ Демьянков В. З., (2001), Лингвистическая интерпретация текста: Универсальные и национальные (идиоэтнические) стратегии // Язык и культура: Факты и ценности: К 70-летию Юрия Сергеевича Степанова / Отв. редакторы: Е. С. Кубрякова, Т. Е. Янко. Языки славянской культуры, – М., с. 5.

¹⁰⁵ Рогова К. А., (2002), Художественная речь русского зарубежья: 20-30-е годы XX в.: Учеб. пособие. Изд. С-Петербургского университета, С-Петербург, С. 326.

e ndërjegjes sociale¹⁰⁶. Si gjithë arti në përgjithësi, një vepër letrare është një shprehje e një përmbajtjeje të caktuar emocionale dhe mendore, një kompleks ideologjik dhe emocional në një formë figurative, estetikisht domethënëse. A. B. Jesin i referohet M. M. Bakhtin, sipas të cilit, një vepër arti është ajo që tha shkrintari, prandaj, “një fjalë për botën” është një akt reagimi i një personi të talentuar artistikisht ndaj realitetit përreth. V. N. Toporov, hapi konceptin e një vepre arti më gjerësisht në 1982. “Një vepër letrare është një formacion kompleks, shumëdimensional që lejon qasje të ndryshme në studimin e saj: nga pikëpamja e teorisë së tekstit, gjuhësisë së tekstit, hermeneutikës, poetikës dhe stilistikës.¹⁰⁷ **Në këtë drejtim, mund të themi se një tekst letrar kryen disa funksione, si:** *transmetimi i informacionit, ruajtja e informacionit dhe, siç thamë më lart, lexuesi i një teksti letrar është në bashkëkrijim me mesazhin e marrë përmes interpretimit dhe kuptimit të asaj që autori donte të thoshte. N. L. Galejeva vëren se një tekst që përmban parametrin e artit zgjon reflektimin, duke çuar në formimin e një hapësire të caktuar të të kuptuarit, ku reflektimi fiksohet në formën e vlerave shpirtërore - kuptimeve dhe ideve, të cilat, nga ana tjetër, janë në gjendje të pasurojnë hapësirën shpirtërore të një personi. Hapësira shpirtërore kuptohet si një tërësi paradigmash semantike, ideologjike, vlerash, ndjenjash, idesh, njohurish, konceptesh, besimi, dukurish të përgjithshme kulturore.¹⁰⁸ . Kështu, duke përdorur përkufizimin e dhënë nga N. L. Galejeva, mund të shqyrtojmë konceptin e ndërkulturës, pasi ky koncept është një nga përbërësit e fenomeneve të përgjithshme kulturore, i cili është një nga përbërësit e hapësirës shpirtërore të një personi. Koncepti i komunikimit ndërkulturor është një përkthim i drejtpërdrejtë nga anglishtja «Crossculture», e cila mund të përkthehet si “kryqëzimi i kulturave”. Në titujt e librave të huaj për komunikimet ndërkulturore, në një mënyrë apo tjetër, ka shprehje: “në prag të kulturave”, “në kryqëzimin e kulturave”, “përplasja e kulturave” etj. Kjo thekson natyrën problematike të komunikimit ndërkulturor, thekson dallimet, jo ngjashmëritë. Detyra e pedagogut është të sigurohet që këto dallime të mos irritojnë, por të ngjallin interes për studimin e një kulture të huaj për identifikimin e mëtejshëm të studentit dhe njohjen më të thellë të kulturës së tyre dhe identifikimin e saj me një gjuhë të huaj. Këtu lind pyetja për formimin e kompetencës ndërkulturore midis studentëve që studiojnë një gjuhë të huaj. Për të kuptuar se çfarë është kompetenca ndërkulturore, së pari do të shqyrtojmë konceptin e “kompetencës” dhe nga cilat komponentë përbëhet ajo. A.V. Hutorskoj ofron përkufizimin e mëposhtëm të “kompetencës”. Kompetenca - përfshin një grup cilësish të ndërlidhura të një personi (njohuri, aftësi, metoda të veprimtarisë), të vendosura në lidhje me një*

¹⁰⁶ Есин А. Б., (2000), Принципы и приемы анализа литературного произведения: Учеб. пособие. - 3-е изд.: Флинта, Наука, - М., с. 11.

¹⁰⁷ Топоров В. Н., (1995), Миф. Ритуал. Символ. Образ: Исследования в области мифопоэтического: Избранное. Издательская группа «Прогресс» - «Культура», - М., с. 259.

¹⁰⁸ Галеева Н.Л. (1999), Параметры художественного текста и перевод. Тверь, с.8-9

gamë të caktuar objektesh dhe procesesh dhe të nevojshme për një veprimtari prodhuese me cilësi të lartë në lidhje me to.¹⁰⁹

Në sistemin arsimor dhe shkencor, nismëtarët e studimit të komunikimit ndërkulturor janë mësuesit e gjuhëve të huaja, të cilët ishin të parët që kuptuan se për një komunikim efektiv me përfaqësuesit e kulturave të tjera nuk mjafton njohja e plotë e një gjuhe të huaj. Praktika e komunikimit me të huajt ka vërtetuar se edhe njohja e thellë e një gjuhe të huaj nuk përjashton keqkuptimet dhe konfliktet me folësit amtare të kësaj gjuhe. Prandaj, mësimi i gjuhëve të huaja përfshin njohjen e studentëve me historinë, zakonet, traditat, organizimin shoqëror të vendit të gjuhës që studiohet. Problemi i formimit të shkrim-leximit ndërkulturor të studentëve është një detyrë e rëndësishme socio-pedagogjike. Sot kërkohet një specialist që është në gjendje të mendojë globalisht, të kuptojë veten dhe të tjerët, të kuptojë kulturën jo vetëm të popullit të tij, por edhe të popujve të tjerë. Është e rëndësishme që studenti të zotërojë kulturën e dallimeve dhe mirëkuptimit, gjegjësisht shkrim-leximin ndërkulturor, që është baza e komunikimit dhe e marrëdhënieve ndëretnike në përgjithësi. Një gjuhë e huaj ka një potencial të pashtershëm për formimin e kompetencës ndërkulturore.

Shkencëtari amerikan R. Henvey dallon 4 nivele të shkrim-leximit ndërkulturor:

Niveli 1 - një person njihet me çuditë sipërfaqësore dhe të dukshme. Këto tipare bëhen stereotipe të zakonshme dhe perceptohen si diçka ekzotike.

Nivelet 2 dhe 3 - një person depërton në thelbin e veçorive të thella të kulturës, në kontrast me tonat. Por nëse në nivelin e dytë këto tipare irritojnë me absurditetin dhe pangjashmërinë e tyre, atëherë në nivelin e 3-të ato tashmë duken të justifikuar në mënyrën e tyre, deri diku racionale.

Vetëm në nivelin 4 është e mundur të perceptohet kultura përmes syve të bartësit të saj.

Interpretimi i veprave letrare ndihmon për të perceptuar në mënyrë adekuate informacionin semantik dhe vlerësues. Gjatë leximit të veprave të tilla, ndodh identifikimi, i cili ndihmon për të kuptuar një person tjetër duke u identifikuar me të, dhe përmes interpretimit të mëtejshëm të tekstit letrar, ndodh reflektimi, i cili ndihmon për të kuptuar tjetrin përmes arsytimit.

Të gjithë këta komponentë janë shumë të rëndësishëm për formimin e kompetencës ndërkulturore, e cila nuk çon në një “përplasje kulturash”, siç e interpretojnë këtë koncept disa autorë të huaj, por në një “kryqëzim kulturash” dhe dialogun e tyre kompetent.

¹⁰⁹ Хуторской А.В. (2002), Ключевые компетенции и образовательные стандарты: Доклад на отделении философии образования и теории педагогики РАО. Центр «Эйдос».

BIBLIOGRAFIA

1. Демьянков В. З., (2001), Лингвистическая интерпретация текста: Универсальные и национальные (идиоэтнические) стратегии // Язык и культура: Факты и ценности: К 70-летию Юрия Сергеевича Степанова / Отв. редакторы: Е. С. Кубрякова, Т. Е. Янко. Языки славянской культуры, – М., С. 323.
2. Рогова К. А., (2002), Художественная речь русского зарубежья: 20-30-е годы XX в.: Учеб. пособие. Изд. С-Петербургского университета, С-Петербург., С. 326.
3. Есин А. Б., (2000), Принципы и приемы анализа литературного произведения: Учеб. пособие. - 3-е изд.: Флинта, Наука, - М., С. 248.
4. Топоров В. Н., (1995), Миф. Ритуал. Символ. Образ: Исследования в области мифопоэтического: Избранное. Издательская группа «Прогресс» - «Культура», - М., С. 367.
5. Галеева Н.Л., (1999), Параметры художественного текста и перевод. Тверь, с.8-9

DR. MARSELA LIKAJ
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE
marsela.likaj@unitir.edu.al

LETËRSIA GREKE PËRMES PËRKTHIMIT NË GJUHË GJERMANE

ABSTRACT

Greek literature through its translation into German

This paper discusses Greek literature and its translation into German. After a brief overview of Greek literature and its division into periods, the paper will focus on modern literature and its translations into German. Special attention is paid to translations of modern literature in the 20th and early 21st centuries. A number of authors of the 20th century will be considered, such as Nikos Kazantzakis, Giorgos Seferis, Odysseas Elytis, Constantine Cavafy, who in various genres have made Greek literature popular not only in German-speaking countries, but in all the world. A special interest is given to some contemporary authors whose works were translated into German during the translation influx in 2000-2001 such as Ioanna Karystiani, Soti Triandafyllou, Petros Markaris and Antonis Sourounis. They present an as yet unknown Greece, the fate of its inhabitants beyond the Mediterranean sun and whitewashed houses. Looking beyond the facades, the reader realizes that some things haven't changed yet and that they actually exist. Some of the contemporary writers belong to the generation of immigrants, who bring a new perspective to literature. These works represent a new era of Greek literature, but in a sense they also bring European history from a Greek perspective.

Keywords: *Greek literature, translation, cultural exchange.*

ABSTRAKT

Ky punim trajton letërsinë greke, dhe përkthimin e saj në gjermanisht. Pas një hyrjeje të shkurtër panoramike mbi letërsinë greke dhe ndarjen e saj në periudha, punimi do të fokusohet në letërsinë moderne dhe përkthimet e saj në gjuhën gjermane. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përkthimeve të letërsisë moderne në shekullin e 20-të dhe në fillim të shekullit të 21-të. Do të merren në konsideratë një sërë autorësh të shekullit të 20-të, si Nikos Kazantzakis, Giorgios Seferis, Odysseas Elytis, Constantine Cavafi, të cilët në zhanre të ndryshme e kanë bërë letërsinë greke të njohur jo vetëm në vendet gjermanishtfolëse, por në të gjithë botën. Një interes i veçantë u kushtohet disa autorëve bashkëkohorë, veprat e të cilëve janë përkthyer në gjermanisht gjatë fluksit të përkthimeve në vitet 2000-2001 si Ioanna Karystiani, Soti Triandafyllou, Petros Markaris dhe Antonis Sourounis. Ata paraqesin një Greqi ende të panjohur, fatin e banorëve të saj përtej diellit mesdhetar dhe shtëpive të lyera me të bardha. Duke parë përtej fasadave, lexuesi kupton se disa gjëra nuk kanë ndryshuar ende dhe se ato ekzistojnë aktualisht. Disa nga shkrimtarët bashkëkohorë i përkasin brezit të emigrantëve, të cilët sjellin një këndvështrim të ri në letërsi. Këto vepra përfaqësojnë një epokë të re të letërsisë greke, por në njëfarë kuptimi ato sjellin edhe historinë evropiane nga këndvështrimi grek.

Fjalë kyç: *letërsi greke, përkthim, shkëmbim kulturash.*

Panorama historike e letërsisë greke ka qenë gjithmonë e bazuar në një koncept të letërsisë që vetëm kohët e fundit është bërë i zakonshëm në filologjinë moderne. Në një kuptim gjithëpërfshirës, përkufizimi “letërsi greke” nënkupton gjithçka që shkruhet në gjuhën greke për një publik specifik, pra jo vetëm letërsi artistike por edhe vepër filozofike, shkrim historik, fjalim publik apo dhe një biografi e hedhur në letër (krahaso: Griechische Literatur, 1981:1). Termi “letërsi greke” i referohet letërsisë në greqisht, d.m.th. si në greqishten e lashtë, ashtu edhe në gjuhën moderne greke.

Një ndarje e përgjithshme e saj do të ishte:

- Letërsia antike greke
- Letërsia bizantine
- Letërsia moderne greke

Letërsia e Greqisë së lashtë është origjina e zhvillimit të filozofisë, historiografisë dhe zhanreve letrare. Për shkak të kolonizimit, grekët njohën popuj dhe vende të tjera duke shkëmbyer ide dhe mendime për botën. Përmes shkrimit të këtyre

përvojave, ata krijuan zhanre të ndryshme, duke formësuar kështu letërsinë dhe kulturën evropiane.

Shkrimtari i madh gjerman, Goethe vlerëson se grekët kishin trinitetin esencial të mirësisë, të vërtetës dhe të bukurisë, për të përjetuar një zbulesë unike të bukurisë. Për të, Helenizmi ishte sinonim i qenies njerëzore. “*Midis të gjitha kombeve, grekët e kanë ëndërruar ëndrrën e jetës më bukur nga të gjithë*”, thotë Gëte në përmbledhjen e tij “Maksima dhe reflektime” (Goethe 2016). Ai i konsideronte grekët si një popull i aftë për t’i dhënë trajtë jetës, për të përjetuar deri në kufijtë e ekzistencës, që arrinin përsosjen e njerëzimit nëpërmjet bashkëveprimit harmonik të të gjitha kapaciteteve njerëzore dhe duke e shijuar të jetuarit, punuarit dhe vuajturit në këtë botë, dhe në të tashmen.

Admirimi i tij për Homerin e tundoi atë të shkruante epos në hexametër. Përveç Homerit, ai gjithashtu i referohet Sofokliut dhe Theokritit, sepse siç shprehet ai “ata më kanë mësuar të ndiej”. Mbi të gjitha, “Iliada” dhe “Odisea” i zbuluan atij shumë për natyrën e njeriut dhe të botës, si dhe për gjenium dhe artin. Nga kjo dije krijoi më pas “Götz-in”, “Werther-in”, “Prometeu-n” dhe “Faust-in”. Ky është një fakt që tregon se letërsia antike greke ka dalë prej kohësh përtej kufijve nacionalë dhe është bërë pjesë tashmë e arsenalit kulturor evropian e madje dhe botëror.

Studiues të ndryshëm gjermanë apo evropianë e kanë të vështirë të heqin një vijë ndarëse midis letërsisë antike greke, letërsisë së vjetër greke dhe letërsisë moderne greke. Madhështia e antikitetit grek është një fakt për të cilin autorët e letërsisë së re greke janë të vetëdijshëm. Ata e ndiejnë vazhdimisht peshën e krahasimit me letërsinë antike greke, duke e cilësuar: “sikur të mbanin Olimpin mbi supë”.

Le të vijmë tek vitet e pushtimit osman. Për tre shekuj me radhë, trojet greke ishin nën sundimin osman. Ishin pikërisht këngët popullore që luajtën një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, si edhe në përhapjen përtej trojeve greke përmes dijetarëve grekë që jetonin jashtë vendit. Në vitin 1816, filologu gjerman Werner von Haxthausen-i (1780-1842) hartoi një përmbledhje me 50 këngë, të cilat ia tregoi edhe njërit prej vëllezërve Grimm, Jakob Grimm-it, sikurse edhe shkrimtarit të mirënjohur Gëte. Me gjithë entuziazmin e tyre për këto perla të letërsisë greke, përmbledhja e Haxthausen-it mbeti e pabotuar deri në vitin 1935. Ishte shkrimtari Werner Müller (1794-1827), i cili mblodhi, përktheu dhe botoi një sërë këngësh të vyera greke. Kjo vëmendje ndaj Greqisë u pasua nga një botim i një filologu tjetër gjerman Carl Iken (1789-1841) “*Leukothea*” një koleksion letrash nga një grek mbi sistemin politik, letërsinë dhe poezinë e Greqisë së re” (2 vëllime) duke vijuar më pas me botime të tjera në revistën *Eunomia*, kontribut ky për njohjen e poezisë dhe prozës së re greke (Iken, 2018)).

Edhe në periudhën midis dy Luftërave Botërore kishte eksponentë kulturorë, të cilët përkthyen dhe publikuan vepra nga letërsia e re greke. Në vitin 1917 u botua Alexandros Papadiamandis, në vitin 1928 Karl Dieterich botoi antologjinë e tij të parë "Poetë modernë grekë", ndërsa në vitin 1944 doli Antologjia me titull "Ëndrra mbi valë", e cila përmbante 31 tregime të autorëve të ndryshëm grekë nga Alexandros Papadiamandis e deri tek Kostas Uranis, përzgjedhur nga Alexander Steinmetz.

Kur flasim për përcjelljen e letërsisë greke në gjuhë të ndryshme duhen mbajtur parasysh edhe disa çështje, si për shembull:

- Cilat janë fazat më produktive në historinë e përkthimit të letërsisë greke?
- Kush i përkthen këto tekste/libra?
- **Çfarë lloj tekstesh janë?**
- Cilët janë aktorët kryesorë që luajnë rol në përkthimin e letërsisë greke (si p.sh., Shtëpitë botuese etj.)
- Kush i lexon këto përkthime

Përgjithësisht grekët janë një popull me një diasporë të madhe të shpërndarë në të gjithë botën. Nisur nga ky fakt mund të thuhet se intelektualët e kësaj diaspore janë edhe përcjellësit kryesorë të letërsisë dhe kulturës greke në kulturën botërore në përgjithësi, sikurse edhe në atë gjermanofone. Këta intelektualë, një pjesë e të cilëve edhe filologë, konstatojnë se në bibliotekat universitare gjermane gjenden një numër i konsiderueshëm tekstesh të antikitetit: përkthime të Homerit, tragjedi dhe komedi greke të së njëjtës periudhë si edhe shumë studime mbi to, ndërsa nga letërsia moderne greke (të paktën deri në fund të shekullit të 20-të) gjendej vetëm një numër i kufizuar veprash të autorëve bashkëkohorë grekë.

Le të shohim fazat më produktive të përkthimit të letërsisë greke në gjuhën gjermane.

Në vitet '20 të shekullit XIX, janë pikërisht dijetarët e mëdhenj që përkthejnë veprat e antikitetit e më pas të Greqisë së kohës, ku një rol të rëndësishëm kanë vjershat dhe këngët popullore, sikurse dhe legjenda "Die Pöpstin Johanna" e Emmanouil Roidis)

Pas formimit të shtetit grek e deri në vitet '60 të shekullit XX përkthimet janë të pakta. Bestseller-i absolut është romani i Nikos Kazantzakis "Zorba", dalë në 1946, përkthyer në gjermanisht 1952 (700 000 kopje të shitura në Gjermani). Ky roman është ndër ato vepra që vënë një standard që vështirë të kapërcehet. Në njërin anë janë gjermano-perëndimorët që zbulojnë diellin dhe detin dhe tërhiqen

nga bukuritë e Greqisë, duke rritur interesimin për ta njohur dhe kuptuar më mirë vendin dhe kulturën greke, nga ana tjetër është Ministria e Kulturës por edhe vetë emigrantët grekë që kujdesen ta ruajnë imazhin e Zorbës deri në tavernat e thjeshta.

Nikos Kazantzakis (1883-1957) është një ndër emrat më të njohur të letërsisë së re greke, i cilësuar shpesh si “babai i letërsisë së re greke”. Kazantzakis është përkthyes i Faustit të Gëtes në gjuhën greke. Ai qëndroi në Berlin nga viti 1920 – 1923, shkroi disertacionin mbi Niçen, me të cilin ndezi një dialog letrar-filozofik greko-gjerman.

Në vitin 1945, ai u ngarkua nga qeveria greke që të hetojë krimet e luftës të kryera nga forcat okupuese gjermane në Kretë. Rezultatet e këtij hetimi u botuan në vitin 1983 nga komuna e Heraklionit nën titullin “Raporti i Komisionit Qendror mbi konstatimin e Krimeve të Luftës në Kretë”. Kazantzakis krijoi eposin e vet “Odise”, të përkthyer edhe në gjuhën gjermane nga Gustav A. Conradi, ndërsa në vitin 1946 hartoi romanin që mori famë botërore “Alexis Zorbas”, vepër kjo që shënon edhe pikën kulmore të shkëmbimit kulturor greko-gjerman. Ky roman përmban qartazi tiparet e filozofisë së Niçes, e cila u bë model për Kazantzakis-in, në veçanti për shkak të shpirtit të tij të pamposhtur të lirë.

Pas Luftës së Dytë Botërore vjen një fazë tjetër përkthimesh, kryesisht e poetëve (Elytis, Kavafis, Seferis, Ritsos)

Shumë lexues gjermanë mund të kenë dëgjuar emrat e shkrimtarëve Nikos Kazantzakis dhe Konstantinos Kavafis, disa të tjerë njohin autorët lirikë dhe nobelistët Jorgos Seferis (1963) dhe Odysseas Elytis (1979). Në kohën e përpjekjeve kundër diktaturës (1967-1974) lexues që tërhiqen kah politika kanë lexuar edhe për Jannis Ritsos-in, poezi të të cilit, u shoqëruan me muzikën e Mikis Theodorakis-it duke u bërë pjesë e disa koncerteve në hapësirën gjermanofone.

Në Republikën Federale Gjermane, një kontribut të çmuar për përkthimin dhe botimin në gjermanisht të një numri të madh veprash nga letërsia e re greke ka filologia e Departamentit të Filologjisë Moderne Greke në Bochum dhe Marburg, Isidora Rosenthal-Kamarinea (1918-2004). Ajo themeloi në vitin 1966 revistën “Hellenika”, një revistë për miqtë e Greqisë (sic ishte nëntitulli i saj), e cila u bë zëri i disa shoqatave gjermano-greke. Pas vitit 2006, Hellenika botohet me nëntitullin Revista për kulturën greke dhe marrëdhëniet gjermano-greke dhe vjen si botim i Bashkimit të shoqatave gjermano-greke. Ndërsa në RDGJ ishte filologu Johannes Irmscher (1920-2000) i cili kujdesej për përhapjen e letërsisë së re greke në RDGJ, duke preferuar vepra me përmbajtje politike, ose të autorëve të përndjekur politikisht.

Letërsia e rezistencës e periudhës së diktaturës ushtarake të viteve 1967-1974

u botua nën titullin “Ekzekutimi i mitit u krye në mëngjes herët” duke u bërë e njohur edhe në Gjermani. Megjithatë, shtëpitë botuese gjermane ishin të tërhequra karshi letërsisë greke, duke i vlerësuar temat e trajtua në letërsinë bashkëkohore greke si “grekocentrike” (Thënia e ish-drejtorit të Panairit të Frankfurtit: “Gjeni një tjetër Kazantzakis”).

Në vitet '90, përgjatë gjithë dekadës u përkthyen 120 tekste, jo vetëm libra të mirëfilltë, por edhe ese.

Në vitin 1995, në Berlin u krijua Fondacioni Kulturor Grek me synim përhapjen e kulturës (edhe të letërsisë) greke në hapësirën gjermanofone. U zhvilluan seminare përkthimi dhe u dhanë çmime për përkthimin e veprave, u ftuan në Gjermani autorë grekë, si Ioanna Karystiani ose Titos Patrikios duke kulmuar në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Frankfurt në vitin 2001, ku Greqia u paraqit si vendi Mysafir i panairit.

Në vitin 2001 vijjnë të përkthyer në gjuhën gjermane 75 tituj të rinj. Ndër autorët që spikatën në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Frankfurt mund të përmendim:

Pavios Matessis: Die Tochter der Hündin (Hanser)

Aris Alexandrou: Die Kiste (Antje Kunstmann)

Petros Markaris: Der Nachtfalter (Diogenes)

Antonis Sourounis: Der Rosenball (Piper)

Andreas Staikos: Kulinarische Liebschaften (Eichbom)

Griechische Lyrik des 20. Jahrhunderts (Suhrkamp)

Kiki Dimoula: Gedichte (Axel Dielmann)

Soti Triantafyllou: Der unterirdische Himmel (Zsolnay)

Ioanna Karystiani: Die Frauen von Andros (Suhrkamp)

E lindur në Athinë më 1957, Triandafyllou duket se është në rrugë të mbarë për t'u bërë një shkrimtare kulturi. Në hapësirën gjermanofone janë përkthyer tre romane të saj:

Der unterirdische Himmel. Qielli nëntokësor (Zsolnay Verlag, Vjenë 2001)

Die Bleistiftfabrik. Fabrika e lapsave, (Zsolnay Verlag, Vjenë 2004)

Das Zeichen des Jägers. Shenja e gjuetarit, triller, (Suhrkamp, Frankfurt 2009)

Der unterirdische Himmel. Qielli nëntokësor

Në përpjekjen për të përshkruar trazirat kulturore të një të riu në Amerikë, Triandafyllou arrin të krijojë një strukturë të re narrative. Në këtë vepër nuk ka situata të mbingarkuara emocionale, ajo qëndron e matur dhe objektive. Ndonjëherë ajo e trondit dhe lehtëson lexuesin në të njëjtën kohë me thyerjen e tregimit në momente kritike, duke futur në mënyrë të papritur harta të qytetit të SHBA, të cilat duhet t'i tregojnë lexuesit ku gjendet heroi i romanit, aty-këtu shfaqet fotografia e një muzikanti të njohur të jazz-it, të cilin Billy (heroi i romanit) e admiron, apo futja në mënyrë enciklopedike e shpjegimeve për zonat e rulotave, industrinë e makinave etj. Në mënyrë të ngjashme me teknikat e montazhit dhe kolazhit që janë hasur në fillimin e shekullit të 20-të në letërsinë botërore (mund të përmendim këtu *Alfred Döblin me Berlin Alexanderplatz*).

Libri i dytë “Fabrika e lapsave” është një nga librat më të lexuar të vitit 2000 në Greqi. Ai është një roman historik që fillon si një sagë familjare që paraqet marrëdhëniet shoqërore diku nga mesi i shekullit të 19-të. “Fabrika e lapsave” është një roman i mrekullueshëm për shekullin e 19-të, paraqitur nga këndvështrimi grek. Ai nuk lë jashtë asgjë të rëndësishme, madje Rosa Luxemburg-u dhe Karl Liebknecht-i njihen me dy heronjtë e romanit. Por për Triandafyllou-n është gjithashtu e rëndësishme të bëhet e qartë se të gjithë romanet e saj kanë të njëjtin motiv: *Rrethanat e jetës njerëzore* qofshin këto të një natyre politike apo thjesht personale. Heronjtë e saj revoltojnë kundër normave ekzistuese nga të cilat ata duan të shpërthejnë me çdo kusht.

Historia është një ndërmarrje e guximshme që mund të quhet larje hesapesh me komunizmin. Për vetë Triandafyllou-n, „Fabrika e lapsave“ është përpjekja për të shkruar kundër politizimit të detyruar dhe për të nderuar të gjithë revolucionarët e kësaj bote, të cilët do të vdisnin për idealet e vërteta, si heroi në romanin e saj, Vangalis-i.

Një autore bashkëkohore greke e përkthyer në gjuhën gjermane është Ioanna Karistiani (lindur në vitin 1952 në Kretë nga prindër aziatikë). Nga kjo autore janë përkthyer në gjuhën gjermane 3 vepra të saj.

Die Augen des Meeres. Sytë e detit. Suhrkamp, Frankfurt 2009.

Schattenhochzeit. Dasma hije. Übersetzt von Michaela Prinzinger. Suhrkamp, Frankfurt 2003.

Die Frauen von Andros. Gratë nga Andros-i. Übersetzt von Norbert Hause. Suhrkamp, Frankfurt 2001.

Ajo zgjodhi ishujt e Androsit dhe të Kretës si vendet e romaneve të saj, gjë që e bëri atë menjëherë të famshme në Greqi. Asaj i interesojnë vendet e vogla të Greqisë me njerëz të thjeshtë të panjohur.

„Si autorë nuk mund ta pyesim veten, se cila temë mund të tërheqë një lexues nga Hanover-i. Ne duhet të qëndrojmë besnikë ndaj vetes dhe historive tona. Personalisht, besoj se duke zgjedhur një vend të vogël në Greqi dhe duke e trajtuar atë në mënyrë të ndershme dhe të drejtë në historitë e mia, gjithkush e ndjen këtë.“ Cituar nga: Neue Griechische Literatur in deutscher Übersetzung. Ein Radioessay 31.07.2001“

Kriza ekonomike e Greqisë ndikoi negativisht edhe në tregun e librit grek në Gjermani. Që nga ajo kohë janë të paktë titujt e veprave greke të botuar në Gjermani. Shtëpitë botuese shfaqin më tepër interes për ato tekste që flasin për krizën greke. Kështu për shembull, edhe autori grek i romaneve triller, më i suksesshmi në hapësirën gjermanofone, Petros Markaris i dedikoi një trilogji të tërë temës së krizës greke, duke i plotësuar dëshirën shtëpisë së tij botuese (Diogenes).

Diaspora dhe shoqatat e ndryshme kulturore vazhdojnë të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përcjelljen e letërsisë greke në Gjermani. Këtu do të përmendja “Kuartetin Letrar të Athinës”, i cili prej mbi 20 vitesh prezanton vepra dhe autorë të rëndësishëm në të dyja kulturat.

Megjithatë, i gjithë spektri i literaturës bashkëkohore greke në Gjermani është mbresëlënës. Greqia paraqet veten në literaturën e saj si një vend mesdhetar, që duke u ndodhur në periferi të Evropës, midis Orientit dhe Perëndimit, dhe me një përvojë historike edhe të rënies së perandorive ka një këndvështrim të vetin dhe ruan një vetëdije mbi aspektin tragjik të jetës.

BIBLIOGRAFIA

1. Griechische Literatur, Hrsg. Ernst Vogt in Verbindung mit Olof Gigon, Hil-debrecht Hommel, Albin Lesky, Arnaldo Momigliano, Carl Werner Müller, Hans-Joachim Newiger, Gustav Adolf Seeckund Martin L. West (Neues Handbuch der Literaturwissenschaft Band 2), Wiesbaden 1981, f. 1–18.
2. “Konstantinos Simonides: Literarische Fälschungen und die Erfindung der Nation”, in: Müller/Diamantopoulou/Gastgeber/Katsiakiori-Rankl:

- Die getäuschte Wissenschaft. Ein Genie betrügt Europa - Konstantinos Simonides, Wien: V&R, 2017, f. 27-52.
3. Neue Griechische Literatur in deutscher Übersetzung. Ein Radioessay 31.07.2001
 4. Axioti, M.: Antigone lebt: neugriechische Erzählungen, Volk u. Welt, 1960.
 5. Goethe, J.W.: Über Kunst und Altertum, B.3 Heft 1, Stuttgart 1821.
 6. Goeth, J.W.: Maximen und Reflexionen, Holzinger 2016.
 7. Iken, C.J.L.: Leukothea, Wentworth Press 2018, S.262.
 8. Köpstein, H.: Probleme der neugriechischen Literatur, Akademie Verlag, Berlin 1959, S.35-42.
 9. Karystiani, I.: Die Augen des Meeres, Suhrkamp, Frankfurt 2009.
 10. Karystiani, I.: Schattenhochzeit, Suhrkamp, Frankfurt 2003.
 11. Karystiani, I.: Die Frauen von Andros, Suhrkamp, Frankfurt 2001.
 12. Kazantzakis, A.: Alexis Sorbas, Pipper Verlag 2001.
 13. Triantafillou, S.: Der unterirdische Himmel, Zsolnay Verlag, Wien 2001.

PROF. AS. DR. EMA KRISTO & PROF. AS. DR. JONIDA BUSHI
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA, UT
ema.kristo@unitir.edu.al/ jonida.bushi@unitir.edu.al

**FRAZELOGJIZMAT NË LETËRSINË PËR FËMIJË
PËRKTHIMI LETRAR NË LETËRSINË PËR FËMIJË DHE TË RINJ –
RASTI I SHPREHJEVE FRAZELOGJIKE NË ROMANIN
ZEMËR SI BOJA (TINTENHERZ) I CORNELIA FUNKE**

ABSTRAKT

Frazologjizmat janë një pasuri e veçantë edhe në letërsinë për fëmijë. Frazologjizmat bëjnë leximin më argëtues, sjellin një element shumëngjyrësh dhe emocionesh në tekste dhe përmirësojnë aftësinë e fëmijëve për të kuptuar thellësisht mesazhet dhe ngjarjet.

Përkthimi i frazeologjizmave në letërsinë për fëmijë vjen me disa sfida të veçanta dhe kërkon një aftësi të theksuar për të kapur thelbin e tyre dhe përshtatur ato në kultura dhe gjuhë të ndryshme. Për përkthyesit është e rëndësishme të kuptojnë thelbin e çdo shprehjeje frazeologjike dhe të jenë kreativë për të përshtatur shprehjet në mënyrë që të jenë tërheqëse dhe të kuptueshme për fëmijët në gjuhën e tyre.

Përkthimi letrar është një disiplinë e rëndësishme për të bërë të njohur dhe të prekshme letërsinë e vendeve dhe kulturave të ndryshme. Ky artikull synon të trajtojë përkthimin letrar në një fushë të veçantë të letërsisë, asaj të letërsisë për fëmijë dhe të rinj. “*Zemër si boja*” i autores Cornelia Funke është padyshim një libër i veçantë i letërsisë për fëmijë dhe të rinj në Gjermani. Në tekstin origjinal në gjermanisht, vepra shquhet për lojën me gjuhën, për pasurinë gjuhësore e figurshmërisë artistike e njëkohësisht për përdorimin e disa fjalëve ose frazave që janë të vështira ose të pamundura për t’u përkthyer. Punimi synon të evidentojë kapërcimin e pengesave gjuhësore në dukje të pakapërcyeshme duke u fokusuar në mënyrën në të cilin realizohet përkthimi në gjuhën shqipe, nëse ka ndryshim me origjinalin në aspektin gjuhësor dhe mënyrën e përkthimit të shprehjeve frazeologjike etj.

Fjalë kyç: *shprehje frazeologjike, tekst letrar, origjinal, përkthim, krahasim, figurë artistike.*

ABSTRACT

Phraseologies are a distinctive treasure in children's literature. They make reading more enjoyable, bring a myriad of elements and emotions into texts, and enhance children's ability to deeply understand messages and events. The translation of phraseologies'/idioms in children's literature comes with specific challenges and requires a strong skill set to capture their essence and adapt them to different cultures and languages. For translators, it is crucial to grasp the core of each idiomatic expression and be creative in adapting them in a way that is appealing and understandable for children in their language.

Literary translation is an important discipline for making the literature of different countries and cultures known and accessible. This article aims to address literary translation in a specific field of literature, that of children's and young adult literature. "Ink heart" by the author Cornelia Funke is undoubtedly a special book in German children's literature. The work stands out for playing with language in the original German text, linguistic richness, artistic figurativeness, and the use of some words or phrases that are challenging or impossible to translate. The study aims to highlight the overcoming of seemingly insurmountable language barriers by focusing on the way translation is carried out in the Albanian language, examining whether there are differences with the original in linguistic aspects and the translation of idiomatic expressions, etc.

Keywords: *phraseologies, literary text, original, translation, comparison, artistic figure*

HYRJE

Interesi për përkthimin e letërsisë për fëmijë ka përjetuar një zhvillim të shpejtë gjatë viteve të fundit. Rëndësia e letërsisë për fëmijë dhe procesi i përkthimit të saj zënë një vend të veçantë në skenën ndërkombëtare, pasi audiencën kryesore të kësaj letërsie e përbëjnë fëmijët. Shpesh herë, tekstet e letërsisë për fëmijë shkruhen nga autorë të rritur. Përkthyesit e letërsisë për fëmijë duhet të jenë në gjendje të përkthejnë tekstet në një mënyrë që të jenë të kuptueshme dhe të përshtatshme për lexuesit e vegjël. Përkthimi duhet të ruajë jo vetëm thelbin e historive, por edhe të shfaqë humorin, magjinë, dhe emocionet e përfshira në tekstet origjinale.

Në aspektin metodologjik në këtë artikull synohet të trajtohet përmes një analize të thelluar të tekstit origjinal në gjuhën gjermane me variantin e tekstit në gjuhën

shqipe, e mbështetur në aspekte teorike lidhur me fushën e përkthimit letrar në letërsinë për fëmijë e të rinj. Analiza krahasuese do të fokusohet në realizimin gjuhësor shprehjeve frazeologjike, të cilat krahas vlerave estetike, si pjesë e strukturave tekstore luajnë një rol të veçantë në rrokjen dhe kuptimin të tekstit.

Pikëpamje të ndryshme mbi përkthimin

Fillimisht, është e rëndësishme të theksojmë se letërsia për fëmijë nuk ka një përkufizim të vetëm dhe përfundimtar. Ka shumë interpretime dhe kuptime të ndryshme të kësaj fushe. Pyetja themelore që lind është: Cilat janë cilësitë që karakterizojnë letërsinë për fëmijë? Astrit Bishqemi¹¹⁰ vlerëson se në konceptin e “letërsisë për fëmijë” përfshihen kërkesat pedagogjike dhe ato edukative, duke përfshirë vepra të përshtatura ose shkruara për audiencë të rritur, por që janë të kuptueshme ose mund të shërbejnë për fëmijët. Oittinen e paraqet letërsinë e fëmijëve si “letërsi që është prodhuar dhe destinuar për fëmijë ose letërsi që lexohet nga fëmijët”. Ehlers, nga ana tjetër, përfshin në këtë kategori “të gjitha veprat me gojë dhe me shkrim që adresojnë ëndrrat, emocionet dhe mendimet e fëmijëve”¹¹¹. Klingberg veçon dallimin midis ‘letërsisë për fëmijë’ dhe ‘letërsisë që lexojnë fëmijët’, duke e kufizuar letërsinë për fëmijë si atë që krijohet posaçërisht për këtë grup lexuesish.¹¹² Librat për fëmijë shfaqen në letërsinë botërore për të transmetuar vizionin dhe kulturën e brezit të ri. Në këtë kontekst, letërsia për fëmijë shërben si një mjet edukues, didaktik dhe argëtues. Megjithatë, Rita Oitinen nxit një diskutim duke shprehur dyshime rreth nevojës për të përkufizuar letërsinë për fëmijë. Ajo vëren se veprat letrare dhe zhanret evoluojnë, duke marrë kuptime të ndryshme dhe ripërkufizohen gjithnjë nga e para. Kjo nënkupton se ajo që sot mund të jetë letërsi për të rritur, në të ardhmen mund të shndërrohet në letërsi për fëmijë.¹¹³

Në lidhje me përkthimin e letërsisë për fëmijë ka gjithashtu mendime të shumta. Përkundër asaj që mendohet zakonisht, përkthimi i letërsisë për fëmijë nuk është i thjeshtë, ai është më i vështirë dhe më i rëndësishëm sesa përkthimi i letërsisë për të rritur. Sepse letërsia për fëmijë luan një rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve. Puurtinen¹¹⁴ argumenton se përkthimi i letërsisë për fëmijë që disa

¹¹⁰ Bishqemi, A. (2006) *Histori e Letërsisë Botërore për Fëmijë*. Sejko, Tiranë. f.51

¹¹¹ Ehlers, S. (1996): *Literarische Texte lesen lernen*. München: Klett Edition Deutsch. f. 33

¹¹² Klingberg, G. (1986): „Children’s Fiction in the Hands of the Translators “. Malmo: CWK Gleerup, f.61

¹¹³ Oittinen, R. (2006): „No Innocent Act: On the Ethics of Translating for Children“, in: Jan Van Coillie, Walter P. Verschueren (Hg.): *Children’s Literature in Translation; Challenges and Strategies*. Manchester: St Jerome Publishing. f.62

¹¹⁴ Puurtinen, T. (1995): *Linguistic Acceptability in Translated Children’s Literature*, Joensuu: University of Joensuu. f. 54

konsiderojnë relativisht të thjeshtë, mund të ndryshojë nga kultura në kulturë dhe të përballet me një numër kufizimesh. Emrat, strukturat e fjalive ose konotacionet që janë të huaja për kulturën e synuar mund të mos jenë problem për të rriturit, por mund të jenë të paqarta për fëmijët. Sipas Puurtinen, përkthimi ndikohet nga normat didaktike, ideologjike, morale, etike dhe fetare që janë thelbësore në një kohë dhe kulturë të caktuar. Për më tepër, ka edhe një sërë ndryshimesh mes gjuhëve dhe kulturave në lidhje me normat e pranuar gjerësisht. Në lidhje me letërsinë për fëmijë, prirjet janë të ndryshme: përkthyesi mund të ruajë elementët e huaj ose mund t'i asimilojë ato sipas gjuhës dhe kulturës së përkthimit. Ndër elementët e huaj që mund t'i nënshtrohen njërës prirje ose tjetrës përmendim emrat e personazheve, njësitë matëse të hapësirave, peshave, njësitë monetare, referencat kulturore, etj. Prirja e përkthyesit ndaj huajëzimit i vendos lexuesit para një përgjegjësie më të madhe gjatë procesit të leximit, ata përballen me më shumë sfida gjatë interpretimit sepse teksti i përkthyer përmban një sërë elementësh të huaj, ashtu siç ata shfaqen në tekstin origjinal, pjesë e kulturës përfaqësuar nga gjuha origjinale.

Studiuesit pohojnë se një përkthyes letrar për fëmijë mund të ketë një liri shumë më të madhe në krahasim me përkthyesin e letërsisë për të rritur. Sipas Oittinen¹¹⁵, njohuritë mbi sfondin, kulturën, gjuhën, fëmijërinë dhe imazhin e fëmijërisë së përkthyesit ndikojnë në përkthim, duke luajtur një rol thelbësor në përcaktimin e strategjisë së përkthimit.

Për këtë arsye, përkthimi letrar për fëmijë ndryshon nga përkthimi i të rriturve. Ky ndryshim kërkon miratimin e metodave ose rregullave të ndryshme për përkthimin e letërsisë për fëmijë. Strategjitë e përkthimit letrar për fëmijë përfshijnë përshtatjen, shtimin, fshirjen, shkurtimin dhe modernizimin dhe pastrimin. Sidoqoftë, përkthyesi nuk është plotësisht i pakufizuar kur përdor këto strategji.¹¹⁶

Veçori frazeologjike

Si përkufizohen frazeologjizmat, frazemat? Cilat janë veçoritë e këtyre shfaqjeve gjuhësore natyrale, të cilat përmbledhen në këtë koncept dhe për të cilat dihet se gjenden në çdo gjuhë prej një kohe të gjatë? Për çudi hulumtimet e gjuhëve të veçanta tregojnë se ka një përputhshmëri të veçorive kryesore, një dukuri e cila thur hipotezën e frazeologjizmave apo idiomave si “universale gjuhësore”. Në literaturën shkencore pranohen si veçori kryesore të frazeologjizmave: struktura me shumë gjymtyrë, polileksikaliteti, qëndrueshmëria dhe figuracioni.

¹¹⁵ Oittinen, R. (2000): *Translating for Children*. New York/London: Garland Publishing. f. 41

¹¹⁶ Puurtinen, T. (2006): „*Translating Children’s Literature: Theoretical Approaches and Empirical Studies*“, in: Gillian Lathey (Hg.): *The Translation of Children’s Literature: A Reader*, Clevedon: Multilingual Matters. f.111

Si tipare të tjera të frazeologjizmave vlej në leksikalizimi dhe riprodhueshmëria. Tipari i parë është më i pagabueshmi nga të gjithë: pavarësisht disa përjashtimeve në lidhje me përkufizimin, frazeologjizmat figurojnë si njësi shumëgjymtyrëshe. Ato karakterizohen nga një qëndrueshmëri relative dhe kuptimi i tyre nuk mund të dalë në mënyrë të lirë, që do të thotë se kuptimi i përbërësve veç e veç nuk e jep kuptimin e përgjithshëm të zinxhirit të leksemave. Idiomaciteti është dhe më i ndërlikuari, sepse bëhet fjalë për pasojat semantike të strukturës shumëgjymtyrëshe dhe të qëndrueshmërisë.

Për të gjitha frazeologjizmat vlen si kusht themeltar qëndrueshmëria e tyre. Kjo do të thotë që një frazeologjizëm përdoret dhe njihet si një fjalë. Por forma e tij nuk është ngulitur në mënyrë absolute, ajo mund të bëhet e ndryshueshme pak a shumë: “Nëse flitet për qëndrueshmëri, nënkuptohet mënyra dhe numri i varianteve midis të cilave duhet të vendosë folësi.”¹¹⁷

Ka frazeologjizma që janë krejt të qëndrueshme dhe nuk lejojnë ndryshime - një shprehje e tillë do të ishte *të hedhësh pushkën në drithë: këtu nuk mund të ndërrohet asnjë nga përbërësit pa u prishur kuptimi; mund të thuash hedh armën në drithë*, veç kjo ka tjetër kuptim nga njësia e parë, ose *të hedhësh pushkën në tërshërë*, ka kuptim tjetër gjithsesi nga shprehja të *hedhësh pushkën në drithë, që do të thotë të dorëzohesh shpejt*. Ekzistojnë edhe frazeologjizma më pak të ngulitura dhe më të ndryshueshme, ndërrimi i përbërësve tek të cilat nuk e ndryshon kuptimin e përgjithshëm.¹¹⁸

Së fundmi, ekzistojnë shprehje frazeologjike që shfaqin një masë të madhe ndryshueshmërie dhe qëndrueshmëri të dobët. Nga sa thamë më sipër, rrjedh që frazeologjizmat janë njësi polileksikore të një qëndrueshmërie relative. Këtë e nënvizojnë p.sh. variantet dhe modifikimet. Si rrjedhim, frazeologjia përmbledh frazeologjizma të qëndrueshme dhe më pak të qëndrueshme.

Jo çdo kriter duhet të vlejë në të njëjtën mënyrë për të gjitha frazeologjizmat. Kështu polileksikaliteti mund të shihet si një tipar universal për të gjitha frazeologjizmat, ndërsa idiomaciteti jo. Edhe kriteri i qëndrueshmërisë është më tepër problematik sesa i lehtë. Pjesa më e madhe e frazeologjizmave lejon ndryshime në kufij të caktuar, vetëm një pakicë është tërësisht e ngurosur. Më së shumti bëhet fjalë për shprehje me përbërës unikalë dhe me anomali të tjera. Cilësitë frazeologjike të përmendura nuk mund të shqyrtohen gjithmonë si madhësi e caktuar e absolute, sepse shpesh perceptimi i tyre varet subjektivisht nga folësi, dëgjuesi.

¹¹⁷ Burger, H. (2003). Phraseologie. Eine Einführung am Beispiel des Deutschen. (4. Ausg.). Berlin: Erich Schmidt Verlag. F. 53

¹¹⁸ Fleischer, W. (1997). Phaseologie der deutschen Gegenwartssprache. Bibliographisches Institut. f. 87

Frazeologjia në letërsinë për fëmijë dhe të rinj

Frazat dhe shprehjet frazeologjike kanë një rol thelbësor në letërsinë për fëmijë dhe të rinj, duke krijuar një atmosferë të veçantë dhe duke ndihmuar në formimin e aftësive letrare të lexuesve të rinj. Autorët e librave për këtë grupmoshë kanë si qëllim të përdorin gjuhën në mënyrë që të jetë e kuptueshme për lexuesit e tyre të vegjël. Frazeologjia, ose përdorimi i shprehjeve të zakonshme dhe frazave me domethënie të veçantë, ka një rëndësi të veçantë në krijimin e një lidhjeje të ngushtë midis lexuesit dhe tekstit.¹¹⁹

Për analizën e shprehjeve frazeologjike në këtë artikull kemi zgjedhur si shembull konkret romanin “Tinteherz” (*zemër si boja*), i rekomanduar për fëmijë mbi 10 vjeç. Përdorimi i frazeologjisë në këtë roman shërben si një mjet për të krijuar një lidhje emocionale mes lexuesit dhe ngjarjeve në libër. Autori ka përzgjedhur fjalë dhe shprehje që fuqizojnë përjetimin emocional të lexuesit, duke e bërë këtë roman jo vetëm një aventurë lexuese, por edhe një eksperiencë të pasur emocionale dhe intelektuale.

Në këtë kontekst, Burger, shpjegon se përdorimi i një gjuhe të kuptueshme dhe i përshtatshme është kyç në krijimin e një lidhjeje të fuqishme me audiencën e tij të re. Ai vlerëson ndikimin e frazeologjisë dhe zgjedhjen e një gjuhe të përshtatshme për të përcjellë mesazhe dhe emocione në mënyrë që të kuptohen dhe nga lexuesit e tij të vegjël.¹²⁰

Romani *Tinteherz (zemër si boja)* rekomandohet për fëmijët mbi 10 vjeç, prandaj është një roman për fëmijë ose të rinj. Autorët e librave për fëmijë shpesh përpiqen të gjejnë se çfarë lloj gjuhe është e përshtatshme për fëmijët. Burger dallon lloje të përdorimit të frazave në librat për fëmijë. Sipas tij përdorimi i frazave dhe shprehjeve frazeologjike të komplikuar nuk është i pritshëm aq shpesh në librat e fëmijëve dhe të rinjve, pasi kërkohen aftësi më të larta njohëse për të kuptuar këto lojëra gjuhësore.¹²¹

¹¹⁹ Jonida Bushi “Phraseologismen im Fremdsprachunterricht” Journal L’Association 1901 SEPIKE, Website: <http://www.sepikcloud.com> Publisher: L’Association 1901 Sepike, Country: DE. 2020, f.5.

¹²⁰ Burger, H. (2003). *Phraseologie. Eine Einführung am Beispiel des Deutschen*. (4. Ausg.). Berlin: Erich Schmidt Verlag. f. 53

¹²¹ Burger, H. (2003). *Phraseologie. Eine Einführung am Beispiel des Deutschen*. (4. Ausg.). Berlin: Erich Schmidt Verlag. f. 54

Romani „Zemër si boja“

Romani *Zemër si boja* është libri i parë i shkruar në trilogjinë *Bota e bojës*, botuar në 2003. *Gjak si boja*, pjesa e dytë doli në 2005 dhe pjesa e tretë e quajtur *Vdekja si boja* u publikua në 2007 të autores Cornelia Funke¹²². Në këtë artikull do të analizohet dhe në fokus do të jetë vetëm romani *Zemër si boja*. Veprimi në roman ndodh në të tashmen dhe shumicën e kohës në botën reale, dhe në një botë joreale gjithashtu. Për të kuptuar romanin, bëhet një hyrje e shkurtër e përmbajtjes.¹²³

Intertekstualiteti luan një rol të rëndësishëm gjatë gjithë trilogjisë. Çdo kapitull fillon me një citim ose një fragment nga letërsia botërore. Citimet tregojnë përmbajtjen e kapitullit vijues.

Në fund të çdo kapitulli ka ilustrime nga vetë autorja, të cilat jo gjithmonë përputhen me përmbajtjen. Temat kryesore përfshijnë miqësinë dhe marrëdhëniet midis njerëzve dhe zhvillimin e tyre (si Megi dhe Elinor), guximin, dhembshurinë dhe gjithashtu fuqinë e leximit dhe dashurinë për librat (raftet e librave të veshur

¹²² Cornelia Funke është një autore gjermane e librave për fëmijë dhe të rinj. Ajo është autorja më e suksesshme dhe më e njohur ndërkombëtarisht. Ka lindur më 10 dhjetor 1958 në Dorsten. Është diplomuar në pedagogji. Më pas ajo punoi për tre vjet me fëmijët si edukatore dhe njëkohësisht studioi ilustrim librash në Hamburg. Pasi ilustroi libra për fëmijë për të tjerët, ajo filloi të shkruante vetë.

Ka shkruar libra të shumtë për fëmijë dhe të rinj, mbi 40 të tillë. Shumica e librave i përkasin letërsisë fantastike. Ajo ilustroi vetë librat e saj. Librat e Cornelia Funke janë përkthyer në shumë gjuhë dhe tregimet e saj njihen në mbi 45 vende të botës. Gjithsej 4.5 milionë libra nga Cornelia Funke janë shitur vetëm në gjermanisht. Në gjuhën shqipe libri është përkthyer nga Elona Mistrovica, në shtëpinë botuese Dudaj dhe mban titullin “Zemër si boja”.

Ajo është e njohur botërisht me librin *Der Herr der Diebe*. Revista amerikane “Time” e zgjodhi atë si një nga 100 njerëzit më me ndikim të vitit 2005. Ajo mori çmime të shumta për veprat e saj. Në vitin 2003 ajo mori çmimin Corine (çmim ndërkombëtar për librin) për romanin *Herr der Diebe*, në vitin 2004 për librin *Tintehertz* mori Çmimin e Jurisë së Lexuesve të Rinj dhe Çmimin Fantazi të qytetit të Wetzlar. Disa prej veprave të saj janë vendosur në skenë.

Suksesi i romanit “Zemër si boja” pasqyrohet edhe në realizimin filmik të tij. Filmi u shfaq në kinema më 11 dhjetor 2008, me të njëjtin titull. *Zemër si boja* është një roman emocionues, pjesa e parë e trilogjisë “Bota e bojës”, me të cilën Cornelia Funke fitoi disa çmime.

¹²³ Një natë një i huaj u shfaq në një shtëpi, në të cilën jeton një vajzë dymbëdhjetë vjeçare me emrin Megi dhe babai i saj Mortimer Folchart, i quajtur Mo nga vajza e tij. Gjithçka ndryshon atë natë. Emri i të huajit është Gishtpluhuri. Ai dhe Mo e njohin njëri-tjetrin që më parë. Gishtpluhuri ka ardhur te Mo për ta paralajmëruar në lidhje me një Bricjap. Historia aventureske fillon nga ky moment. Mo ka një dhunti të veçantë. Ndërsa Mo lexon librat, historia nga librat bëhet realitet dhe personazhet nga librat zgjohen dhe bëhen realë dhe vijnë në botën e tij. Mo nuk e ndau kurrë këtë dhunti me vajzën e tij. Kur Megi ishte tre vjeç, Mo po lexonte një histori nga libri “Zemër si boja”, ndërsa një zotëri i lig me zemër të zezë, Bricjapi, u çlirua nga litarët e fjalëve dhe u shfaq në sallon. Po në të njëjtin çast fatal, ndodhi edhe diçka tjetër më e rëndë: gruaja e Mosë u zhdruk përgjithmonë mes faqeve të librit. Ndërkaq, Bricjapi i pamëshirshëm kërkon prej Mo Gjuhëzanës që t’ia nënshtrojë dhuntinë e tij qëllimeve të veta djallëzore. Megi gjendet e përfshirë në një vorbull ndodhish, gjatë të cilave përfytyrimi shndërrohet në realitet.

me pëlhurë, bibliotekat që shfaqen vazhdimisht shërbejnë si skenë veprimi). Personazhet në libër janë të lehtë për t'u kuptuar nga lexuesi për shkak të përshkrimit të detajuar. Mënyra e të shkruarit karakterizohet nga imazhe unike dhe shprehje të fuqishme. Shkrimi i thjeshtë dhe i kuptueshëm është në të njëjtën kohë interesant dhe e tërheq lexuesin në botën e përshkruar. Personazhet shpesh identifikohen me emra të pazakontë, shpesh të lidhur me karakterin ose pamjen e tyre.

Analiza e tekstit - Shprehjet frazeologjike

Frazeologjizmat mund të dallohen nga kombinimet e lira të fjalëve ose fjalitë sipas një sërë të vetive të tyre të veçanta. Sipas Burger (2010), këto karakteristika përfshijnë polileksikitetin, stabilitetin dhe idiomatikën. Romani *Tintenherz* përmban shprehje frazeologjike të shumta, gjithsesi në pjesën empirike ne u përqendruam vetëm në dy forma siç janë **Zwillingsformeln (format binjake) dhe idiomat.**

- romanet për fëmijë dhe të rinj priren të përdorin fraza dhe shprehje që janë të lehta për t'u kuptuar nga lexuesi dhe në të njëjtën kohë u mundësojnë atyre të përfytyrojnë më lehtë situatat.
- ekziston rreziku që lexuesit e vegjël të mos i kuptojnë të gjitha frazat, prandaj përdorimi i frazave idiomatike në tekst duhet të jetë i tillë që kuptimi i tyre të jetë i qartë në kontekst, në mënyrë që lexuesit të kuptojnë lehtësisht edhe fraza plotësisht idiomatike të panjohura.

Formulat binjake (të quajtura edhe formula të çifteve) formohen sipas modelit të mëposhtëm: dy fjalë me të njëjtën pjesë të ligjëratës ose e njëjta fjalë dy herë kombinohen me lidhëzën *dhe* (ose me një lidhëz tjetër) ose një parafjalë për të formuar një formulë të çiftëzuar. Rendi i komponentëve është kryesisht i fiksuar ose preferohet një renditje. Rendi i formulave binjake me komponentë unikë është plotësisht i fiksuar. Formulatat binjake tregojnë shkallë të ndryshme idiomatike:

idiomatike - *gang und gäbe*

pjesërisht idiomatike - *klipp und klar*

jo idiomatike - *dick und fett*

Mord und Totschlag geben	
„Wegen eines solchen Buches hat es schon Mord und Totschlag gegeben. Ich brauchte zum Glück sie nur zu kaufen.“(f.50)	„Për një libër si ky, ka njerëz që arrijnë deri aty sa të vrasin. Mua për fat të mirë m'u desh vetëm ta blija (f.43)

Në fushën juridike Mord und Totschlag kuptohen si dy vepra të ndryshme, por në këtë rast ato trajtohen si sinonime dhe (ndonëse vrasja është një akt më i rëndë se vrasja nga pakujdesia) të lidhura nga kuptimi i shprehjes. Shprehja është plotësisht idiomatike dhe metaforike. Përkthimi në shqip nuk korrespondon plotësisht me origjinalin gjermanisht, pra është një ekuivalencë e pjesshme.

Schritt und Tritt	
„Heute gehe ich allein. Und wenn ich jemanden brauche, der mir auf Schritt und Tritt nachläuft, schaff ich mir einen Hund an.“ (f. 373)	Sot do të shkoj vetëm. Dhe nëse ndonjëherë do të dua dikë që të më ndjekë nga pas, atëherë do të marr një qen. (f.308)

Në këtë rast, bëhet fjalë për një formulë emërore binjake, e cila mund të përshkruhet si një kombinim i dy sinonimeve me rimë fundore. Duke e dyfishuar, kuptimi përforcohet. Shprehja është stilistikisht neutrale. Përkthimi shqip është pjesërisht ekuivalent me tekstin burimor gjerman. Aspekti semantik është ruajtur pjesërisht, gjithashtu kanë ndodhur ndryshime edhe në rrafshin leksikor dhe gramatikor. (parafjalë + rrethanor vendi)

viel zu viel	
»Das ist doch Unsinn!«, sagte sie ärgerlich. »Du gibst viel zu viel auf das, was dieser Streichholzfräser erzählt.« (f. 96)	„Gjepura! - ia ktheu e zemëruar. - I beson si shumë fjalët e atij ngrënësit të shkrepëseve.“ f.79

Është një formulë binjake ndajfoljore që është stilistikisht neutrale. Në gjermanisht ka një dyfishim, që rrit kuptimin. Në përkthimin shqip, përkthyesi nuk e ka mbajtur këtë formë, por përkthimi mund të konsiderohet plotësisht i barasvlershëm, sepse i përshtatet kontekstit dhe është konciz.

dicht an dicht	
„Meggie strich mit der Hand über die dicht an dicht stehenden Buchrücken!“ (S. 66)	Megi kaloi dorën në shpinën e veshjes së shqepur të librit. (f.55)

Në këtë rast kemi të bëjmë me një formulë binjake ndajfoljore, e cila duhet të konsiderohet si stilistikisht neutrale. Dyfishimi në tekstin burimor rrit kuptimin. Përkthimi në gjuhën shqipe nuk korrespondon aspak me origjinalin dhe shprehja nuk është ekuivalente.

Idiomat

Këto ndërtime përbëhen nga të paktën dy fjalë. Sipas shkallës së idiomatikës ndahen në shprehje të plota, të pjesshme ose jo idiomatike. Kuptimi i përgjithshëm i tyre nuk mund të dallohet nga komponentët përbërës. Kuptimi i tyre nuk duhet kuptuar fjalë për fjalë, por figurativisht. Në libër gjenden kryesisht idioma foljore.

mit allen Wassern gewaschen sein	Kuptimi: i rrahur me vaj e me uthull
Sie [Bücher] waren ihr Zuhause in der Fremde – vertraute Stimmen, Freunde, die sich nie mit ihr stritten, kluge, mächtige Freude, verwegen und mit allen Wassern der Welt gewaschen, weit gereist, abenteurerprobt. (f. 24)	Ato (librat) ishin shtëpiza e saj, miq me të cilët nuk grindej asnjëherë, miq që dinin shumë gjëra, miq të pushtetshëm, të guximshëm, me përvojë, njohës të hollë të botës, dhe që i bëjnë ballë çdo të papriture. (f.22)

Përkthyesja është përpjekur të japë kuptimin e kësaj shprehje duke e perifrastuar. Nuk ka ekuivalencë, dhe nuk është ruajtur si idiomë foljore.

jmdn. in die Finger bekommen/kriegen	Kuptimi: bie në dorë të dikujt
„Was soll ich Capricorns Männer erzählen, wenn sie mich in die Finger bekommen?“ (f. 31)	Po të më kapin çfarë duhet ti them Bricjapit? (f.28)

Përkthyesja ka dhënë kuptimin e kësaj shprehje duke e perifrastuar në mënyrë shumë neutrale. Nuk ka ekuivalencë. Një përkthim më i mirë i kësaj shprehje frazeologjike do të ishte: *bie në dorë të dikujt*, i cili shpreh edhe figurshmërinë e shprehjes në gjuhën gjermane.

mit jmdm. unter einer Decke stecken	Kuptimi: merrem vesh me dikë
„Du hast es gestohlen!“, schrie Meggie, außer sich vor Wut. „Und du hast diese Männer geholt, ja, genau. Du und dieser Capricorn, ihr steckt unter einer Decke! [...]“ (f.95)	Ti e ke vjedhur! – e akuzoi vajza e tërbuar nga inati – Dhe dërgove të thërrisnin ata burrat; po ishe ti! Ti dhe Bricjapi jeni marrë vesh me njëri tjetrin. (f.78)

Përkthimi i kësaj shprehjeje frazeologjike është plotësisht ekuivalent dhe ruan të njëjtën figurshmëri dhe kuptim.

sich (Dativ) in die Hosen machen (salopp) / scheißen	Kuptimi: Dhihem në brekë
„Die Schatzinsel! Himmel, ich habe mir fast in die Hosen gemacht vor Angst!“ Elinor tauchte hinter Darius auf und schob ihn unsanft zur Seite. (f. 196)	Ishulli i thesarit! O zot. Pothuajse i laga rrobat nga tmërri! – tha Elinori, ndërsa u shfaq nga mbrapa Darius dhe e shtyu atë mënjane. (f.160)

Duhet theksuar se edhe fjalët paraqesin një shkallë të pranueshme banaliteti; përkthimi i duhur do të ishte: u dhiva në brekë (nga frika). Ky përkthim do të arrinte një shkallë emocionaliteti më të lartë.

sich auf die Lippen beißen	Kuptimi: mos e thuaj diçka; kontrolloje veten që të mos flasësh
„Sie?“ Staubfinger lachte auf. „Herrgott, demnächst sagst du noch Herr Staubfinger zu mir. Ich kann dieses Siezen nicht leiden, also lass es, ja?“ Meggie biss sich auf die Lippen und nickte. (f. 64)	Vazhdon të më flasësh me „ju“? Për atë qiell, pas pak do më thërrasësh “zoti gishtpluhur”! Dëgjio, më bezdis kjo gjë. Hiq dorë, më kuptove? Megi kafshoi buzët dhe tundi kokën në shenjë pohimi.(f.71)

Përkthimi “kafshoi buzët” është një përkthim i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për shprehjen gjermane “sich auf die Lippen beißen”. Shprehja në kuptimin e saj të gjerë tregon përpjekjen për të qëndruar heshtur ose për të kontrolluar fjalët, duke mos thënë diçka që mund të shkaktojë pasoja në atë moment.

ein Herz aus Stein haben	Kuptimi: të mos kesh ndjenja
Mo ... Wo war er? Meggie biss sich auf die Lippen, damit sie nicht zitterten, aber sie wusste, dass die Angst in ihren Augen saß und dass Capricorn sie dort sah. Ein Herz aus Eis wünschte sie sich und lächelnde Lippen statt der zitternden eines Kindes, dem man den Vater gestohlen hatte. (f. 140)	Moja.... Ku ishte? Megi kafshoi buzët që të mos e shihnin se i dridheshin, por e dinte se në vështrim i lexohej frika dhe se, me siguri, Bricjapi po e shihte. Më mirë të kishte pasur një zemër prej akulli dhe një buzëqeshje guximtare e jo atë pamjen e tronditur të një vogëlusheje që ia kanë rrëmbyer të atin. (f.115)

Përkthimi i modifikuar duket i përshtatshëm dhe ekuivalent me origjinalin. Në tekstin origjinal, shprehja “ein Herz aus Stein haben” është kuptuar si “të mos kesh ndjenja,” dhe ky kuptim përcillet në përkthimin e modifikuar: “Më mirë të kishte pasur një zemër prej akulli.” Këtu, kemi një modifikim të shprehjes *zemër prej guri në zemër prej akulli*. Kuptimi i përgjithshëm i frazës është ruajtur, dhe ndryshimet janë të kuptueshme dhe përshtatshme.

in einer (alten) Wunde bohren; in (alten) Wunden bohren	Kuptimi: lëndoj dikë duke i kujtuar ngjarje (të vjetra) të dhimbshme
„Nun, das ist vermutlich auch besser so. Warum in alten Wunden bohren? Und du erinnerst dich ja eh nicht an sie. Das Zeichen auf der Bibliothekstür hat sie gemalt. Aber jetzt komm. Sonst verpasst du deine Vorstellung.“ (f. 75)	E po, besoj se është më mirë kështu. Pse ta rrotullosh thikën në plagë? Në fund të fundit, ti nuk mund ta mbash mend. Atë simbolin në derën e bibliotekës e ka vizatuar ajo. Por tani eja me mua, përndryshe ke për ta humbur shfaqjen.

Përkthimi është i përshtatshëm dhe i kuptueshëm. Fjala “rrotullosh” përdorur në përkthim për “bohren” shpreh mirë veprimin e të kujtuarit të një teme që i sjell dhimbje dikujt duke u përqendruar në një ngjarje të vjetër të dhimbshme.

jemandem schlägt/klopft das Herz bis zum Hals; jemandes Herz schlägt/klopft bis zum Hals	Kuptimi: dikush është shumë i emocionuar / i tensionuar / i ngazëllyer / nervoz
Elinor schwang widerstrebend die Beine aus dem Auto. Meggie stieg auch aus und stellte sich neben sie. Das Herz schlug ihr bis zum Hals. Sie hatte noch nie einen Mann mit einem Gewehr gesehen. (f. 133)	Elinori zbriti me mëdyshje. Megi e ndoqi pas. Zemra i rrihte si e marrë. Nuk ishte ndodhur asnjëherë përballë një njeriu me armë zjarri në dorë. Kishte parë të tillë vetëm në televizor. (f.109)

Përkthimi paraqet mjaft qartë emocionin dhe tensionin e personazhit. Kuptimi i frazës “Das Herz schlug ihr bis zum Hals” është përkthyer në mënyrë të përshtatshme me “Zemra i rrihte si e marrë”, duke përdorur një shprehje e cila shpreh përshtypjen e një tensioni ose emocioni të theksuar. Pra, përkthimi është i përshtatshëm dhe përputhet me kontekstin e tekstit origjinal.

PËRFUNDIME

Letërsia për fëmijë mbart një nivel të caktuar vështirësie në përkthim, i cili lidhet me kulturën, gjuhën, aftësinë krijese të përkthyesit dhe një sërë strategjish që përdoren në të.

Romanet për fëmijë përdorin fraza dhe shprehje të thjeshta për t’u kuptuar nga lexuesi mbështetur në moshën e tij dhe nivelin gjuhësor që ai zotëron.

Gjuha e përpunuar me figuracion artistik (metafora, krahasime, shprehje frazeologjike) rrezikon të mos kuptohet nga lexuesit e vegjël e për këtë arsye ajo duhet të jetë e qartë.

Gjatë analizës se si është realizuar përkthimi u vu re që figuracioni artistik i përdorur nga autorja në veprën origjinale jo gjithmonë është ruajtur duke përdorur një sërë strategjish të njohura në përkthimin e letërsisë për fëmijë. Kjo dukuri u vu re më së shumti në shembuj e ilustruar për përkthimin e metaforave e krahasimeve, shprehjeve frazeologjike e idiomava për të cilat përkthyesi shpesh ka realizuar:

Ekuivalencë të plotë;

Ekuivalencë të pjesshme;

Shndërrim të metaforës në krahasim;

Përshtatje sinonimike;

Mungesë të plotë ekuivalence;

Në përshtatjen e shprehjes frazeologjike;

Perifrazime neutral;

Përkthim të barazvlefshëm dhe përshtatje kontekstuale etj.

Nga analiza konkrete e shembujve të marrë mbërrimë në disa përfundime themelore:

Përkthimi i letërsisë për fëmijë mbart vështirësi që lidhen me natyrën e gjuhës origjinale dhe natyrën e gjuhës në të cilën përkthehet.

Përkthimi i figuracionit artistik, shprehjeve frazeologjike, idiomave varet më së shumti me jo vetëm aftësinë e përkthyesit për të zgjedhur formën më të plotë në të cilën ruan aspektin semantik, ngarkesën emocionale dhe vlerën estetike por edhe në hapësirën që të krijon struktura gjuhësore, moshën e lexuesit, kultura nga e cila vjen dhe kultura në të cilën përkthehet vepra.

BIBLIOGRAFIA

1. Bushi, J. "Phraseologismen im Fremdsprachunterricht" Journal L`Association 1901 SEPIKE, Website: <http://www.sepikcloud.com> Publisher:L`Association 1901 Sepike, Country: DE. 2020 Numri i Faqeve: 4-10.
2. Funke, C. (2010) Tintenherz, Dressler Verlag, Hamburg
3. Funke, C. (2011) Zemër si boja, Botimet Dudaj, Tiranë
4. Bishqemi, A. (2006) Histori e Letërsisë Botërore për Fëmijë. Sejko, Tiranë.
5. Burger, H. (2003). Phraseologie. Eine Einführung am Beispiel des Deutschen. (4. Ausg.). Berlin: Erich Schmidt Verlag.
6. Ehlers, S. (1996): Literarische Texte lesen lernen. München: Klett Edition Deutsch
7. Fleischer, W. (1997). Phaseologie der deutschen Gegenwartssprache. Bibliographisches Institut.
8. Klingberg, G. (1986): „*Children's Fiction in the Hands of the Translators*“. Malmo: CWK Gleerup
9. Oittinen, R. (2000): *Translating for Children*. New York/London: Garland Publishing.
10. Oittinen, R. (2006): „No Innocent Act: On the Ethics of Translating for Children“, in: Jan Van Coillie, Walter P. Verschueren (Hg.): *Children's Literature in Translation; Challenges and Strategies*. Manchester: St Jerome Publishing,
11. Puurtinen, T. (1995): *Linguistic Acceptability in Translated Children's Literature*, Joensuu: University of Joensuu.
12. Puurtinen, T. (2006): „Translating Children's Literature: Theoretical Approaches and Empirical Studies“, in: Gillian Lathey (Hg.): *The Translation of Children's Literature: A Reader*, Clevedon: Multilingual Matter.

PROF. ASSOC. DR. AIDA GJINALI
UNIVERSITY OF TIRANA
FACULTY OF FOREIGN LANGUAGES
ITALIAN LANGUAGE DEPARTMENT
aida.gjinali@unitir.edu.al

**THE ART OF COMMUNICATION
IN FOREIGN LANGUAGE CLASSES**

ABSTRACT

The purpose of this paper is to focus on communication in foreign language classes as a very important aspect related to the development of this skill in the perspective of not only mainly linguistic but above all the development of communication skills and communicative production skills in the language alien to every context and situation in which every individual will find himself in the future. Starting from this point of view, bearing in mind that in foreign languages this is even more complicated as many other factors related to the individual's personality, his cognitive styles and especially the cultural differences that exist between languages are involved, there is a need for teachers of foreign languages to consider the fact that communicating does not mean only expressing yourself correctly in that language, but knowing how to communicate within a certain context, to convey the right message, to understand what the interlocutor is conveying and to create relationships and human relations necessary for the socialization and social integration of the individual. Therefore, for this purpose, in language classes it is necessary to use diverse strategies and techniques that enable such a thing, taking into consideration the age, the language level, the student in the whole sphere of his personality for the best quality training in this aspect.

Keywords: *communication, foreign language, technique, teaching, skills.*

ARTI I KOMUNIKIMIT NË KLASAT E GJUHËS SË HUAJ

ABSTRAKT

Punimi në fjalë ka si qëllim të vëre në fokus komunikimin në klasat e gjuhës së huaj si një aspekt mjaft të rëndësishëm lidhur me zhvillimin e kësaj aftësie në këndvështrimin jo vetëm kryesisht gjuhësor por mbi të gjitha të zhvillimit të aftësive komunikuese dhe atyre prodhuese komunikative në gjuhë të huaja në çdo kontekst dhe situatë në të cilën çdo individ do të mund të gjendet në të ardhmen. Nisur nga ky këndvështrim duke pasur parasysh që në gjuhë të huaj kjo është akoma më e ndërlikuar pasi ndërfiten mjaft faktorë të tjerë që lidhen me personalitetin e individit, stilet e tij konjitive dhe sidomos me diferencat kulturore që ekzistojnë ndërmjet gjuhëve, lind nevoja që mësuesit e gjuhëve të huaja të marrin në konsideratë faktin që të komunikosh nuk do të thotë vetëm të shprehesh korrektesash në atë gjuhë por të dish të komunikosh brenda një konteksti të caktuar, të përcjellësh mesazhin e duhur, të kuptosh atë çfarë përcjell bashkëbiseduesi dhe të krijosh marrëdhënie dhe raporte njerëzore të nevojshme për socializmin dhe integrimin shoqëror të individit. Ndaj për këtë qëllim në klasat e gjuhës është e nevojshme që të përdoren strategji e teknika të larmishme që e mundësojnë një gjë të tillë duke marrë në konsideratë moshën, nivelin gjuhësor, nxënësin në tërë sferën e personalitetit të tij për një formim sa më cilësor në këtë aspekt.

Fjalë kyçe: *komunikim, gjuhë e huaj, teknika, mësimdhënie, aftësi.*

1. HYRJE

1.1. Përkufizimi i komunikimit

Nga pikëpamja psikologjike, të komunikosh do të thotë të bashkëndash, të krijosh një lidhje ose të vendosësh një marrëdhënie. Sipas përkufizimit të dhënë Iacob L¹²⁴ në librin **Psikologjia Sociale, komunikimi shihet si një marrëdhënie e bazuar në ndarjen e një kuptimi. Në aktin e komunikimit, informacioni është një premisë absolutisht e nevojshme, por që nuk është i mjaftueshëm, sepse, nëse ka një keqkuptim midis informacionit dhe kornizës relacionale që drejton dhe rregullon kuptimin e tij, komunikimi anulohet.**

¹²⁴ Iacob L., (1999), "Didactic communication" tek Cosmovici A., *Scolar Pscycology*, Iasi, Polirom.

1.2. Çdo të thotë të komunikosh

Komunikimi është një proces ndërveprimi midis njerëzve, grupeve, si një marrëdhënie e ndërmjetësuar nga fjala, imazhi, gjesti, simboli ose shenja. I konsideruar si një proces, komunikimi konsiston në transmetimin dhe shkëmbimin e informacionit (mesazheve) ndërmjet njerëzve.

Të komunikosh do të thotë t'u thuash të tjerëve se kush je, çfarë dëshiron, pse dëshiron një gjë të caktuar dhe çfarë mjetesh do të përdorësh për të arritur qëllimet e tua. Në këtë kuptim, të komunikosh do të thotë të heshtësh, të presësh përgjigjen, reagimin e atij që ke dashur të shpallësh ekzistencën e të cilit vërtet dëshiron të thuash diçka.

1.2.1. Tiparet e komunikimit

Komunikimi karakterizohet nga fakti se:

- ka gjithmonë një objektiv të materializuar në kërkesën për të ndikuar në të menduarit, ndjenjat dhe sjelljen e bashkëbiseduesit;
- qëllimi arrihet nëse mesazhi dëgjohet, kuptohet dhe pranohet nga marrësi;
- është një proces dinamik: pasi të fillojë, ai evoluon dhe ndryshon;
- është një proces i pakthyeshëm; mesazhi, pasi të jetë lëshuar dhe marrë, nuk mund të tërhiqet më;
- Ekziston një dialog i dyanshëm midis transmetuesit dhe marrësit;

1.2.2. Çfarë është arti i komunikimit

Arti i komunikimit është një fushë që ka të bëjë me strategjitë dhe teknikat e ndryshme të përdorura për të përcjellë në mënyrë efektive një mesazh ose ide tek një audiencë specifike. Ai përfshin aftësinë për të shprehur veten në mënyrë të qartë, bindëse dhe empatike, në mënyrë që të krijojë lidhje dhe mirëkuptim me të tjerët.

Brenda artit të komunikimit, merren parasysh disa aspekte, duke përfshirë:

- *Komunikimi verbal*: përfshin përdorimin e fjalëve dhe gjuhës për të shprehur mendimet, konceptet dhe emocionet. Ai përfshin zgjedhjen e fjalëve të duhura, strukturën e fjalisë, shqiptimin e saktë dhe përdorimin e duhur të gramatikës.
- *Komunikimi joverbal*: ka të bëjë me të gjitha ato sinjale dhe gjeste që shoqërojnë komunikimin verbal, si gjuha e trupit, shprehjet e fytyrës, kontakti me sy, gjestet e duarve dhe qëndrimi. Komunikimi joverbal

mund të përcjellë mesazhe të fuqishme dhe të ndikojë në perceptimin e bashkëbiseduesit.

- *Dëgjimi aktiv*: është një element themelor në artin e komunikimit. Ai përfshin t'iu kushtoni vëmendjen tuaj të plotë personit që flet, të tregoni interes, të bëni pyetje përkatëse dhe të tregoni ndjeshmëri. Dëgjimi aktiv ndihmon në krijimin e një lidhjeje më të thellë dhe nxit mirëkuptimin e ndërsjellë. Këtu është për t'u shtuar motivimi dhe interesi ndaj argumentit që duhet të ofrohet nga bashkëbiseduesi për të vijuar bashkëbisedimin.
- *Empatia*: Të kuptuarit e emocioneve dhe perspektivave të të tjerëve është një faktor vendimtar në komunikimin efektiv. Empatia përfshin vënien e vetes në vendin e tjetrit, përpjekjen për të kuptuar këndvështrimin e tyre dhe reagimin e duhur në përputhje me rrethanat.
- *Përshtatshmëria*: aftësia për të përshtatur stilin e komunikimit sipas kontekstit, audiencës dhe objektivit të dëshiruar. Kjo nënkupton aftësinë për të përdorur tone, regjistra dhe mënyra të ndryshme komunikimi për të arritur rezultate optimale.
- *Qartësia dhe konciziteti*: shprehja e qartë e ideve, shmangia e paqartësisë dhe konfuzionit. Përdorimi i gjuhës së thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë ndihmon për të siguruar që mesazhi të kuptohet pa vështirësi.

Arti i komunikimit mund të zbatohet në kontekste të ndryshme, si komunikimi ndërpersonal, komunikime grupi, prezantime publik, negociata, marketing dhe shumë situata të tjera ku është thelbësore të përçohet informacioni në mënyrë efektive. Praktika e vazhdueshme dhe mësimi i vazhdueshëm mund të kontribuojnë në zhvillimin e aftësive komunikuese gjithnjë e më të rafinuara.

2. Rekomandimet e Parlamentit Evropian

Siç përcaktohet në Rekomandimin e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 18 dhjetorit 2006 mbi Kompetencat kryesore për të mësuarit gjatë gjithë jetës (2006/962/EC):¹²⁵

Përkufizimi:

Komunikimi në gjuhët e huaja ndan gjerësisht dimensionet kryesore të aftësive të komunikimit në gjuhën amtare: ai bazohet në aftësinë për të kuptuar, shprehur dhe interpretuar konceptet, mendimet, ndjenjat, faktet dhe opinionet si në formë gojore ashtu edhe me shkrim (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit). dhe shkrimi) në një gamë të përshtatshme të konteksteve shoqërore dhe kulturore (në arsim

¹²⁵ Official Journal of the European Union, (2006)

[https://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:394:0010:0018:en:PDF#:~:text=The%20Reference%20Framework%20sets%20out,7\)%20Sense%20of%20initiative%20and](https://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:394:0010:0018:en:PDF#:~:text=The%20Reference%20Framework%20sets%20out,7)%20Sense%20of%20initiative%20and)

dhe trajnim, punë, shtëpi dhe kohë të lirë) sipas dëshirave ose nevojave të dikujt. Komunikimi në gjuhë të huaj kërkon gjithashtu aftësi të tilla si ndërmjetësimi dhe mirëkuptimi ndërkulturor. Niveli i aftësisë së një individi do të ndryshojë ndërmjet katër dimensioneve (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) dhe ndërmjet gjuhëve të ndryshme, dhe sipas prejardhjes sociale dhe kulturore, mjedisit, nevojave dhe/ose interesave të atij individi.

Njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet thelbësore në lidhje me këtë kompetencë:

- Kompetenca në gjuhët e huaja kërkon njohuri të fjalorit dhe gramatikës funksionale dhe një ndërgjegjësim për llojet kryesore të ndërveprimit verbal dhe regjistrat e gjuhës. Njohja e konventave shoqërore, dhe aspekti kulturor dhe ndryshueshmëria e gjuhëve është e rëndësishme. Njohuri mbi konventat shoqërore dhe aspektin kulturor dhe ndryshueshmëria e gjuhëve është e rëndësishme.
- Aftësitë thelbësore për komunikim në gjuhë të huaja konsistojnë në aftësinë për të kuptuar mesazhet e folura, për të nisur, mbështetur dhe përfunduar biseda dhe për të lexuar, kuptuar dhe prodhuar tekste të përshtatshme për nevojat e individit. Individët gjithashtu duhet të jenë në gjendje të përdorin mjetet ndihmëse në mënyrë të përshtatshme, dhe të mësojnë gjuhë gjithashtu joformalisht si pjesë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Një qëndrim pozitiv përfshin vlerësimin e diversitetit kulturor, si dhe një interes e kuriozitet për gjuhët dhe komunikimi ndërkulturor.

3. Komunikimi në klasat e gjuhës së huaj

«Të folurit është një mjet thelbësor i mësimdhënies»,¹²⁶ siç thuhet nga Brighetti dhe Minuz. Gjithashtu sipas Ehlich dhe Rehbein¹²⁷ (1986) “komunikimi në klasë paraqitet si e pandërprerë, e dendur nga jashtë, pothuajse e pandërprerë vazhdimësi e fjalës”.

Në klasë, në përgjithësi ndodhin dy lloje ndërveprimesh komunikuese: komunikimi mësues-nxënës dhe komunikimi nxënës-nxënës. Në veçanti, lloji i parë i kritikohet ndonjëherë për artificialitetin e tij, veçanërisht në rastet kur mësuesi ka një rol qendror, ndërsa studenti kufizohet në përgjigjen pasive të pyetjeve dhe ndjekjen e udhëzimeve që i janë dhënë.

Megjithatë, duhet theksuar se, siç na kujton Seedhouse¹²⁸ “Ndërveprimi

¹²⁶ Brighetti C., Minuz F. (2008), *Abilità del Parlato*, Guerra Edizioni, Perugia.

¹²⁷ Ehlich K., Rehbein J. (1986), *Muster und Institution. Untersuchungen zur schulischen Kommunikation*, Gunter Narr, Tübingen.

¹²⁸ Seedhouse, P. (1995), *L2 classroom transcripts: data in search of a methodology?* TESL-EJ, 1 (4), pp. 1-37.

komunikues në klasë LS ka një veçori unike, përkatësisht lidhjen midis qëllimeve pedagogjike që qëndrojnë në themel të aktiviteteve të ndryshme në klasë dhe formave dhe modeleve gjuhësore të ndërveprimit që rrjedhin nga ato aktivitete në klasë. Ky është rasti pavarësisht nga ‘metoda’ që mësuesi përdor”².

Për rrjedhojë, vlerësimi i ndërveprimit komunikues që ndodh në momente të ndryshme të orës së mësimit duhet të bëhet mbi bazën e objektivave që mësuesi ka vendosur herë pas here për të arritur, të cilat nga ana e tyre janë të lidhura ngushtë me forma dhe modele të caktuara gjuhësore komunikimit.

Natyrisht, kjo mund të shkaktojë, në disa raste, shkëmbime komunikuese që nuk kanë të bëjnë fare me komunikimin real. Madje, mund të ndodhë edhe që, megjithëse nxënësi prodhon thënie që do të ishin të pranueshme në një bisedë normale, këto të mos pranohen nga mësuesi, pasi nuk janë në përputhje me synimet pedagogjike që ai ka vendosur.

3.1. Koha që zë komunikimi në klasë

Komunikimi *i mësuesit* ka tendencë të zërë më shumë kohë sesa ajo e studentëve, si në mësimsdhënien e gjuhës ashtu edhe në disiplina të tjera. Në fakt, Popi F.,¹²⁹ na thotë që në disa studime që kanë trajtuar këtë temë kanë nxjerrë në pah faktin se zakonisht, në klasë, nxënësi zë fjalën në 30% të kohës. Kjo e dhënë gjen një përgjigje të pjesshme në vëzhgimin se, nga katër *lëvizjet e ligjërit*, të listuara nga Bellack¹³⁰, tre, ‘strukturimi’, ‘kërkimi’ dhe ‘reagimi’ janë zakonisht të rëndësishme për mësuesin. Vetëm një, ‘përgjigja’, është zakonisht prerogativë e studentit.

Gategno¹³¹ në vëzhgimin e tij në lidhje me komunikimin në klasë vuri re pikërisht që është mësuesi ai që komunikon më shumë dhe ndaj dhe duke u bazuar në këtë vëzhgim ai hartoi një metodë të quajtur Silen Way, ku mësuesi komunikon mjaft pak duke nxitur sferën konjitive të nxënësit për zgjidhjen e problemit. Sigurisht që kjo metodë ka avantazhet dhe disavantazhet e veta nëse do të merreshim me analizimin e hollësishëm të tij, por ky nuk është qëllimi ynë në këtë punim. Ajo çfarë po kërkojmë të vëmë në dukje është fakti që tashmë rolet kanë ndryshuar dhe qëllimi i është të kuptohet qartë që në qendër të mësimsdhënies është nxënësi në gjithë tërësinë e tij dhe si e tillë është ai që duhet të komunikojë shumë më tepër në klasë se sa mësuesi. Kjo mundësohet jo vetëm duke i ofruar atij stimuj

¹²⁹ Popi F., *Interazione orale nelle classi L2* <https://digilander.libero.it/dibiasio.neoassunti/TEM-ATICA7/Favorire/interazione.pdf>

¹³⁰ Bellack, A., Kliebard, H., Hyman, R., Smith, F. (1966). *The Language of the Classroom*. Teachers College Press, New York.

¹³¹ Richard J., Rodgers T.S., (2001), *Approaches and Methodologies in Language Teaching*, Cambridge University Press, London.

të mjaftueshëm për realizimin e një komunikimi efikas por duke përdorur teknika të tilla që ia mundësojnë atij këtë lloj komunikimi. Gjithsesi në realizimin e një komunikimi dialogues në gjuhë të huaja ndërmjet dy apo më shumë bashkëbiseduesish ndikojnë shumë faktorë duke u nisur nga ato individuale në ato të jashtëm. Këto faktorë janë:

- Personalë (personaliteti, emocionet, të qenët introversë apo jo) ¹³²
 - Druajta për të qenë të saktë në përcjelljen e mesazhit, saktësi kjo si në këndvështrimin e e saktësisë gramatikore ashtu edhe kuptimore
 - Dëshifrimi i kodit gjuhësor të ofruar
 - Interpretimi i gabuar i gjuhës verbale dhe jo
 - Interpretimi gabuar i aspekteve të gjuhës paraverbale
 - Motivimi
 - Argumenti i bisedës
 - Lloji i inteligjencës që përdorim në komunikim (Gardener) ¹³³
 - Lloji i tipologjisë së individit: auditiv, visiv, etj.

- Të jashtëm
 - Konteksti në të cilën ndodh eventit komunikativ, pra kuptueshmëria e e tij
 - Ritmi i të folurit, shpejtësia, intonacioni që mund të deshifrohen dhe interpretohen në mënyrë të gabuar
 - Niveli gjuhësor i komunikimit
 - Regjistri gjuhësor
 - Tipologjia e tekstit komunikues
 - Etj.

Sigurisht që komunikimi influencohet akoma nga shumë faktorë të tjerë të cilët ndikojnë pozitivisht apo negativisht në komunikim.

Ajo çka duhet të ketë parasysh mësuesi në mësimin e gjuhës së huaj është që të ketë parasysh të gjithë këto faktorë në mënyrë të tillë që të ofrojë larmi teknikash për zhvillimin e komunikimit, të stimulojë nxisë dhe ofrojë mbështetjen e duhur për t'i mundësuar çdo nxënës në klasën e tij artikulumin e gjuhës së huaj duke pasur parasysh që qëllimi kryesor i këtij artikulumit është përcjellë dhe kuptueshmëria e mesazhit duke i dhënë më rëndësi atij sesa formës siç dhe udhëzohet nga metodat dhe qasjet e që e vënë theksin më shumë tek efikasiteti i mesazhit sesa tek forma e tij.

¹³² Mariano L., Pozzo G., (2002), Stili, strategie e strumenti nell'apprendimento linguistico, La nuova Italia, Firenze.

¹³³ Gardener H., (2006), Multiple Intelligences: New Horizons in Theory and Practice. New Horizons.

4. Teknika për zhvillimin e aftësisë komunikuese në klasë

➤ Dramatizimi ¹³⁴

Është një formë simulimi që nuk lejon asnjë liri: nxënësit duhet të recitojnë (përmendësh ose duke lexuar) tekstin e gjetur në manual ose në një tekst të përgatitur nga mësuesi ose nga vetë klasa. Kjo teknikë kërkon shumë kohë për t'u përgatitur. Sidomos nëse regjistrohet dhe më pas analizohet së bashku me nxënësit, mundëson memorizimin e shprehjeve që kryejnë aktet komunikuese, por përpjekja e ekzekutimit nuk duket adekuate për rezultatet.

Shërben për të memorizuar shprehjet në aktet kryesore të komunikimit

➤ Marrja e rolit /Role taking

Ky term i krijuar nga Littlewood i referohet atij lloji të simulimit në të cilin studentët janë ende shumë të udhëhequr nga teksti burimor dhe kufizojnë ndërhyrjen e tyre në ndryshimin e disa elementeve.

Merrni si shembull një situatë të vendosur në një bar; për aktet komunikuese në lidhje me ofertën e një pije, pranim (ose refuzim, ose modifikim) dhe falënderim. Në gjuhën e huaj është paraqitur paradigma e asaj që mund të ofrohet në një lokal, duke përdorur një listë çmimesh që liston pijet; një fotografi ose poster që tregon banakun në një lokal; copa nga insertet e reklamave për pije dhe pije alkoolike.

Në mësimin e një gjuhe të huaj si gjuhë e dytë, mësuesi mund t'i bëjë vetë studentët të kujtojnë këtë paradigmë, duke u kërkuar atyre të ndajnë përvojat e tyre, duke rikrijuar një listë çmimesh të besueshme në dërrasën e zezë, duke i bërë ata të gjejnë reklama.

Kryen këtë operacion zëvendësimi. Mësuesi sugjeron dramatizimin e tekstit burimor, duke ndjekur transkriptimin e tij, duke zëvendësuar atë që mund të zëvendësohet.

Ky nuk është një operacion thjesht mekanik: nëse teksti burimor fliste për "KAFFE", kualifikuesit mund të ishin "e shkurtër ; e gjatë; makiato"; nëse në rolin e një studenti nuk porosit një kafe, por një uiski, kualifikimi i mundshëm është "me/pa akull"; një kola në vend do të jetë "me / pa akull. Pipë , limon"; e kështu me radhë. Për më tepër, çmimi gjithashtu ndryshon rast pas rasti dhe studenti që simulon rolin e kamarierit duhet ta ketë parasysh këtë. Një modifikim, pra, nënkupton të tjerat, kaskadë, dhe ushtrimi është më kompleks se sa mund të duket në shikim të parë.

¹³⁴ D'annunzio B., https://www.italy.it/sites/default/files/Filim_TECNICHE_DIDATTICHE.pdf

➤ **Krijimi i roleve/ Role making** ¹³⁵

Ky lloj simulimi ofron më shumë hapësirë për zgjedhjet autonome të bashkëbiseduesve: paraqitet situata dhe tregohen aktet kryesore komunikuese që duhen kryer, por nxënësit i lihet detyra të shtojë të gjitha aktet e nevojshme rutinë shoqërore (përsëritje, faleminderit. etj.), dhe të kryejnë aktet komunikuese sipas shprehjeve të ndryshme që nxënësit kanë gjetur në tekstin hapës (L italisht) dhe në përvojën e tyre të përditshme (italisht L2). ¹³⁶

Ky lloj i teknikës së simulimit korrespondon pjesërisht me atë që Robert di Pietro e ka përcaktuar si skenar, i cili megjithatë përfshin edhe artikullin tjetër, lojën e roleve të duhura.

➤ **Loja me role/ role play**

Ky variant është më i liri nga të gjithë ata që përfshihen në zonën e simulimit. Koordinatat e situatës, qëllimet e ndërveprimit, çdo informacion shtesë u jepen studentëve dhe më pas studentët lihen të lirë të zhvillojnë shkëmbimin komunikues sipas strategjive të tyre, duke kujtuar elementë nga njësiti e mëparshme ose nga përvoja ose nga përvoja e përditshme, duke shtuar detaje etj.

Loja me role (loja ose interpretimi i roleve) konsiston në simulimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të adoptuara përgjithësisht në jetën reale; rolet i marrin dy ose më shumë nxënës përballë grupit të bashkëmoshatarëve – vëzhgues. Nxënësit duhet të marrin përsipër rolet e caktuara nga mësuesi dhe të sillen ashtu siç mendojnë se do të sillen në të vërtetë në situatën e dhënë.

Prandaj, kjo teknikë ka për qëllim të fitojë aftësinë për të imituar një rol dhe për të kuptuar në thellësi atë që kërkon roli. Luajtja me role nuk është përsëritje e një skenari, por një recitim i vërtetë subjekti. Ka të bëjë me sjelljet e individëve në marrëdhëniet ndërpersonale në situata të sakta operationale për të zbuluar se si njerëzit mund të reagojnë në rrethana të tilla.

➤ **Dialogu i hapur**

Kjo teknikë është pjesërisht e jashtme për grupin e ilustruar deri më tani: nxënësve u jepet një fletë në të cilën shfaqen vetëm rreshtat e njërës personazh dhe ftohen të krijojnë rreshtat e tjetrit. Për ta bërë këtë, ata duhet të kenë parasysh rreshtat e mëparshëm por edhe vijues; është një teknikë që forcon ndërgjegjësimin për

¹³⁵ Balboni P.E., (2014) Didattica dell'italiano a stranieri, Bonacci, Roma.

¹³⁶ Daniela Bertocchi, 1995, Il dialogo, il finto dialogo e il monologo. <file:///C:/Users/m/Downloads/303214.pdf>

dimensionin tekstual, që është unitar, koherent dhe koheziv i një dialogu.¹³⁷

Gjatë këtyre aktiviteteve mësuesi duhet të ndërhyjë sa më pak: në fakt ai nuk do të jetë pranë nxënësve të tij kur duhet të përdorin italishten në situata reale.

Është mësuesi ai që tregon qartë përfundimin e ushtrimit të simulimit, përndryshe çiftet më të ngadalta monopolizojnë përdorimin e orës së mësimit dhe çiftet që kanë mbaruar humbasin përqendrimin; për të ndaluar aktivitetin, një ose më shumë çifteve mund t'i kërkohej të kryejnë versionin e tyre të dialogut para klasës: nga njëra anë, kjo çon në vëmendje më të madhe gjatë shfaqjes së parë, e cila u zhvillua në «privat» e tavolinë; së dyti, ofron një lloj modeli për korrigjim; çiftet që e kanë zhvilluar dialogun ndryshe mund të kërkojnë sqarime, ndërhyrjet korrigjuese mbi atë dialog mund të korrigjojnë në mënyrë indirekte dialogët e çifteve të tjera etj.

Aktivitetet simuluese janë të dobishme për mbledhjen e reagimeve, d.m.th. informacione mbi autonominë funksionale të studentëve individualë. Rezultatet e këtyre vëzhgimeve mund të raportohen në një formë ose në një regjistër, për t'u bërë më pas pjesë e vlerësimit përfundimtar. Të paktën dy faktorë duhet të mbahen të ndarë në verifikim:

- efektiviteti pragmatik i komunikimit
- korrektësinë gjuhësore të shprehjes

➤ **Transkodifikimi**

Kalimi nga një kod në një tjetër p.sh.

- Nga ai i shkruar në atë folur, (përmbledhja, diskutimi mbi argumentin që trajtohet në tekstin e shkruar)
- nga ai pamor në atë të folur (një pikturë, figurë, imazh e diskutimi mbi të)
- nga mimika në atë të folur (gjetja/sfidë/ problem solving)
- lojëra me fjalë

5. **Korrigjimi i gabimeve në komunikim kur dhe si** ¹³⁸

Metodat më të hershme e shikonin gabimin si një pengesë serioze në mësimin e gjuhës së huaj dhe insistonin në shmangien dhe korrigjimin e menjëhershëm të tij dhe e ndëshkonin atë. Kështu që edhe mësuesit e formimit tradicional prirën ta korrigjojnë atë për saktësi nga ana morfologjike, sintaksore, shqiptimore, leksikore kjo duke e konsideruar atë një devijancë saktësie që duhet shmangur

¹³⁷ Mezzadri M., (2015), I nuovi ferri del mestiere, Bonacci editore, Torino, Italia, fq. 214- 220.

¹³⁸ Mezzadri M., (2015), I nuovi ferri del mestiere, Bonacci editore, fq. 276

medoemos pasi mund të sjellë në ngulitjen e gabimit në memorien e nxënësit.¹³⁹

Çfarë ndodh zakonisht me trajtimin e gabimit në komunikim:

- Ai korrigjohet menjëherë pa u shpjeguar se ku qëndron gabimi, gjë që nuk sjell reflektim mbi atë që korrigjohet dhe si rrjedhojë mbetet sërish pjesë e nxënësit;
- Ndërpritet rrjedha e komunikimit dhje kjo sjell ndërprerje të vijueshmërisë së aktit komunikativ;
- Krijon tension tek nxënësi i cili i korrigjuar në mënyrë të vazhdueshme mund ta ndërpresë fare komunikimin;
- Krijon një atmosferë demotivimi pasi nxënësi i korrigjuar krijon një vlerësim të ulët për veten si i paaftë për të krijuar një akt komunikues.
- Frenon dëshirën për t'u shprehur para mësuesit pasi duke e parë atë si pikë referimi gjuhësore të një niveli të lartë nuk e krahason dot veten me të ndaj dhe mund të mos e fillojë fare një akt komunikimi.

5.1. Shmangia e problematikave në korrigjim

Mësuesi me formim bashkëkohor e ka tashmë të qartë që vlera e komunikimit është përcjellja e mesazhit dhe kuptueshmëria e tij nga bashkëbiseduesi në mënyrë të tillë që akti komunikativ të ketë vijueshmëri kjo duke konsideruar më shumë jo formën sesa mesazhin në vetvete. Gjithashtu duke pasur parasysh që gabimi tashmë konsiderohet një hap i mëtejshëm drejt përmirësimit dhe shërben si moment reflektimi si për mësuesin ashtu edhe për nxënësin.¹⁴⁰ Mënyra e korrigjimit është mjaft e rëndësishme pasi kjo ndikon në vijueshmërinë e nxënies në mënyrë motivuese dhe efikase në të ardhmen, ndaj teknikat e korrigjimit që përdoren janë disa prej të cilave mësuesi mund të përzgjedhë duke pasur parasysh llojin e gabimit, llojin e ushtrimit, llojin e nxënësit. Gjithsesi ajo çka tashmë dihet është që:

- mësuesi nuk duhet të ndërhyjë në një akt komunikimi të ndërtuar nga nxënësi veç në rastet kur sheh vështirësi të dukshme në vijueshmërinë e dialogut;
- në raste ku moskuptueshmëria e dialogut nga njëri prej bashkëbiseduesit është e tillë që e bën dialogun të pakuptueshëm;
- Në raste kur vijimi i dialogut nuk gjen një përmbyllje dhe zgjatet më tepër se sa koha e përcaktuar;

¹³⁹ Mezzadri M., (2002) Correzione degli errori, në In.it, N. 1 2/Fq. 4- 9 <https://docenti.unimc.it/gianluca.frenguelli/teaching/2022/25956/files/laboratorio-2-1/testo-mezzadri>

¹⁴⁰ Monami, E. (2013). Strategie di correzione orale dell'errore in classi di italiano L2., Guerra Edizioni, Perugia.

- Në raste kur akti i komunikimit vijon në një drejtim që del jashtë situatës fillestare të përcaktuar, pa një koherencë e logjike lidhëse ndërmjetëse.

Mësuesi në lidhje me korrigjimin mund të përdorë regjistrimin e akteve komunikuese të studentëve dhe të bëjë në një moment të dytë së bashku me nxënësit diskutimin në lidhje mbi problematikat e hasura dhe trajtimin e tyre së bashku duke reflektuar mbi arsyet e këtyre problematikave.

6. Konkluzione

Për sa më lart si përfundim mund të themi që komunikosh në gjuhë të huaj është një art i ndëllikuar që kërkon impenjimin maksimal si nga ana e mësuesit ashtu dhe nga ana e nxënësit. Është e rëndësishme që mësuesi të marrë në konsiderate të gjithë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e kësaj aftësie. Gjithashtu është e nevojshme që mësuesi të krijojë një klimë të favorshme produktiviteti në klasë të tillë që t'i mundësojë çdo nxënësi të kapërcejë barrierat psikologjike, gjuhësore dhe kulturore me qëllim prodhimin e komunikimit. Një rol të rëndësishëm padyshim luajnë materialet didaktike të nevojshme që nxisin e favorizojnë një prodhim të tillë, por padyshim aftësia e mësuesit për të krijuar situata komunikimi spontane duke shfrytëzuar çdo mundësi që ofrohet dhe duke u dhënë nxënësve mundësi që ata të krijojnë gjithashtu në mënyrë evente komunikimi që i do i ndihmojnë ata në të ardhmen në çdo kontekst të mundshëm.

BIBLIOGRAFIA

1. Balboni P.E., (2014) Didattica dell'italiano a stranieri, Bonacci, Roma.
2. Balboni, Paolo E. (2012). Le sfide di Babele. Insegnare le lingue nelle società complesse, Utet Università, Torino.
3. Bellack, A., Kliebard, H., Hyman, R., Smith, F. (1966). The Language of the Classroom. Teachers College Press, New York.
4. D'annunzio B., https://www.italy.it/sites/default/files/Filim_TECNICHE_DIDATTICHE.pdf
5. Gardner H., (2006), Multiple Intelligences: New Horizons in Theory and Practice. New Horizons.
[https://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:394:0010:0018:en:PDF#:~:text=The%20Reference%20Framework%20sets%20out,7\)%20Sense%20of%20initiative%20andhttps://www.edilingua.it/it-it/Flip.aspx?ElementID=b1dd8d1b-65bb-4a8d-8a03-bd1805733b62](https://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:394:0010:0018:en:PDF#:~:text=The%20Reference%20Framework%20sets%20out,7)%20Sense%20of%20initiative%20andhttps://www.edilingua.it/it-it/Flip.aspx?ElementID=b1dd8d1b-65bb-4a8d-8a03-bd1805733b62)

6. Iakob L., (1999), "Didactic communication" tek Cosmovici A., *Scolar Pscycology*, Iasi, Polirom.
7. Mariano L., Pozzo G., (2002), *Stili, strategie e strumenti nell'apprendimento linguistico*, La nuova Italia, Firenze.
8. Mezzadri M., (2002) *Correzione degli errori*, në *In.it*, N. 1 2/Fq. 4- 9
<https://docenti.unimc.it/gianluca.frenguelli/teaching/2022/25956/files/laboratorio-2-1/testo-mezzadri>
9. Mezzadri M., (2015), *I nuovi ferri del mestiere*, Bonacci editore, Torino, Italia, fq. 214- 220.
10. Monami E., (2021), *Correggere l'errore nelle classi di lingua L2*, Università per stranieri di Siena, Edilingua,
11. Monami, E. (2013). *Strategie di correzione orale dell'errore in classi di italiano L2.*, Guerra Edizioni, Perugia.
12. Official Journal of the European Union, (2006)
13. Popi F., *Interazione orale nelle classi L2* <https://digilander.libero.it/dibiasio.neoassunti/TEMATICA7/Favorire/interazione.pdf>
14. Richard J., Rodgers T.S., (2001), *Approaches and Methodologys in Language Teaching*, Cambridge University Press, London.
15. Seedhouse, P. (1995)., *L2 classroom transcripts: data in search of a methodology?* *TESL-EJ*, 1 (4), pp. 1-37.
- Torresan P., *Gestire l'errore*, (2011),
<file:///C:/Users/'m/Downloads/Dialnet-GestireLerroreELusoDellaLinguaMadreNellaClasseDiLi-4925270.pdf>
16. Ciliberti A., Margutti P., *Modulo 4. Interazione in classe e gestione delle dinamiche di gruppi multilingui e multiculturali*: http://venus.unive.it/italdue/80/mod_4_ciliberti.pdf

DR. VIOLETA SHABA & DR. ORGES SELMANI

DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE, FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA,
UNIVERSITETI I TIRANËS

violeta.shaba@unitir.edu.al & orges.selmani@unitir.edu.al

“DY SHPIRTRA NË NJË TRUP”

RASTI I ‘MIQVE TË RREMË’ NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHQIPE

ABSTRAKT

Kategoria leksikore e fjalëve të njohura si “miq të rremë” paraqet vështirësi dhe përbën burim gabimesh për përdoruesit e një gjuhe të huaj, pavarësisht nivelit gjuhësor. Këto çifte fjalësh, në dukje të njëjta apo shumë të ngjashme por të ndryshme në kuptim, krijohen vazhdimisht qoftë si fjalë të huazuara, qoftë si fjalë që kanë të njëjtën prejardhje por që me kalimin e kohës kanë ndryshuar kuptim. Kjo kumtesë trajton pikërisht këtë dukuri gjuhësore duke analizuar disa nga rastet më të përhapura të kësaj miqësie të rreme mes dy gjuhëve - angleze dhe shqipe, si dhe arsyet që motivojnë përdorimin e tyre në komunikim dhe përkthim. Bazuar në të dhënat nga të dyja gjuhët propozohet një listë me “miq të rremë” në të dyja gjuhët shoqëruar me gjegjësit e saktë në gjuhët përkatëse, angleze dhe shqipe.

Kumtesa hedh sadopak dritë mbi problemet gjuhësore në komunikim dhe përkthim që vijnë nga keqpërdorimi i këtyre njësive leksikore, çka çon në humbje të paqëllimshme të kuptimit të synuar dhe/ose keqkuptime të cilat mund të shmangen duke theksuar rëndësinë e ndërgegjësimit lidhur me këto çifte fjalësh të pranishme në gjuhën angleze dhe shqipe, si dhe vëmendjen që duhet t’i kushtohet togut leksikor ku bashkëpërdoren këto fjalë që ngrenë “kurthe” për përdoruesit e gjuhës së huaj.

Fjalë kyçe: *miq të rremë, ndikim, formë, kuptim, kurth, përkthim*

ABSTRACT

The category of words known as ‘false friends’ poses difficulty and constitutes a source of mistakes for the users of a foreign language, despite their language level. These word pairs identical or highly similar in form but different in meaning are constantly created as borrowings or words of the same origin but whose meaning diverged over the centuries. This paper explores this particular linguistic phenomenon and examines the most common cases of this false friendship between English and Albanian, as well as the reasons motivating their use when communicating or translating. Based on the data from both languages, a list of ‘false friends’ is compiled and their correct translations are shown alongside them.

The paper aims to provide insights into the linguistic and the communication/translation problems stemming from a misuse of these lexical items, which leads to involuntary loss of the meaning intended and/or misunderstandings which may be avoided if awareness is raised about the existence of these word pairs in English and Albanian and attention is paid to collocations in which these deceptive words that set traps for foreign language users appear.

Key words: *false friends, language interference, form, meaning, trap, translation*

Nxënësit që mësojnë një gjuhë të huaj, folësit e një gjuhe të huaj apo përkthyesit përballen me probleme të ndryshme që lindin nga dallimet që ekzistojnë mes gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj, dallime këto që lidhen me strukturat e tyre gramatikore, sintaksore dhe leksikore. Ndikimi i gjuhës amtare në gjuhën e huaj shërben për të shpjeguar shumë gabime që bëhen jo vetëm në fillimet e kompetencës gjuhësore të nxënësit por edhe në nivele më të larta të ligjërimit. Sipas një prej parimeve të të nxëniet ne i japim kuptim informacionit të ri që marrim apo ideve të reja duke i lidhur ato me njohuritë tona të mëparshme. Ekzistojnë dy lloj njohurish gjuhësore të mëparshme, të cilat nxënësit që mësojnë një gjuhë të huaj, por jo vetëm, mund t’i shfrytëzojnë në mënyrë që t’u japin kuptim fjalëve të reja që hasin; e para renditet njohja a njohuritë që kanë për gjuhën amtare dhe, e dyta, njohuritë që zotërojnë për gjuhën tjetër. Në rastin e parë flitet rëndom për “transferim” dhe në rastin e dytë për “përgjithësim.” (Handbook of Applied Linguistics, 2008). Një nga mënyrat për të kuptuar se ç’ ndodh në mendjen e nxënësit që po mëson një gjuhë të huaj është të shikosh jo vetëm format e sakta që prodhon, por edhe gabimet (shih Corder, 1967; James, 1998; Richards, 1974), analiza e të cilave hedh dritë mbi procesin e të nxëniet të gjuhës së huaj.

Një nga problemet që hasin folësit e një gjuhe amtare e cila nuk ndan shumë tipare me gjuhën e huaj, siç është rasti i gjuhës shqipe dhe asaj angleze, është

keqpërdorimi e një kategorie të veçantë leksikore të fjalëve të njohura si “miq të rremë”. Ky term u krijua nga Maxime Koessler dhe Jules Derocquigny në veprën e tyre të rëndësishme *Les faux amis, ou, Les trahisons du vocabulaire anglais: conseils aux traducteurs* [Miq të rremë, ose, Tradhtitë e fjalorit të gjuhës angleze: Këshilla për përkthyesit] (1928). Dukuria e “miqve të rremë” është një çështje e ndikimit gjuhësor. I referohet ekzistencës së dy fjalëve të dhëna në dy a më shumë gjuhë natyrale të cilat janë të njëjta apo shumë të ngjashme për nga mënyra si shkruhen dhe/ose shqiptohen e, megjithatë, kuptimet e tyre mund të jenë plotësisht apo pjesërisht të ndryshme, pra fjalë që kanë të njëjtën formë por ndryshojnë plotësisht apo pjesërisht sa i përket kuptimit. Përkufizimi që jep T. Hayward and A. Moulin në terma sosyrianë për problemin e miqve të rremë konsiderohet nga më të arsyeshmit dhe më të kuptueshmit:

“Në gjuhën amtare të nxënësit një *shenjues* i caktuar lidhet me një *të shenjuar* të caktuar. Në momentin që shfaqet *shenjuesi*, edhe në një kontekst të gjuhës së huaj, lidhja e sipërpërmendur është aq e fortë, sa përdoruesi automatikisht mendon të *shenjuarin* në gjuhën e tij amtare (*në tërësinë e tij*).” (cit. në *Semantics and Pragmatics of False Friends*, 2008).

Keqpërdorimi i këtyre çifteve të fjalëve vjen shumë natyrshëm pasi reagimi i parë i çdokujt ndaj një fjale të huaj që i ngjet një fjale në gjuhën e tij amtare, në të shkruar apo në të shqiptuar, është që të mendojë se kanë edhe kuptim të njëjtë. Këtë reagim e përforcon edhe më shumë fakti që ka shumë fjalë që ngjasojnë si në formë, ashtu edhe në kuptim – “miq të vërtetë” që sjellin gëzim kur vijnë. Çdo folës i gjuhës duhet ta shfrytëzojë këtë miqësi të mirë (*problem - problem, instinkt - instinct, distancë - distance, diplomaci- diplomacy, hotel- hotel, etj.*), pa harruar edhe shumë ‘miq të rremë’ që sjellin probleme. Këta të dytët i kemi ndarë në dy kategori të gjera:

1. ‘Miq të rremë’ që kanë të njëjtën rrënjë, por kanë marrë kuptime të ndryshme në shekuj (*aktualisht (shqip.) - actually (angl.)*), si dhe ata që ngjashmërinë e kanë krejt të rastësishme (miq të rremë të plotë).
2. ‘Miq të vërtetë’ me një ose më shumë kuptime të përbashkëta por ‘të rremë’ në kuptimet shtesë që nuk gjenden në gjuhën tjetër: *argument* (‘miq të rremë’ të pjesshëm).

Kjo dukuri gjuhësore, që i ngre kurthe jo vetëm nxënësve të gjuhës së huaj, por edhe përkthyesve jo të sprovuar, përbën burim gabimesh dhe ngatërresash për folësit vendas të të dyja gjuhëve. Është e vërtetë që pjesa më e madhe e nxënësve shqiptarë që mësojnë gjuhën angleze, pavarësisht nivelit të gjuhës që zotërojnë, i keqpërdorin këto çifte fjalësh. Këto fjalë të ngjashme apo thuajse të njëjta me forma fonologjike dhe morfologjike të ngjashme, por me kuptime që ndryshojnë

në shkallë të ndryshme bëjnë që shqiptarët të bien në kurth e të mendojnë se, meqë këto fjalë në gjuhën burimore dhe të synuar kanë të njëjtën formë, kanë edhe të njëjtin kuptim. Të bindur për kuptimin e fjalës në gjuhën shqipe, ata krijojnë një ndjesi të rreme sigurie që edhe termi gjegjës në gjuhën angleze ka ekzaktësisht të njëjtin kuptim si termi në gjuhën shqipe. Kështu, është e rëndësishme që kuptimi të sqarohet, të mësohet e të njihet në përdorim në mënyrë që “miqtë e rremë” të mos ngatërrohen me “miqtë e vërtetë”, pasi problemi qëndron në faktin që nxënësit nuk janë të vetëdijshëm për ekzistencën e tyre. Kështu, mësuesit duhet t’i paralajmërojnë nxënësit për këtë grackë që kurdiset vetvetiu dhe t’i ndërgegjësojnë lidhur me këtë rrezik që fshihet pas përdorimit të këtyre fjalëve në dukje njësoj.

Le të marrim si shembull e të analizojmë mbiemrin ngatërrestar *actual* dhe ndajfoljen *actually* në anglishte. Në gjuhën angleze kuptimi dhe përdorimi i tyre ka devijuar, duke rezultuar në ‘miq të rremë’ në shumë gjuhë evropiane (numërohen 14), ndër to edhe në shqipe. Në gjuhën angleze *actual* përdoret për të theksuar diçka që është e vërtetë apo ekziston në të vërtetë dhe nuk do të thotë *aktuale* si në shqipe a gjuhë të tjera evropiane. Ndajfolja *actually* është ndoshta edhe më problematike se mbiemri duke qenë se përdoret për të theksuar, kundërshtuar një informacion, apo për t’i shtuar informacion të ri asaj që sapo ke thënë, për të dhënë një mendim, ose për të nisur një bisedë të re në gjuhën angleze dhe nuk do të thotë *aktualisht* si në shqipe apo dhe shumë gjuhë të tjera. Në dallim nga shumë gjuhë evropiane, përfshirë edhe shqipen, fjalët *actual* dhe *actually* në gjuhën angleze nuk i referohen kohës. Problemi me këto fjalë qëndron në faktin që ato mund të shfaqen natyrshëm në një fjali e cila tingëllon e saktë, por kuptimi i synuar ose humbet, ose keqinterpretohet dhe, si rrjedhojë, fjala keqkuptohet. Mund të merret me mend se ç’ fjali formohet nëse një folës shqiptar i gjuhës angleze e formon fjalinë në bazë të bindjes së gabuar se fjala e ngjashme në gjuhën angleze është mik i besueshëm në një kohë që nuk është. Le ta ilustrojmë me një fjali të thjeshtë: ‘*Actually, I live alone*’. Kuptimi që përcjell kjo fjali është ndryshe nga kuptimi që ajo synon të përcjellë (*Aktualisht jetoj vetëm*) e që ka të bëjë me të jetuarit vetëm, të paktën për momentin, kuptim ky që ka humbur. Kuptimi i përcjellë është kundërshtimi i diçkaje që i është thënë më parë ose në momentin e komunikimit (*Faktikisht, jetoj vetëm*). Problemi me këtë fjali qëndron në faktin që gabime të tilla mund të kalojnë pa u vënë re, duke qenë se në këtë kontekst leksikor fjala *actually* shfaqet natyrshëm e qëndron mirë, pa ngritur dyshime që mund të ketë një gabim që rri fshehur. Gabimi nuk korrigjohet nëse bashkëbiseduesi nuk ka njohuri për gjuhën amtare të atij që e ndërtoi fjalinë.

Po kështu, nëse dikush, gjuha amtare e të cilit është gjuha angleze, e përshkruan dikë si *a sympathetic person*, tek një shqiptar kjo fjalë mund të vijë me kuptimin

‘good looking’ për shkak të ngjashmërisë në sipërfaqe me fjalën në shqipe ‘simpatik’ d.m.th., ‘i pashëm’ e jo në kuptimin që synohet të përcillet nga folësi që, në fakt, po përshkruan një person që tregohet i mirë me dikë që ka një problem sepse e kupton si ndihet.

Më poshtë kemi renditur fjalët më të përdorshme në gjuhën shqipe të cilat nuk kanë të njëjtin kuptim me fjalët me të njëjtën formë në gjuhën angleze. Lista padyshim që nuk është shteruese. Për më shumë kuptime dhe përkthime të tjera të mundshme referojuni zërit përkatës në fjalor.

Fjala ‘mike e rreme’ në gjuhën shqipe	Përkthimi në gjuhën angleze i fjalës shqipe	Fjala ‘mike e rreme’ në gjuhën angleze dhe kuptimi	Përkthimi në gjuhën shqipe i fjalës ‘mike të rreme’
aktual/e	<i>present, current, of current interest, topical</i>	actual	i/e vërtetë, reale etj.
aktualisht	<i>currently, at the moment, at the present time</i>	actually	faktikisht, në fakt
i/e edukuar	<i>polite, having good manners</i>	educated	i arsimuar, i shkolluar
librari	<i>a bookshop</i>	library	bibliotekë
simpati	<i>a liking for sb/sth</i>	sympathy	ndjenjë keqardhjeje
simpatik/e	<i>handsome, good-looking, nice, pleasant, likeable</i>	sympathetic	që ndjen keqardhje
fabrikë	<i>a factory</i>	fabric	cohë, pëlhurë
gjimnaz	<i>general high school</i>	gymnasium	palestër
shef	<i>a person in charge, head, chief, boss</i>	chef	kryekuzhinier
pretendoj	<i>claim</i>	pretend	shtirem
novelë	<i>a short-story</i>	novel	roman
motorist	<i>a mechanic</i>	motorist	shofer
magazinë	<i>a storehouse</i>	magazine	revistë
miting	political rally	meeting	takim, mbledhje
prezervativ	<i>a condom</i>	preservative	konservant
vagabond	an unprincipled person	vagabond	endacak

Tab.1 Fjalët në shqip të cilat nuk kanë të njëjtin kuptim me fjalët me të njëjtën formë në gjuhën angleze

Një nga arsyet pse ekzistojnë këta ‘miq të rremë’ është fakti që gjuha shqipe ndoshta i ka huazuar nga i njëjti burim si gjuha angleze, por shqipja ka mbajtur kuptimin fillestar. Kështu, *chef* është huazuar në gjuhën angleze nga ajo frënge me kuptimin më specifik *kryekuzhinier*, ndërkohë që është huazuar në shqipe si *shef* me kuptimin e *drejtuesit/udhëheqësit/kryetarit*, që ka qenë dhe vazhdon të jetë kuptimi i parë në gjuhën frënge. Kështu, *chef* është një ‘mik i rremë’ si në gjuhën angleze dhe frënge, ashtu edhe në gjuhën angleze e shqipe, por ‘mik i vërtetë’ në gjuhën frënge dhe shqipe. E njëjta gjë vlen edhe për fjalën *fabrikë*, që do të thotë *factory*, ashtu siç e ka kuptimin original në frëngjisht.

Disa fjalë në shqipe përkojnë me fjalë në anglishte në të gjitha kuptimet e tyre, por kjo mund të çojë në një ndjenjë të rreme sigurie, sepse ato mund të kenë edhe kuptime shtesë vetë që nuk përkojnë domosdoshmërisht dhe këto raste janë më të vështira për t’u pikasur. Kështu, ata që shfaqen si ‘miq të vërtetë’ kthehen në një burim të mundshëm ngatërrese. Këta miq të rremë e të vërtetë njëkohësisht janë të shumtë në anglishte dhe shqipe. Ka raste kur kuptimi i fjalës në gjuhën angleze është më i ngushtë apo më i gjerë sesa ai në shqipe, ose e kundërta. Fjala në shqipe *manifestoj* si folje *apo manifestim* si emër, për shembull, ka një kuptim më të gjerë sesa gjegjësi i saj në gjuhën angleze pasi nënkupton edhe *marshim nëpër rrugë për të shprehur përkrahje apo protestë kundër dikujt a diçkaje*, gjithashtu. Në tabelën e mëposhtme renditen fjalët në shqipe, gjegjësit e tyre në gjuhën angleze, si dhe kuptimet shtesë si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze. Lista, padyshim, nuk është shteruese. Për kuptime të tjera shtesë referojuni fjalorit.

Fjala në shqipe	Gjegjësi në gjuhën angleze	Kuptimet shtesë në gjuhën angleze ose shqipe
administroj	administer	Në gjuhën angleze: jap (dikujt mjekim/ilaç)
argument	argument	Në gjuhën angleze: mosmarrëveshje/ zënkë/ grindje
aksident	accident	Në gjuhën angleze: rastësi, diçka që ndodh pa planifikuar, pa dashje
abertoj	abort	Në gjuhën angleze: e lë në mes/e ndërpret një aktivitet sepse është e vështirë apo e pamundur t’i shkohet deri në fund
aksion	action	Në gjuhën angleze: veprime, masa
adresë	address	Në gjuhën angleze: një fjalim formal që e mban dikush para një grupi njerëzish
figurë	figure	Në gjuhën angleze: numër/shifër që përfaqëson një sasi, sidomos një numër zyrtar; një shumë e caktuar parash
familjar	familiar	Në gjuhën shqipe: që ka lidhje me familjen dhe jetën familjare; karakteristike e familjes; i/e martuar, me familje për të mbajtur, etj.

histori	history	Në gjuhën shqipe: tregim, përrallë
inteligjencë	intelligence	Në gjuhën angleze: informacion për veprimtaritë sekrete të qeverive të huaja, planet ushtarake të një armiku
kontroll	control	Në gjuhën shqipe: testim; vizitë te mjeku
konfidencë	confidence	Në gjuhën angleze: besim te vetja; ndjesia që diçka është e vërtetë
kamera	camera	Në gjuhën angleze: pajisje që shërben për të bërë foto
dramatic	dramatic	Në gjuhën shqipe: tragjike, që të shkakton vuajtje a dhembje shpirtërore
nerva	nerves	Në gjuhën angleze: nervozizëm; guxim Në gjuhën shqipe: zemërim, acarim
manifestoj	manifest	Në gjuhën shqipe: marr pjesë në manifestim/demonstratë, marshoj (në protestë)
officer	officer	Në gjuhën angleze: dikush me pozitë në një organizatë apo qeveri
provoj	prove	Në gjuhën shqipe: shikoj gjellën për kripë; provoj diçka për herë të parë; ha a pi diçka për herë të parë; përpiqem; përjetoj, etj.
patentë	patent	Në gjuhën shqipe: dokument zyrtar apo kartë ku thuhet se të lejohet me ligj të ngasësh makinën
perspective	perspective	Në gjuhën angleze: këndvështrim; aftësia për të menduar në mënyrë të arsyeshme për probleme a vendime pa i bërë të duken më të këqija apo më të rëndësishme se sa janë mënyrë e arsyeshme për të vlerësuar dhe krahasuar situatat në mënyrë që të mos mendosh që diçka është më e rëndë se ç' është në të vërtetë; Në gjuhën shqipe: e ardhmja e dikujt/ e diçkaje
popullor	popular	Në gjuhën angleze: që pëlqehet nga shumë njerëz Në gjuhën shqipe: që ka të bëjë a i përket popullit; i dashur për popullin; i thjeshtë; shumë i përhapur
partizan	partisan	Në gjuhën angleze: përkrahës i një partie politike
realizoj	realise	Në gjuhën angleze: kuptoj
simpatizoj	sympathise	Në gjuhën shqipe: pëlqej, dua dikë; Në gjuhën angleze: ndjej keqardhje për dikë, sepse ia kupton hallin;
virtual	virtual	Në gjuhën angleze: thuajse e njëjtë me gjënë që përmendet/ përshkruhet

Tab. 2 Fjalët shqip me gjegjës në anglisht

Vëmendje duhet t'i kushtohet edhe dallimeve në kombinueshmërinë leksikore të këtyre njësive leksikore në të dyja gjuhët. Nëse fjalët me të cilat kombinohen nuk janë të këmbyeshme në të dyja gjuhët, pra nëse konteksti leksikor ndryshon, atëherë kjo duhet të ngrejë alarmin që këto çifte fjalësh nuk janë miq të vërtetë.

Ta shohim këtë gjë të ilustruar tek disa fjalë në gjuhën angleze dhe shqipe:

actual: *number/ investment/exports/ëords/score/amount/in actual fact*

aktual: *temë/ problem/çështje/gjendje/ngjarje/rrethana/ kushte/rrezik*

Konteksti leksikor vlen edhe për fjalët me kuptime shtesë. Kuptimet shtesë bëhen të qarta kur përdoren në grupe leksikore specifike ku kuptimi i përbashkët nuk ka vend.

provoj: *gjellën/verën/këpucët/biçikletën/urinë
të bëj diçka*

Fjala *prove* nuk përdoret në këto kombinime fjalësh në gjuhën angleze duke qenë se nuk i ka këto kuptime që mbart fjala *provoj* në gjuhën shqipe.

familjar: *jetë familjare, detyrime (lidhje, marrëdhënie) familjare, çështje familjare, edukata familjare, rrethi familjar; njeri familjar, ngrohtësi familjare, mjedis familjar, me ton familjar. restorant familjar, mbrëmje familjare*

Fjala në gjuhën angleze *familiar* kombinohet me *sight, voice, face*, etj, por nuk formon tog a grup leksikor me fjalët më sipër pasi nuk i mbart ato kuptime.

PËRFUNDIME

'Miqtë e rremë' janë të pranishëm në gjuhën angleze e shqipe edhe pse këto dy gjuhë nuk lidhen "gjenetikisht". Kjo dukuri gjuhësore duhet sjellë në vëmendjen e nxënësve dhe përkthyesve pasi është shumë e lehtë të biesh pre e kurthit të tyre. Ato përbëjnë rrezik të fshehur sepse priremi të besojmë se ngjashmëria në formë nënkupton ngjashmëri edhe në kuptim. Ndërgjegjësimi për ekzistencën e këtyre 'miqve të rremë' është fillim i mbarë në shmangien e keqkuptimeve, shtrembërimeve të kuptimit të synuar apo përkthimeve të gabuara që vijnë nga përdorimi jo i saktë i këtyre njësive leksikore.

Mësuesit duhet të verifikojnë vazhdimisht nëse miqtë e rremë po përdoren a kuptohen saktë nga nxënësit, por edhe vetë individët e interesuar për përdorim të saktë të gjuhës nuk duhet ta marrin të mirëqenë kuptimin e fjalëve të ngjashme në formë por duhet t'i referohen tekstit dhe fjalorit për t'u siguruar që hamendësimi i tyre është i saktë.

Përveç kësaj, nxënësit duhet të ndërgjegjësohen edhe lidhur me rëndësinë që kanë togjet leksikore (konteksti leksikor). Nëse nxënësit, dhe jo vetëm ata, do t'u kushtonin vëmendje togjeve leksikore në të cilat përdoren fjalët në të dyja gjuhët, do të arrinin të kuptonin pa shumë vështirësi që këto çifte fjalësh nuk janë të këmbyeshme. Kështu, duhet theksuar se miqtë e rremë duhen mësuar në grupe leksikore në mënyrë që të shmangen ngatërresat në kuptim.

BIBLIOGRAFIA

1. Chamizo-Domínguez, P. J. (2008). *Semantics and pragmatics of false friends*. New York, NY: Routledge. (fq.2)
2. Corder, SP, 1967, *The significance of learner's errors*, International Review of Applied Linguistics
3. James, Carl, 1998, *Errors in Language Learning and Use: Exploring Error Analysis* (Applied Linguistics and Language Study), Harlow: Addison Wesley Longman
4. John Wiley & Sons, Apr 15, 2008, *Handbook of Applied Linguistics*, Blackwell Handbooks in Linguistics, Alan Davies, Catherine Elder (editors)
5. Hayward, T., & Moulin, A. (1983). False friends invigorated. In R. R. K. Hartmann (Ed.) *LEXeter '83 proceedings: International Conference on Lexicography at Exeter*. (pp. 190-198) Tübingen: Max Niemeyer. (cited by Chamizo-Dominguez, P.J. (2008) in *Semantics and pragmatics of false friends*)
6. Koessler, Maxime; Derocquigny, Jules, 1928, *Les faux amis, ou, Les trahisons du vocabulaire anglais: conseils aux traducteurs* (False friends, or, The treacheries of English Vocabulary: Advice to Translators)
7. Richards, Jack C, 1974, *Error Analysis: Perspectives on second language acquisition*, Essex, England: Longman

Fjalorët

1. *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, 2006, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë
2. *Longman Dictionary of Contemporary English* 6th Edition, 2014, Pearson Longman
3. *Oxford Advanced Learner's Dictionary* (online).

MA. ALBA BEQAJ

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA, DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE

alba_beqaj.doktorantfgjh@unitir.edu.al

**ROLI I HUAZIMEVE GREKE NË SPANJISHT DHE NË SHQIP,
NË MËSIMIN E GJUHËS SPANJOLLE TEK SHQIPTARËT**

ABSTRAKT

Në këtë studim synojmë të nxjerrim në pah vendin e huazimeve greke në gjuhën spanjolle dhe në shqipen, në drejtim të të nxënimit të spanjishtes si gjuhë e huaj tek shqiptarët. Pasi të kemi dhënë një pamje në sinkron të situatës aktuale të gjuhës spanjolle në Shqipëri, do ndalemi e do të veçojmë dukuritë dhe rastet e huazimeve nga greqishtja e lashtë, rëndësinë që kanë ato për shqipen dhe veçoritë që hasim gjatë didaktikës të gjuhës spanjolle. Do të nxjerrim në pah influencën e gjuhëve të lashta në veçanti e të greqishtes e cila ka ndikuar në rrafshin leksikor të gjuhëve në fjalë, e rrjedhimisht termat që hasim në shkencë, kulturë, letërsi dhe arti. Pas një prerje të shkurtër rreth historikut të gjuhës spanjolle kemi bërë edhe klasifikimin e fjalëve në disa fusha leksikore.

Në fund do të veçojmë rolin e huazimeve greke në didaktikën e spanjishtes në kuadër të njohurës dhe të panjohurës. Keto huazime janë pjesë e të njohurës siç është rasti i *fotografi dhe hidrologji* e cila bazuar në hipotezat e Krushen dhe Thomason lehtësojnë mësimin e gjuhës së huaj.

Key Word: *Huazim, spanjisht, gramatikë, leksikologji, glotodidaktikë, greqishte e lashtë.*

Hyrje

Elementet leksiko-gramatikore dhe prania e tyre nga një gjuhë në tjetrën përcaktojnë më së miri huazimet e njërës gjuhe tek gjuha tjetër. Dukuria e

huazimeve ka lindur gjatë një procesi të gjatë historik , kjo për shkak se gjuha nuk lidhet vetëm me një territor të caktuar, gjuha udhëton dhe së bashku me të shfaqen dhe procese të reja ku njerëzit duhet të huazojnë fjalë nga një vend në tjetrin. Studimi ynë i është përmbajtur më së shumti në klasifikimin e huazimeve dhe më konkretisht tek ajo kategori huazimesh që shpërfaqet në thelb e ndryshme nga ato të krijuara nga interferenca gjuhësore, siç mund të jenë, për shembull, rastet e gjuhës së brezit të parë apo brezit të dytë të emigrantëve, apo rastet e bilingualëve¹⁴¹.

Vetë fjala huazim në fjalorin e Gjuhës Shqipe e përcakton dukshëm si një term në gjuhësi; fjalë a strukturë e huazuar ¹⁴². Për gjuhëtarin Lazaro Carreter huazimi është; *“Element gjuhësor ose leksik ku zakonisht një gjuhë ja huazon një gjuhë tjetër, qoftë duke e përshtatur në formën e saj origjinale, apo duke e imituar ose duke e shndërruar atë. Huazimi është një huazim i inkorporuar në sistem ku mund të jetë edhe brenda së njëjtës gjuhë, kur një term i specializuar zhargon është inkorporuar në gjuhën e përgjithshme, ose anasjelltas.”*¹⁴³

Ndikimi i një gjuhë në botë është një proces aq natyral sa dhe i zakonshëm, është një fenomen që ndodh dhe në kultura të tjera. Historia faktori që çdo fjalë e huazuar ka pasur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjuhëve. Sikurse dhe spanjishtja është një ndër ato gjuhë të cilat kanë një rëndësi të madhe për sa i përket numrit të folëseve që e flasin atë si gjuhë amtare por dhe si një gjuhë e dytë. Instituti Cervantes përkufizon se :

*“Spanjishtja është një gjuhë globale që po përjeton një rritje të vazhdueshme konstante. Është ndër pesë gjuhët më të mira në botë për nga numri i folësve si për nga numri i vendeve ku është zyrtare por dhe nga shtrirja gjeografike. Është gjuha zyrtare e Kombeve të Bashkuara ku gati 24 milionë njerëz e studiojnë atë si gjuhë të huaj.”*¹⁴⁴


¹⁴¹ Uriel Weinreich, Languages in contact, Linguistic Circle of New York, New York 1953, f. 32-36.

¹⁴² <https://fjalorthi.com/huazim>

¹⁴³ file:///C:/Users/alba.beqaj/Downloads/El_prestamo_como_procedimiento_de_creaci.pdf fq 13

¹⁴⁴ https://www.cervantes.es/sobre_instituto_cervantes/prensa/2022/noticias/presentacion-anuario-2022.htm


Spanjishtja Gjuhë Globale



- Tabla de la lengua española en el mundo.

Fuente tomado de la pagina central España en el ONU ¹⁴⁵

Gjuha Spanjolle vijon nga latinishtja vulgare. Për ta qartësuar edhe me gjerë burimi kryesor për formimin e gjuhëve neolatine ose romane i takon përafërsisht shekullit IX të erës sonë, ku gjuha popullore latine ose latinishtja vulgare (Lingua Latina Vulgaris ose sermo quotidianus) janë formuar nga bashkimi i gjuhës së folur latine me dialektet vendase nën ndikimin e kushteve historike të caktuara.¹⁴⁶



- Tabla de las Lenguas Indoeuropeas

Fuente tomada de una pagina central de blog¹⁴⁷

¹⁴⁵ <https://twitter.com/SpainUN/status/988423354456604672/photo/1>

¹⁴⁶ Qirjaz Kosta, Gjuha Latine Pjesa teorike 1, Shtëpia botuese e librit Universitar Tiranë, 2003. fq13.

¹⁴⁷ Naranjo Amador Elena, Nuestro idioma “el castellano”, <http://carmenelena.over-blog.es/article-articulo-sin-titulo-102744003.html>

Edhe pse kjo gjuhë sipas klasifikimit të Linguistikës Moderne i përket grupit indereuropian, ka përvetësuar tipare të shumta nga kultura të ndryshme Influenta historike greko – latine kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në pasurimin leksik, gramatikor e gjuhësor të kësaj gjuhe.

Historia e kolonizatorëve grekë në rajonet jugore të Spanjës përgjatë viteve 1000 përpara Krishtit kanë lënë gjurmë të thella në pasurimin e kësaj gjuhe. Në Spanje shumica e rajoneve e flisnin greqishten e lashtë, krahas latinishtes që ishte një ndër ato gjuhë që kishte influencë greke dhe rrjedhimisht të dyja së bashku kanë pasur rolin e tyre gjuhësor, shkencor, kulturor por dhe gramatikor në spanjishten e sotme. Greqishtja ishte gjuha e përdorur për shkencën gjatë antikitetit klasik dhe pa dyshim vazhdoi të ishte e tillë edhe për shekujt më pas e madje vazhdon të jetë një shtyllë e pa lëkundur e leksikut sot e gjithë ditën.

Le të ndalemi fillimisht tek shpjegimi i fjalës helenizëm ose greqishtja e lartë. Sipas shpjegimit të etimologjisë, helenizëm është një term që i referohet kulturës greke. Ky term vjen nga gjuha greke që do të thotë të flasësh si një grek.¹⁴⁸ Si ka influencuar gjuha greke (helene) në spanjishten e sotme?

Gjuha e lashtë greke është origjina jo vetëm e shumë fjalëve spanjolle, por edhe e shumë parashtesave spanjolle. Konkretisht po japim disa aspekte të greqishtes të cilat kanë krijuar rrënjë gjatë gjithë historisë së gjuhëve por në veçanti dhe të spanjishtes. Janë të shumtë temat në të cilën kjo gjuhë ka ndikuar për shumë dekada, ndonëse është e rastit të theksohet që janë të paktë njerëz ato të cilët bëjnë diferencimin e një fjale apo origjinën e saj. Fokusi ynë i është drejtuar më së shumti termave tipike të një fjalori të zakonshëm komunikues, ai të cilin e hasim gjatë ditës ose në mësimin e një gjuhe të huaj të dytë. Gjuha ka influenza të jashtëzakonshme në kulturë, art, letërsi por dhe interferencat gjuhësore gjatë një ore mësimi janë të pashmangshme....

PRAPASHTESAT DHE PARASHTESAT

1. A-(gr. ἀ-), an-(gr. ἀν-, ante vocal): Është një parashtesë me konotacion negativ e cila përdoret shpesh në spanjisht. Përdoret për të ndryshuar kuptimin e fjalës. Shembujt të tillë mund të përmendim: Anamorfozis- anamorfozë në gjuhën greke -ἀναμόρφωσις *anamórphōsis* **«transformación», transformim.**

2. Para-(gr. παρα-): Para përdoret shpesh si parashtesë në formimin e disa kultizmave shkencore, me vlera të ndryshme: Paralelo – paralele në gjuhën latine - *parallēlus*, **në gjuhën greke - παράλληλος *parállēlos*.**

3.- ta-(gr. -της), -ita (gr. -ίτης), -ista (gr. -ιστής): -ita y –ista janë format e ndryshme të prapashtesave. Janë prapashtesa emërore dhe përdoren në parim për të shprehur

¹⁴⁸ Shih, Etimologia de HELENISMO <https://etimologias.dechile.net/?helenismo>

ku një person i cili kryen një veprimtari të caktuar: Hipócrita- hipokritik ne gjuhën latine - tardío hypocrita, në gjuhën greke- ὑποκριτής hypokrités.

4.ico (gr. -ικός): Prapashtesë mbiemërore e cila në përgjithësi formon mbiemra që rrjedhin nga emrat: -automático- automatik. Në gjuhën greke- αὐτόματος *autómatos*;

LEKSIKU

- 1 Fotografia: Është e përbërë nga fjala foto- De *foto-1* y -*grafia*. (gr. φωτο-) y -*grafia* (gr. -γραφία). Φωτο- rrjedh nga fjala φῶς, që do të thotë dritë ; -γραφία - γραφή.
- 2 Hidrología: Është fjalë e përbërë e formuar nga hidro- (gr. ὕδρο-) y -logía (gr. -λογία). Në gjuhën greke kjo fjalë vjen nga , ὕδρο- si dhe nga fjala νερό, që është gjithashtu ekuivalente me fjalën ujë në spanjisht; - λογία.

LETËRSIA

Marrim shkas dhe nga materiale të shumta letrare me gjini të ndryshme si historia, arti, kultura, aktualiteti i përditshëm, ku spikasim shumë fjalë të panjohura për studentin shqiptar. Gjatë leximit dhe hulumtimit të një sërë fjalësh të panjohura vumë re që disa prej tyre ishin të huazuara nga greqishtja dhe për këtë na ndihmoj RAE Real Academia Española e cila në përkthimin e tyre përcaktonte gjithashtu dhe origjinën e huazuar.

Format / gjinitë letrare si :

- Teatro-teatër në gjuhën latine- *theātrum*, në gjuhën greke -θέατρον *théatron*, **de** θεᾶσθαι *theâsthai*.
- Tragjedia –tragjedi *tragoedía*, në gjuhën greke - τραγωδία *tragōidía*.
- Komedia- komedi në gjuhën latine - *comoedía*, në gjuhën greke- κωμωδία *kōmōidía*.

HERMENEUTIKA

Kryesisht tekstet liturgjike të përshtatura deri diku për nivelin e studentëve:

- Obispo-peshkop ne gjuhën latine-tardío episcōpus, në gjuhën greke ἐπίσκοπος *epískopos*;

- Iglesia- Kishë. në gjuhën latine- *tardío ecclesiā*, në gjuhën greke -*ἐκκλησία* *ekklesiá*;
- Cristo- Krishti në gjuhën latine- *Christus*, në gjuhën greke- *Χριστός* *Christós*;

ARTI DHE MUZIKA

Terma të tjerë të cilët kanë influencuar në këtë gjuhë po i rendisim si me poshtë:
Në art, në veçanti në muzikë fjala ‘polifonia’ pra muzikë polifonike.

- polifonia – në gjuhën greke- *πολυφωνία* *polyphōnía* ‘variedad de tonos’.
- historia- në gjuhën latine- *historiā*, **në gjuhën greke *ἱστορία* *historía*.**

GJEOGRAFIA

- Evropa-(*gr.Εὐρώπη*): Emri i këtij kontinenti vjen edhe nga Mitologjia Greke. Në spanjisht ekzistojnë gjithashtu dhe disa shprehje që dhe në gjuhën shqipe kanë një përdorim me konotacion ngjyruës:
- La flecha de Cupido- shigjeta e Kupidit që vjen nga Mitologjia e Lashtë Greke ku shkurtimisht përmendim Kupidin djalin e Perëndeshës së dashurisë, Aferditës ku në mitologji ai përshkruhej si një fëmijë me krahë. Perëndesha i dhuroi një hark dhe dy lloje shigjetash ku njëra ishte prej ari dhe tjetra prej plumbi. Sot Kupidi përkufizohet si simboli i dashurisë.

KONKLUZIONE

Në këtë punim së pari i jemi referuar historikut të fjalës huazim, proceset në të cilat pëson ndryshime një gjuhë e huaj, më tej shpjeguar rëndësinë e gjuhës spanjolle si gjuhë e huaj duke e veçuar me tabela e dhe statistika. U thelluar në historikun e gjuhës spanjolle dhe folëm për influencën e gjuhës greke e latine sesi kanë ndikuar këto gjuhë në pasurimin e një tjetre. Shpjeguar përmbajtjen e helenizmit, si ekspozohet origjina kryesore e leksikut spanjoll, rëndësinë dhe kontributin që ka dhënë ndër dekada greqishtja e lashtë. Më tutje dhamë shembuj fjalësh dhe lokucionesh nga greqishtja e lashtë si dhe shpjeguar rëndësinë e tyre në nivel gjuhësor.

Nga sa më lart dalim në konkluzionin se huazimet spanjolle të shqipes herë dalin si të drejtpërdrejta e herë dalin si përcjellëse të elementeve dhe etimoneve greke. Ky korpus ka një rol jo të vogël në glododidaktikën e spanjishtes në përgjithësi dhe të studentëve njohës të greqishtes në veçanti. Ato janë fenerë orientues në rrugëtimin e gjatë e të bukur të mësimin të gjuhës së huaj.

BIBLIOGRAFIA

1. C. Battisti/G. Alessio, Dizionario etimologico italiano (DEI) Firenze, Barbèra, 1950-57
2. M. Cortelazzo/P. Zolli, Dizionario etimologico della lingua italiana (DELI). Zanichelli, 1979-88
3. G. Devoto, Avviamento alla etimologia italiana. Firenze, Le Monnier, 1967
4. B. Migliorini, Storia della lingua italiana. Firenze, Sansoni, 1960
5. G. B. Pellegrini, Gli arabismi nelle lingue neolatine con special riguardo all'Italia. Brescia, Paideia, 1972
6. G. B. Pellegrini, Ricerche sugli arabismi italiani con particolare riguardo alla Sicilia. Palermo, Centro Studi filologici e linguistici siciliani, 1989
7. C. Tagliavini, Le origini delle lingue neolatine. Bologna, Patron, 1982
8. Q.Kosta, Gjuha Latine Pjesa teorike 1, Shtëpia botuese e librit Universitar Tiranë, 2003
9. P. Zolli, Le parole straniere. Bologna, Zanichelli, 1991
10. M. Clyne, Community Languages, Cambridge University Press, Cambridge 1991

Literatura e shfrytëzuar

1. Diccionario didáctico interactivo griego-español: <http://www.dicciogriego.es/>
2. https://pure.mpg.de/rest/items/item_2282964/component/file_2282963/content
3. https://rua.ua.es/dspace/bitstream/10045/12767/8/L%C3%A9xico_de_la_ciencia_y_de_la_t%C3%A9cnica.pdf
4. Diccionario Manual Griego Clásico- Español http://www.epapontevedra.com/documentos/latinegrego/grego/Diccionario_vox_griego_clasico-esp.pdf
5. <https://es.scribd.com/document/422091582/Lenguas-Que-Influyeron-en-El-Espanol>
6. <https://tribusyurbes.öordpress.com/2012/11/10/un-espanol-muy-griego/>
7. <http://ww.vallenajerilla.com/glosas/gramaticapidal.htm>

PROF. AS. DR. MIRELA PAPA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA, UNIVERSITETI I TIRANËS
mirela.papa@unitir.edu.al

PËRKTHIMI I ELEMENTEVE KULTURORE NË LETËRSINË PËR FËMIJË

PËRMBLEDHJE

Përkthimi i letërsisë për fëmijë ka të njëjtat problematika si përkthimi i letërsisë për të rritur, ndonëse ka karakteristika të veçanta. Një ndër problemet kryesore ka të bëjë me përkthimin e elementëve kulturorë. Duke qenë se lexuesi i vogël nuk ka të njëjtën njohuri mbi kulturat e tjera si një lexues i rritur, përkthyesi duhet të vendosë nëse ta ndihmojë lexuesin e ri në vështirësitë e mundshme që krijon kultura e ndryshme nga e tija apo të nxisë tek lexuesi joshjen ndaj asaj që është e huaj.

Në këtë kumtesë kemi dashur të analizojmë përkthimin e elementëve kulturorë në disa vepra të letërsisë italiane për fëmijë të përkthyera në gjuhës shqipe.

Fjalët çelës: letërsi për fëmijë, përkthim, elemente kulturore

ABSTRACT

The translation of children's literature faces the same problems as the translation of adult's literature, although there are special characteristics. One of the main problems is the translation of cultural elements. Being that the young reader does not have the same understanding of other cultures like the adult reader, it's the translator's job to decide whether to help the young reader in difficulties he faces in different cultures or to encourage him on foreign elements.

In this study, we wanted to analyze the translation of cultural elements in some works of Italian literature for children translated in Albanian language.

Keywords: *children's literature, translation, cultural elements*

1. Elementet kulturore

Veçantitë kulturore manifestohen në nivelin leksikor të gjuhës, për shembull nëpërmjet pranisë së elementeve gjuhësore që u referohen elementeve të jetës së përditshme të folësve dhe kodifikohen në nivelin pragmatik të gjuhës, d.m.th në mënyrën se si gjuha përdoret nga folësit, në kontekst dhe në ndërveprim me folësit e tjerë.

Problemi i përkthimit të elementeve specifike të kulturës ka qenë gjithmonë një temë qendrore në historinë e *Translation Studies*. Leksiku i lidhur me një kulturë të caktuar, ose që i përket një bashkësie të caktuar gjuhësore, përmban fjalë dhe shprehje që përshkruajnë dukuri dhe objekte përfaqësuese të asaj kulture. Shpesh këto elemente kanë një “ngjyrë” lokale apo historike dhe në shumë raste u mungon një korrespondencë e saktë në gjuhën dhe kulturën tjetër. Strategjitë dhe procedurat e ndryshme që do të zbatohen për përkthimin e këtyre elementeve janë analizuar nga studiues të ndryshëm. Më poshtë shohim shkurtimisht zgjidhjet e ndryshme që ata kanë propozuar.

Vlahov e Florin

Dy gjuhëtarët bullgarë Vlahov dhe Florin ishin të parët që kryen një studim të thelluar të njëjësive leksikore që tregojnë objekte unike dhe dukuri karakteristike të një kulture ose të një bashkësie të caktuar gjuhësore. Sipas përkthyesit dhe studiuesit italian Bruno Osimo¹⁴⁹, ishin ata që futën termin *realia* për «fjalë që tregojnë gjëra materiale specifike të kulturës». Vlahov dhe Florin e përkufizojnë kështu termin *realia*.

[...] fjalë (dhe fraza të përbëra) të gjuhës popullore që përbëjnë emërtime sendesh, konceptesh, dukurish tipike të një mjedisi gjeografik, të një kulture, të jetës materiale ose të veçorive historiko-shoqërore të një populli, të një kombi, të një vendi, të një fisi dhe që, për këtë arsye, kanë një ngjyrim kombëtar, lokal apo historik; këto fjalë nuk kanë korrespondencë të saktë në gjuhët e tjera.

(përkthyer dhe cituar në Osimo 2011: 112)

Sipas këtyre studiuesve, *realia*-t mund të jenë të llojit *gjeografik*, *etnografik* ose *socio-politik*¹⁵⁰

Kategoria e parë, ajo e *realia*-ve *gjeografike*, përmban: objektet e gjeografisë

¹⁴⁹ Osimo B. (2011), *Manuale del traduttore*, Hoepli Editore, f. 112.

¹⁵⁰ Ibid.

fizike dhe meteorologjisë (*stepa, preri, tampa, fjordi, mistrali, tornado, cunami* etj.); emrat e objekteve gjeografike të lidhura me veprimtarinë njerëzore (*polder* etj.); emërtimet e specieve endemike: *kivi, koala, sekuoja, iguana e Galapados* etj.

Kategoria e dytë, *realia-t etnografike*, janë fjalë që nënkuptojnë koncepte të disiplinës që studion jetën e përditshme dhe kulturën e popujve, format e kulturës materiale dhe shpirtërore, zakonet, fenë, artin, folklorin etj. si për shembull: emërtime nga jeta e përditshme (*spagheti, kimono, sari*); puna (*brigadier, gaucho, consierge*); arti dhe kultura (*tarantella, blues, balalajka, tam tam, banjo; saga, Arlecchino*); objekte etnike (*bantu, kopto, Kozak, Bask, Cockney, Gringo, Gorilla, karioka*); njësi matëse dhe para (*këmbë, milje, hektar, rubla, dollarë, lira, dinar, peseta* etj.)

Kategoria e tretë e *realia-ve politike dhe sociale* përmban brenda saj: entet administrative territoriale (*guvernator, qark, krahinë, rreth*); organet dhe ofiqet (*duma, senati, dhoma, kongresi, giunta*); jeta shoqërore dhe politike (*peronistë, Ku Klux Klan, partizanë, lordë*); *realia* ushtarake (*legjion, admiral*)

Si t'i përkthejmë *realia-t*?

Në një tekst *realia-t* mund të transferohen në mënyra të ndryshme. Sipas Vlahov dhe Florin, mundësia e parë është të futet *realia* brenda tekstit të përkthyer (metatestit) duke përdorur transkriptimin, d.m.th., «përcjellja e tingujve të një gjuhe të huaj (zakonisht emër i përveçëm, emërtim gjeografik, term shkencor) duke përdorur shkronjat e alfabetit të kulturës marrëse.» Transkriptimi mund të kryhet germë pas germe, ose sipas rregullave të shqiptimit të kulturës marrëse¹⁵¹. Nëse fjala origjinale ka një alfabet të ndryshëm nga ai i kulturës marrëse, përkthyesi mund të përdorë transliteracionin, d.m.th. “përcjelljen e shkronjave të një fjale të huaj përmes shkronjave të alfabetit të kulturës marrëse”, për të ndihmuar lexuesin për të interpretuar mesazhin. Me transkriptim ose transliteracion, përkthyesi përpiket të ruajë elementin e huaj të tekstit origjinal. Ndërsa, me përkthimin, përkthyesi tenton “përvetësimin më të madh të elementit të huaj”. Vlahov dhe Florin sugjerojnë disa strategji për përkthimin. E para është krijimi i një neologjizmi ose një kalku në kulturën marrëse: “me material nga gjuha marrëse formohet një fjalë e thjeshtë ose e përbërë duke përkthyer fjalë për fjalë elementet e shprehjes së kulturës burimore”.

Mundësia e dytë për përkthimin e *realia-ve* është përkthimi i përafërt, që është strategjia më e përhapur, sipas Vlahovit dhe Florin (cituar nga Osimo). Përkthimi i përafërt i *realia-ve* ka nënllaje të ndryshme vëren Osimo, ndër të cilat i pari është zëvendësimi me “një shprehje të përgjithshme me kuptim më të gjerë”. Me

¹⁵¹ Id. Ibid.

përdorimin e një fjale ose shprehjeje më të përgjithshme, ngjyrimi lokal humbet¹⁵². Një shembull është “organizatë kriminale” për “*ndrangheta*”. Kjo strategji përshkruhet nga Osimo si “përdorim i parimit përkthimor të përgjithësimit”. Një nënloj tjetër i përkthimit të përafërt është dhënia e *realia*-ve të tekstit origjinal përmes shpjegimit ose përshkrimit.

Mundësia e tretë ose nënloji i përkthimit të përafërt, është zëvendësimi i fenomenit të kulturës burimore me një “homolog lokal”, pra me një *realia* të kulturës marrëse, për shembull *art nouveau* si një përkthim francez i “*Jugendstil*”¹⁵³. Osimo përmend edhe mundësinë e zëvendësimit me një “analog funksional”, strategji e cila parashikon zëvendësimin e *realia*-ve të kulturës burimore me një element tjetër të kulturës marrëse që ngjall një reagim të ngjashëm tek lexuesi që i përket kësaj të fundit. Një shembull i përdorimit të kësaj strategjie është zëvendësimi i një instrumenti muzikor që është pak i njohur, por shumë i përhapur në kulturën burimore me një instrument të mirënjohur në kulturën marrëse: “dhe kështu, për shembull, *mandolina* napolitane mund të bëhet *banjo* në far west (perëndimin e largët)” (Osimo 2014).

Përkthimi i elementeve kulturore në librat për fëmijë

Në përkthimin e letërsisë për fëmijë, vëmendja ndaj interesave dhe aftësive të lexuesit të vogël është një aspekt i rëndësishëm. Tradicionalisht, funksioni edukativ i letërsisë për fëmijë ka qenë mbizotërues dhe për këtë arsye tekstet për fëmijë përshtaten, ose rregullohen, sipas asaj që shkrimtarët dhe edukatorët besojnë se janë nevojat, interesat dhe përvojat e fëmijëve, lexuesve të vegjël. Një lloj përshtatjeje e përhapur në përkthimin e letërsisë për fëmijë është “purifikimi” (pastrimi), përmes të cilit modifikohen elementët që konsiderohen të papërshtatshëm për fëmijën, siç vërehet për shembull nga studiuesja Maria Nikolajeva¹⁵⁴.

Studiuesi suedez Göte Klingberg, i cili ishte një nga të parët që u angazhua në përkthimin e letërsisë për fëmijë, ka futur termin “cultural context adaptation” (përshtatje e kontekstit kulturor) për të përshkruar modifikimet që mund të aplikohen në tekstin burimor në përkthim, me vëmendje të veçantë për letërsinë për fëmijë. Klingberg identifikon disa elementë kulturorë që mund të mos jenë të njohur për lexuesit e rinj të tekstit të përkthyer: *referencat letrare; gjuhë të huaja në tekstin burimor; referenca për mitologjinë dhe besimet popullore; referime historike, fetare dhe politike; ndërtimi dhe mobilimi i shtëpisë, ushqimi; zakonet, traditat, lojërat; flora dhe fauna; emrat e përveçëm, titujt, emrat e kafshëve*

¹⁵² Osimo B., (2011), vep. cit. f. 113.

¹⁵³ Ibid. f. 114

¹⁵⁴ Nikolajeva, Maria (1996), Introduction to the Theory of Children’s Literature, Talinn Pedagogical University.

*shtëpiake, emrat e objekteve; emrat gjeografikë; pesha dhe masat*¹⁵⁵.

Për studiuesin Klingberg është e rëndësishme të ruhet e njëjta shkallë përshtatjeje e pranishme në tekstin origjinal edhe në përkthim. Kështu studiuesi propozon një sërë strategjish që përkthyesi mund të përdorë për të kryer përshtatjen e kontekstit kulturor¹⁵⁶:

- *Shpjegimi i shtuar*: elementi kulturor në tekstin burimor ruhet, por në tekst shtohet një shpjegim i shkurtër;
- *Riformulimi*: ajo që thotë teksti burimor është riformuluar pa përdorimin e elementit kulturor;
- *Përkthimi shpjegues*: funksioni i elementit kulturor shpjegohet pa përdorur emrin e huaj të elementit;
- *Shpjegimi jashtë tekstit*: shpjegimi i elementit kulturor sillet si shënim, parathënie ose diçka të ngjashme;
- *Zëvendësimi me një ekuivalent në kulturën e gjuhës marrëse*;
- *Zëvendësimi me një ekuivalent të përafërt në kulturën e gjuhës marrëse*;
- *Thjeshtimi*: në vend të konceptit specifik përdoret një koncept më i përgjithshëm;
- *Heqja*: fjalët, fjalitë, paragrafët ose kapitujt fshihen;
- *Lokalizimi*: i gjithë mjedisi kulturor i tekstit burimor është vendosur pranë me atë të lexuesve të tekstit të përkthyer.

Pavarësisht nevojës për të përshtatur tekstin për lexuesin fëmijë, është e rëndësishme, sipas Klingberg, të ruhen sa më shumë elementët e huaj të tekstit burimor. Për këtë qëllim mund të përdoren edhe strategjitë e riformulimit dhe përkthimit shpjegues, duke qenë edhe ato forma shpjegimi. Studiuesi shton se, megjithëse shpjegimi nuk është shumë i përshtatshëm për librat për fëmijë, një shpjegim i elementit problematik mund të shtohet jashtë tekstit, për shembull me një shënim në fund të faqes, në vend të një parathënie ose një shtojce¹⁵⁷. Për sa i përket strategjive të thjeshtimit, heqjes ose lokalizimit, Klingberg është i mendimit se ato nuk rekomandohen, si dhe zëvendësimi me elementë që i përkasin gjuhës marrëse. Teksti duhet të përshtatet sa më pak që të jetë e mundur për të lejuar lexuesin të mësojë për një kulturë tjetër. Qëllimi i përshtatjeve për Klingberg është të lehtësojë të kuptuarit ose ta bëjë tekstin më interesant për lexuesin e ri¹⁵⁸.

Dy strategji qendrore në shkencën e përkthimit, të cilat kryesisht kanë të bëjnë

¹⁵⁵ Klingberg, Göte (1986), *Children's Fiction in the Hands of the Translator*, Malmo: Liber/Gleerup, f. 17.

¹⁵⁶ Ibid, f. 18.

¹⁵⁷ Ibid, f. 19.

¹⁵⁸ Ibid, f. 12.

me shkallën e përshtatjes së tekstit me kulturën e synuar, janë strategjitë e *domestication* (përshtatjes) dhe të *foreignization* (tjetërsimit). Këto strategji janë veçanërisht të rëndësishme për letërsinë për fëmijë. Duke qenë se lexuesi i ri nuk ka të njëjtat njohuri për kulturat e tjera sa lexuesi i rritur, përkthyesi duhet të vendosë nëse do ta ndihmojë atë në vështirësitë e mundshme që paraqet kultura e ndryshme apo nëse do të nxisë te lexuesi joshjen për atë që është e huaj.

Një studim i elementeve specifike kulturore, është kryer edhe nga Javier Franco Aixelà, profesor dhe përkthyes spanjoll. Aixelà propozon klasifikimin e strategjive të mundshme për përkthimin e elementeve të veçanta kulturore, të cilat janë strategji të ngjashme me ato të Klingberg-ut, sipas shkallës së manipulimit ndërkulturor¹⁵⁹. Sipas Aixelà-së, *culture-specific items*, mund të ndahen në dy kategori kryesore: emrat e përveçëm dhe shprehjet e zakonshme.

2. Rast studimor i përkthimit të elementeve kulturore të letërsisë italiane për fëmijë

Për të realizuar një studim të përkthimit të elementeve kulturore të letërsisë për fëmijë kemi marrë në analizë përkthimin në gjuhën shqipe të kryeveprës për fëmijë *Le avventure di Pinocchio* dhe kemi parë përkthimin e këtyre elementeve në tri përkthime të ndryshme të kësaj vepre:

- Carlo Collodi, *Pinoku*, përkthyer nga Cuk Simoni, botuar nga Shtëpia Botuese Logos-A, Shkup 2022¹⁶⁰
- Carlo Collodi, *Pinoku*, përkthyer nga Robert Anastasi, botuar nga Shtëpia Botuese Extra, Tiranë 2010
- Carlo Collodi, *Pinoku*, përkthyer nga Orland Novaku, botuar nga Shtëpia Botuese Zambaku, Tiranë 2013

2.1. Emrat e përveçëm

Duke u bazuar në kriterin semantik (në funksion të mungesës apo të pranisë së përmbajtjes gjuhësore) Hermans-i (1988) dallon dy kategori të emrave të përveçëm sipas shkallës së “semantizimit”: *conventional names* (konvencionalë) dhe *loaded names* (shprehës). Emrat konvencionalë përbëhen nga fjalë të cilave u mungon ngarkesa semantike, domethënë, në përbërjen e tyre nuk ka aludim lidhur me natyrën e referentit. Emrat shprehës, përkundrazi, janë të semantizuar,

¹⁵⁹ Aixelà, J. F. (1996), Culture-Specific Items in Translation. In R. Alvarez, & C. A. Vidal (Eds.), Translation, Power, Subversion. Frankfurt: Multilingual matters, f. 60.

¹⁶⁰ Ndonëse është botim i vitit 2002, bëhet fjalë për përkthimin e parë të Pinokut, bërë nga Cuk Simoni, botuar në vitin 1935, variant i cili me ndryshime të vogla është botuar më pas edhe në vitin 1944 (Tiranë), 1959 (Tiranë), 1972 (Prishtinë) dhe 2002 (Shkup).

të pajisur me kuptim dhe/apo konotacione, dhe përfshijnë në formimin e tyre fjalë të cilat u përkasin kategorive me një ngarkesë semantike të përcaktuar. Për sa i përket mënyrës së përkthimit të emrave të përveçëm i jemi referuar listës së procedimeve të propozuara nga Franco Aixelá-ja¹⁶¹ që ky autor zbaton gjithashtu – me pak ndryshime – edhe për studimin e përkthimit të objekteve kulturore (Aixelá: 60-65).

Në bazë të shkallës së manipulimit kulturor (i madh apo i vogël) Franco Aixelá i ndan procedimet teknike në dy grupe të mëdha: ruajtje dhe zëvendësim, sipas faktit nëse përkthimi është i orientuar drejt polit të origjinës (përshtatje) apo drejt polit mbërritës (pranueshmëri).

Strategjitë përkthimore që mëtojnë ruajtjen janë: *Përsëritja*; *Përshtatja ortografike*; *Përkthimi gjuhësor*; *Glosa jashtëtekstuale*; *Glosa brendatekstuale*.

I përkasin kategorisë së zëvendësimit këto procedime: *Neutralizimi i kufizuar*; *Neutralizimi absolut*; *Natyralizimi*; *Përshtatja ideologjike*; *Heqja*; *Krijimi autonom*.

Për të realizuar një studim të përkthimit të emrave të përveçëm që dalin te *Le avventure di Pinocchio*, i kemi klasifikuar segmentet tekstuale të përzgjedhura në tri grupe të mëdha të bazuar në llojin e referentit që këta emra përfaqësojnë: antroponime (emrat e personave), toponime (emrat e vendeve), zoonime (emrat e kafshëve).

2.1.1. Antroponimet

Emrat e përveçëm dhe mbiemrat e personazheve të një veprë letrare kanë si funksion themelor të prezantojnë këta të fundit te lexuesi. *Le avventure di Pinocchio* nga pikëpamja e rrëfimit mbartin elemente fantastike dhe reale¹⁶². Në histori gërshetohen dhe shkrihen me natyrshmëri situata reale dhe fantastike dhe përshkohen nga personazhe shpesh të karakterizuar nga «emra që flasin» apo nga antroponime të thjeshta ose sipas traditës së përrallave nga emra të përgjithshëm të shndërruar në emra të përveçëm duke vënë germën e madhe, procedim ky që ndiqet sidomos në rastin e emrave të kafshëve. Përkthyesi ndodhet, pra, përballë një materiali onomastik të ndryshëm, që nga pikëpamja e përkthimit kërkojnë një trajtim të ndryshëm.

¹⁶¹ Franco Aixelá, Javier (2000), La traducción condicionada de los nombres propios (inglés-español). Análisis descriptivo, Salamanca, Ediciones Almar, f. 84-94.

¹⁶² Asor Rosa A. (1995) *Le Avventure di Pinocchio*. Storia di un burattino, në A. Asor Rosa (ed.), Letteratura italiana. Le Opere. III. Dall'Ottocento al Novecento, Torino 1995, f. 880

❖ Pinocchio

Richter¹⁶³ na kujton se në kohën e Collodit *pinocchio* ishte një emër i përgjithshëm, që rrjedh nga latinishtja *pinuculum*, që shënjonte farat e pishës. Collodi në përzgjedhjen e këtij emri natyrisht ka lidhur fjalën *pino* me *Pinocchio* dhe me këtë term të fundit ka dashur të sugjerojë një anë të parë të karakterit të kukullës që, siç thuhet të shprehjet populllore do të ishte *duro come una pigna* (i fortë si një bohçe pishë), domethënë paksa i vonuar në mendje, jo i zgjuar, i mbyllur.

Zgjedhja e përkthyesve shqiptarë është e njëjtë. [Pinoku] Emri përsëritet në gjuhën shqipe duke iu përshtatur rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Në këtë mënyrë natyrisht nuk përcillet synimi i autorit të veprës origjinale. Natyrisht si strategji është një qasje më moderne drejt kalimit nga teksti i nisjes tek ai mbërritës.

Personazhet e tjerë

Personazhet e tjerë i përkasin dy kategorive: emra të përveçëm të frymëzuar nga realiteti dhe emra të përveçëm të frymëzuar nga fantazia.

→ Personazhe realë:

❖ Mastro Geppetto

Geppetto është një ndryshim jo i zakonshëm i emrit Italian Giuseppe, më saktësisht të Geppe¹⁶⁴. Emri gjithashtu shoqërohet edhe nga ndajshtimi *maestro*, titull që i jepej në disa krahina italiane atij që praktikonte arte apo mjeshteri. Në kapitullin e dytë *Geppetto* tallet nga Mastro Antonio me nofkën *Polentina*, një emër me tingull toskan që aludon për ngjyrën e verdheme të parukes që përdorte zdrukthëtari. *Polentina* = (kaçamak) ëmbëlsirë me miell dhe shumë vezë sa merr ngjyrë të verdhë aq sa duket si e gatuar me miell misri.

(TP1) Simoni: – Gjepeti, Pulendër

(TP2) Anastasi: – Xhepetoja, Qullash

(TP3) Novaku: – Xhepeto, Qullash

Interesant është përkthimi i nofkës *Polentina*, fjalë e cila shenjon një gatim të përhapur në krahina të ndryshme të Shqipërisë dhe si rrjedhim ka variante të ndryshme në gjuhën shqipe sipas zonës ku gatuhet.

¹⁶³ Richter, Dieter (2002), *Pinocchio, o Il romanzo d'infanzia*, Romë, Edizioni di Storia e Letteratura, f. 54

¹⁶⁴ Pantaleoni D. (2014), *I nomi di Pinocchio in romeno*, <https://sciendo.com/article/10.2478/tran-2014-0055>

❖ Mastr'Antonio i quajtur i Ciliegia

Është një nofkë shprehëse që duhet përkthyer.

(TP1) Simoni: – mjeshtër Ndou, mjeshtër Qershia

(TP2) Anastasi: – usta Antonio, usta Qershia

(TP3) Novaku: – mjeshtër Antonio, mjeshtër Qershia

❖ Romeo i quajtur i Lucignolo

si chiamava di nome Romeo: ma tutti lo chiamavano col soprannome di Lucignolo, per via del suo personalino asciutto, secco e allampanato, tale e quale come il lucignolo nuovo di un lumino da notte.

(TP1) Simoni: ...i cili thirrej Rome, por gjithkush e quante Fitol, për punë të trupit të tij të hollë e të thatë. Kryekëput si një fitil bishtuku. (f. 123)

(TP2) Anastasi: ...që e kishte emrin Romeo; por të gjithë e thërrisnin me nofkën Stërhelli, për shkak të trupit të tij të dobët, të thatë e të gjatë, si fitil i ri i një feneri nate. (f. 129)

(TP3) Novaku: ...i cili në të vërtetë quhej Romeo, por të gjithë e thërrisnin me nofkën Fitili, për shkak të trupit të tij të thatë dhe të hollë, tamam si të ishte një fitil kandili. (f. 107)

Pantaleoni

Ashtu si në rastin e Mastr'Antonio edhe miku i Pinokut njihet më shumë me nofkën e tij në libër *lucignolo* = bishtuk, fitil sepse ishte i thatë dhe i stërgjatë si një bishtuk. Që në kohën e Collodit *lucignolo* mbartte kuptimin “person i gjatë dhe i dobët”

(TP1) Simoni: Fitili

(TP2) Anastasi: Stërhelli

(TP3) Novaku: Fitili

❖ Eugenio (Emër konvencional)

(TP1) Simoni: Eugen

(TP2) Anastasi: Euxhenio

(TP3) Novaku: Euxhenio

❖ l'ortolano Giangio

Është një formë tipike toscane që Fanfani¹⁶⁵ vë në dukje se rrjedh nga Angiolo (Angelo).

¹⁶⁵ Pietro Fanfani (1863), Vocabolario dell'uso toscano A-Z, Firenze, Barbera, f. 624

- (TP1) Simoni: Gjergji
- (TP2) Anastasi: kopshtari Xhanxho
- (TP3) Novaku: kopshtari Xhanxho

❖ Omino e il Direttore

Ashtu si edhe në rastin e kafshëve Collodi përdor emra të përgjithshëm si emra të përveçëm.

- (TP1) Simoni: burrin e rrumbullakët, Drejtori
- (TP2) Anastasi: shkurtabiqi, Drejtori
- (TP3) Novaku: burrin e shkurtër, Drejtori

→ Personazhe fantastikë

❖ Arlecchino, Pulcinella e Rosaura

Janë tre maskat e famshme të komedisë italiane.

- (TP1) Simoni: Arlekini, Pulçinela, Rozaura
- (TP2) Anastasi: Arlekinoja, Pulçinela, Rozaura
- (TP3) Novaku: Arlekinoja, Pulçinela, Rozaura

❖ Mangiafuoco

Struktura morfologjike e emrit folje+emër

- (TP1) Simoni: Zjarrngrënësi
- (TP2) Anastasi: Zjarrngrënësi, Zjarrvënësi
- (TP3) Novaku: Zjarrngrënësi

❖ La Fata dai capelli turchini

Collodi i jep këtij personazhi disa emërtime: *Fata dai capelli turchini*, *Fata*, *Fatina*, *Bambina dai capelli turchini*, *bella Bambina*, *Bambina*.

- (TP1) Simoni: Zana, Vajzë e bukur me flokë të kaltër,
- (TP2) Anastasi: Zana, Vogëlushja e bukur flokëkaltër, Zanëza
- (TP3) Novaku: Zana, Vogëlushe e bukur flokëkaltër

Drejtori i cirkut gjatë shfaqjes në të cilën Pinoku i shndërruar në gomar, kërcen, shpjegon se “grazie al sistema di Galles”.¹⁶⁶

¹⁶⁶ Bëhet fjalë sigurisht për një pjesë të errët edhe për lexuesin italian. Collodi dëshiron të bëjë një aludim duke ndryshuar në mënyrë ironike emrin e sistemit të Gall, apo teorinë e formuluar nga mjeku gjerman Franz Joseph Gall (1758-1828) sipas të cilit mund të përcaktosh sjelljet e dikujt

- (TP1) Simoni: duke ndjekur sistemin e Galles (f. 144)
- (TP2) Anastasi: duke ndjekur sistemin e Galtesit (f. 152)
- (TP3) Novaku: duke ndjekur modelin uellsian (f. 127)

Në përkthimet e antroponimeve vihet re se Cuk Simoni është ai i cili përpiqet të përshtasë në gjuhën shqipe emrat e personazheve duke gjetur në disa raste gjegjësin shqip të emrit të personazhit si në rastin e *ortolano Giangio (Gjergji)* apo *mastr'Antonio (mjeshtër Ndou)*. Duke qenë një përkthim, varianti origjinal i të cilit daton në vitin 1935, është e kuptueshme përpjekja e përkthyesit për t'i dhënë lexuesve të vegjël të një epoke aspak multikulturore si kjo e sotmja, një vepër, e cila të tingëllonte shqip sa më shumë të ishte e mundur, duke respektuar kështu kulturën marrëse (strategjia e pranueshmërisë). Përkthyesit e tjerë, duke qenë se kanë përkthyer në një epokë tërësisht të ndryshme nga ajo e Cuk Simonit, kanë ndjekur strategjinë e përshtatjes duke respektuar kulturën origjinale të veprës.

2.1.2. Toponimet

Në librin *Avventure di Pinocchio* nuk ekzistojnë qytete apo vende reale, por vetëm hapësira fantastike që shenjohen me emra toponimesh shprehëse që, teorikisht, nuk duhet të krijojnë probleme në përkthim.

❖ Il Paese dei Barbagianni

Barbagianni = *grabitqar nate*, por edhe *njeri budalla*

- (TP1) Simoni: Në qytetin Turulluqaj (f. 44)
- (TP2) Anastasi: Në qytetin e Kukuvajkave (f. 46)
- (TP3) Novaku: Në qytetin e Kukuvajkave (f. 38)

❖ Il Campo dei Miracoli

- (TP1) Simoni: Lëma e mrekuillive (f. 45)
- (TP2) Anastasi: Fusha e mrekuillive (f. 47)
- (TP3) Novaku: Fusha e mrekuillive (f. 39)

❖ La città di Acchiappa-citrulli

Acchiappacitrulli është një emër i formuar nga folje+emër

- (TP1) Simoni: Kurtha e Mendjeshpuarvet
- (TP2) Anastasi: Kap-Budallenjtë

(TP3) Novaku: Zër-Budallenjtë

❖ Il Paese dei balocchi

Edhe ky është një toponim i krijuar nga fantazia

(TP1) Simoni: Qyteti i lojnavë

(TP2) Anastasi: Qyteti i lodrave

(TP3) Novaku: Vendi i Lodrave

2.1.3. Zoonimet

Emrat e kafshëve kanë një status të dyshimtë, sepse Collodi duke ndjekur traditën e përrallave tenton t'i shkruajë gjithmonë me germë të madhe. **Të vetmit kafshë të cilët kanë një emër të përcaktuar janë 3 qen: qeni i Zanës, Medoro,** i quajtur edhe *Can-barbone*; *Alidoro* qeni që Pinoku e shpëton nga mbytja dhe *Melampo*, qeni roje i ngordhur që do të zëvendësohet nga kukulla. Këto zoonime të përdorura nga Collodi janë emra që kanë referime të qarta letrare. Medoro ishte këmbësori saraçen me të cilin dashurohet Angelica tek *Orlando furioso*; Alidoro është njëri nga protagonistët e *Amadigi di Gaula* të **Bernardo Tasso**; ndërsa **Melampo është një figurë e shquar e mitologjisë greke që del në shumë vepra letrare. Në përkthimin në gjuhën shqipe kemi përsëritje të zoonimit origjinal.**

(TP1) Simoni: Medor, Alidor, Melampi

(TP2) Anastasi: Medor, Alidor, Melampi

(TP3) Novaku: Medor, Alidor, Melampi

2.2. Shprehje të përgjithshme

Këto shprehje i kemi ndarë në dy nëngrupe: grupi i parë është i lidhur me *ushqimin*, ndërsa grupi i dytë me *lojërat fëmijore*.

2.2.1. Elemente kulturore që lidhen me ushqimin

❖ Allora prese una boccata di paglia tritata; ma in quel mentre che la masticava, si dovè accorgere che il sapore della paglia tritata non somigliava punto né al *risotto alla milanese*, né ai *maccheroni alla napoletana*. (XXXIII)

(TP1) Simoni: Atëherë shtiu në gojë pak kashtë të grimcuar, e në sapo e përçapte, iu mbush mendja se shija e kashtës nuk i përngjante kurrkund as pilafit, as makaronave të godita me domate. (f. 141)

(TP2) Anastasi: Atëherë mori një dorë kashtë të shkelur, por në kohën që e

përtypte, iu desh të kuptonte se shija e kashtës së shkelur s'afrohej fare as me pilafin milanez, as me makaronat napolitane. (f. 149)

(TP3) Novaku: Atëherë futi në gojë një kafshatë nga kashta e thatë, por ndërkohë që përtypte kashtën, e kuptoi se shija e kashtës nuk i ngjante fare as pilafit e as makaronave që hante në shtëpi. (f. 125)

Në këtë rast vëmë re se Simoni dhe Novaku pjetat karakteristike të kuzhinës italiane i japin me gjegjëset e tyre në kulturën shqiptare, ndërsa Anastasi duke vendosur krahas termit karakteristik të gjuhës shqipe edhe termin që tregon origjinën e këtyre pjetave, mundohet t'i bëjë të ditur lexuesit të vogël që bëhet fjalë gjithsesi për gatime të një kuzhine të ndryshme nga ajo shqiptare.

❖ [...] m'inghiotti come un tortellino di Bologna. (XXXV)

(TP1) Simoni: ... ngau vrap e më kapërdui si një kokërr fiku. (f. 156)

(TP2) Anastasi: ... më kapi pa çak pa bam, dhe më kullufiti sikur të isha një tortë Bolonje. (f. 166)

(TP3) Novaku: ... më kapi e më kullufiti si të isha një tortellini bolonjeze. (f. 139)

Në shembullin e mësipërm Sinmoni ruan krahasimin si figurë letrare, por ndryshon elementët e krahasueshëm. Në fakt përdor **kokërr fiku që është shumë më pranë fantazisë kulturore të lexuesit të vogël shqiptar. Anastasi dhe Novaku vendosin emrin e vendit (Bolonjë) për t'i dhënë të kuptojë lexuesit që bëhet fjalë për një element kulturor të huaj.**

2.2.2. Elemente kulturore që lidhen me lojërat

Janë shumë të përdorura nga Carlo Collodi edhe kulturemat që i referohen lojërave të fëmijëve. Në kapitullin XXXI përshkruhet se si jetonin fëmijët në Vendin e Lojërave dhe përmenden disa nga lojërat.

❖ [...] Branchi di monelli da per tutto: chi giocava alle *noci*, chi alle *piastrelle*, chi alla *palla*, chi andava in *velocipede*, chi sopra un *cavallino di legno*, questi facevano a *mosca-cieca*, quegli altri si *rincorrevano*, altri, vestiti da pagliacci, mangiavano la stoppa accesa; [...] (XXXI)

(TP1) Simoni: Gjithkrah shiheshin grumbuj fëmijësh: kush lozte arrash, kush rrasash, kush topash, kush ecte në biçikletë, kush mbi një kalë druri, këta luanin macja-mini; ata mirrnin mbrapa shoqishojnë; të tjerë veshur si surretën, shtinin

në gojë pambuk të ndezuar... (f. 131)

(TP2) Anastasi: Shikoje gjithandej grupe çamarrokësh: njëri luante me arra, njëri me rrasa, njëri me top, njëri kalonte me biçikletë, njëri mbi një kalush pej druri: një palë luanin syllambyllthi, ata të tjerët ndiqnin njëri-tjetrin: të tjerë akoma, të veshur si lolo, hanin shtupë të ndezur... (f. 139)

(TP3) Novaku: Tufa fëmijësh bredharakë shiheshin ngado. Dikush luante me arra, dikush me peta, disa të tjerë me top, ca hipnin mbi triçikle, ca të tjerë kishin nga një kalë prej druri, disa luanin kukafshehtas, të tjerë përpiqeshin për të kapur njëri-tjetrin, ndërsa disa të tjerëve të veshur si palace, fushnin në gojë zjarrin e ndezur ... (f. 115)

Në rastin e lojërave për fëmijë duhet të themi që strategjia e ndjekur nga përkthyesit është e njëjtë. Të gjithë janë përpjekur të gjejnë gjegjësin e këtyre lojërave në gjuhën shqipe.

Në shembullin që vijon kemi të dyja fushat semantike bashkë: dalin referime për ëmbëlsira, pije dhe lojëra.

- ❖ [...] Vorrei avere un bel palazzo, mille *cavallini di legno* e mille *scuderie* per potermi baloccare, una cantina di *rosoli* e di *alchermes* e una libreria tutta piena di *canditi*, di *torte*, di *panettoni*, di *mandorlati* e di *cialdoni con la panna*” (XIX)

(TP1) Simoni: Kisha për të dashtë një pallat të bukur, një mijë kuaj të vegjël druri ndër një mijë kulla për t’u argëtuar me ta, një bodrum me shirupë gjithfarësh, e një raft librash mbushur me dardha sheqeri, torta, fugace, hallvë me bajame, biskota me ajkë... (f. 72)

(TP2) Anastasi: Do të doja të kisha një pallat të bukur, njëmijë kuaj prej druri dhe njëmijë stalla, që të mund të dëfreja, një qilar me shurupe e me likerna, një raft plot me fruta të sheqerosura, torta, bajame e revani me kajmak. (f. 74)

(TP3) Novaku: Do doja të kisha një pallat të bukur, mijëra kuaj të drunjtë e mijëra karroca për t’u dëfryer, një kantinë me gjithfarë pijesh të ëmbla, një dhomë plot e përplot me sheqerna, torta, kekë, ëmbëlsira të bajamta e me franxholla të ngrohta valë. (f. 61)

Edhe në këtë rast strategjia e ndjekur nga përkthyesit është e njëjtë, pranueshmëria. Pra, respektimi i kulturës marrëse kundrejt asaj të origjinës. Në fakt mundohen të japin me gjegjësit në gjuhën shqipe si lojërat, ashtu edhe emrat e pijeve apo ëmbëlsirave duke bërë të humbasë kështu identiteti kulturor i tekstit origjinal.

2.2.3. Kulturema të tjera i përkasin fushave të ndryshme semantike

- ❖ I pari është *carabinieri* term që përsëritet disa herë gjatë rrëfimit.

TO: [...] quando sentì a un tratto un rumore sordo di passi che si avvicinavano.

Si voltò: erano due *carabinieri*. (XXVII)

(TP1) Simoni: ...kur dëgjoi se dikush po afrohej. U kthye e pa dy gjindarmë që ishin nisur fill e kah ai. (f. 108)

(TP2) Anastasi: ...kur befas dëgjoi një zhurmë të shurdhët hapash që afroheshin. U kthye: ishin dy karabierë. (f. 111)

(TP3) Novaku: ...kur dëgjoi ca zhurma hapash që afroheshin. Ktheu kokën dhe pa se ishin dy policë. (f. 91)

Në rastin e këtij elementi kulturor duhet thënë se Simoni dhe Novaku japin ekuivalentin në kulturën shqiptare (në varësi të epokës në të cilën është bërë përkthimi) të termit *carabinieri*, ndërsa Anastasi traskripton fjalën e gjuhës italiane duke i bërë të ditur lexuesit të vogël që bëhet fjalë për një term të huaj. Nga konteksti kuptohet që *carabinieri* nuk është gjë tjetër veçse *policì italian*.

- ❖ Në kapitullin XVI ndeshemi me një lloj vallëzimi tradicional toskan.

TO: [...] la bella Bambina dai capelli turchini si affacciò daccapo alla finestra, e impietositasi alla vista di quell'infelice che, sospeso per il collo, ballava il *trescone*¹⁶⁷ alle ventate di tramontana, batté per tre volte le mani insieme e fece dei piccoli colpi.

(TP1) Simoni: Vajza e bukur me flokë të kaltër doli prapë në dritare, e duke parë atë rrezikzi pezull me litar në fyt që po hidhej e përdridhej si është më zi nga murrani, pati dhimbë për të, rrahu shuplakat e dha tri krisma te lehta. (f. 58)

(TP2) Anastasi: Vogëlushja e bukur flokëkaltër doli sërish në dritare, dhe, duke i ardhur keq kur pa atë fatgjorë që, i varur për qafe, hidhej sa andej-këtej në erën e furishme të dimrit, rrahu pëllëmbët tri herë lehtë. (f. 59)

(TP3) Novaku: vogëlushja e bukur flokëkaltër u shfaq rishtas në dritare, dhe duke iu dhimbsur gjendja e atij të pafati, që i lidhur për qafe tundej e vërtitej nga erërat e perëndimit, përplasi tri herë duart, e ato përplasje u pasuan nga tri zhurmë të vogla goditjesh. (f. 49)

Ky lloj vallëzimi është karakteristikë e një krahine të caktuar në Itali dhe është e

¹⁶⁷ *trescone*: [tre-scó-ne] s.m. (pl. -ni) vallëzim që karakterizohet nga lëvizje të gjalla, kërcëhet në çift dhe me shkëmbim të vajzës.

kuptueshme që në gjuhën shqipe nuk gjendet dot një term ekuivalent. Zgjedhja që përkthyesit kanë bërë është eliminimi i kësaj kultureme dhe zëvendësimi me folje të sferës semantike të të kërcyerit.

❖ E quanto si spende per entrare? — Quattro soldi¹⁶⁸.

(TP1) Simoni: - E sa bën të hyjë? – Katër pare. (f. 33)

(TP1) Anastasi: Sa duhet për të hyrë? – Katër soldë. (f. 34)

(TP1) Novaku: Sa paguhet për hyrjen? – Katër monedha. (f. 28)

❖ Quanto vuoi di codesto ciuchino zoppo?

— Venti lire.

— Io ti do venti soldi. (XXXIII)

(TP1) Simoni:- Sa atë gomuç të shqepët?

- Njëqind solda.

- A bën dhjetë solda? (f. 146)

(TP2) Anastasi: - Sa kërkon për këtë kërric çalaman?

- Njëzet lira.

- Unë të jap njëzet soldë. (f. 154)

(TP3) Novaku: - Sa para kërkon për këtë kërricin e çalë?

- Njëzet lireta.

- Unë po të jap njëzet groshë. (f. 129)

Në rastin e monedhave duhet thënë se asnjë nga përkthimet nuk arrin të japë të qartë për lexuesit e vegjël shumën e parave për të cilat bëhet fjalë, por vështirësia qëndron edhe për lexuesin e sotshëm të tekstit origjinal, si pasojë e largësisë kohore mes periudhës në të cilën është shkruar libri dhe kohës sonë, pasi në qarkullim kanë qenë dhe janë monedha të ndryshme.

❖ Intanto s'era levato un vento impetuoso di tramontana¹⁶⁹ (XV)

(TP1) Simoni: Në këtë kohë ishte pas çuar një murra i fortë... (f. 57)

(TP1) Anastasi: Ndërkohë kishte filluar të frynte një murrilan i vrullshëm... (f. 58)

¹⁶⁸ Soldo është emërtimi i një monedhe argjendi italiane të prerë për herë të parë në fund të shekullit XII. Me reformën monetare të ndërmarrë nga Napoleoni soldi u bë i barabartë me 5 cent dhe 20 soldë bënin një lirë. Në Shqipëri deri në 1912 përdorej lira turke. Pas pavarësisë kemi para, grosh (njësi më e vogël e lirës turke) dhe lira italiane, franga argjenti etj.

¹⁶⁹ Tramontana është erë lokale. Fryn kryesisht nga veriu në drejtim të detit Adriatik dhe sidomos gjatë periudhës së dimrit, por mund të fryjë edhe gjatë verës.

(TP1) Novaku: Nërkaq kishte filluar një erë e furishme nga perëndimi (f. 47)

Për erën *tramontana* Simoni dhe Anastasi kanë dhënë ekuivalentin e kësaj ere në gjuhën shqipe, ndërsa Novaku bën shpjegimin semantik.

Përfundime

Kur përkthehet për një publik fëmijësh duhen mbajtur parasysh se po përkthehet për fëmijët, pra, të mos harrohen kufizimet e tyre kuptimore. Një ndër problemet kryesore me të cilat ndeshet përkthyesi ka të bëjë me përkthimin e elementeve kulturore. Sot flitet për konceptin e *multikulturalitetit*. Vetë zhvillimet e kohës sonë kanë bërë të mundur që shumë kultura të jenë tashmë në kontakt me njëra-tjetrën dhe njohja reciproke e tyre është shumë më e madhe se ç' ishte në të shkuarën. Prandaj është detyrë e përkthyesit që në këtë epokë globalizimi të ndërhyjë me strategjitë e pranueshmërisë së tekstit (duke respektuar kulturën marrëse) vetëm në rastet kur është e nevojshme dhe të ndjekë strategjitë përkthimore të përshtatjes (që respektojnë dhe përcjellin në tekstin e përkthyer elementet kulturore të tekstit origjinal) si një formë respekti ndaj kulturës së origjinës dhe multikulturalitetit duke shfrytëzuar kështu përkthimin si një urë mes fëmijëve dhe kulturave të ndryshme. Teksti origjinal, pra, duhet të përshtatet sa më pak që të jetë e mundur për të lejuar lexuesin të mësojë për një kulturë tjetër.

BIBLIOGRAFIA

1. AIXELÀ, J. F. (1996). Culture-Specific Items in Translation. In R. Alvarez, & C. A. Vidal (Eds.), *Translation, Power, Subversion*. Frankfurt: Multilingual matters.
2. AIXELÁ, J. F. (2000), *La traducción condicionada de los nombres propios (inglés-español). Análisis descriptivo*, Salamanca, Ediciones Almar.
3. ASOR ROSA, A. (1995) *Le Avventure di Pinocchio. Storia di un burattino*, në A. Asor Rosa (ed.), *Letteratura italiana. Le Opere. III. Dall'Ottocento al Novecento*, Torino 1995, f. 879-950
4. COLLODI Carlo, *Pinoku*, përkthyer nga Cuk Simoni, botuar nga Shtëpia Botuese Logos-A, Shkup 2022
5. COLLODI Carlo, *Pinoku*, përkthyer nga Robert Anastasi, botuar nga Shtëpia Botuese Extra, Tiranë 2010
6. COLLODI Carlo, *Pinoku*, përkthyer nga Orland Novaku, botuar nga Shtëpia Botuese Zambaku, Tiranë 2013

7. FANFANI PIETRO (1863), *Vocabolario dell'uso toscano A-Z*, Firenze, Barbera
8. KLINGBERG, GÖTE (1986), *Children's Fiction in the Hands of the Translator*, Malmo: Liber/Gleerup.
9. NIKOLAJEVA MARIA (1996), *Introduction to the Theory of Children's Literature*, Talinn Pedagogical University.
10. PANTALEONI Daniele (2014), *I nomi di Pinocchio in romeno*, <https://sciendo.com/article/10.2478/tran-2014-0055>, (konsultimi i fundit më 10.12.2023)
11. OITTINEN, R. (2000), *Translating for Children*, New York and London: Garland Publishing.
12. OSIMO B. (2011), *Manuale del traduttore*, Hoepli Editore.
13. RICHTER, DIETER (1980), *Contenuti sociali delle fantasie fiabesche nel corso del mutamento storico*, në *Tutto è fiaba*, Aktet e konferencës ndërkombëtare mbi përrallën, botuar nga Giorgio Cusatelli, Alberto Mario Cirese dhe Enrica Delitala, 227-238. Milano: Botimet Emme.
14. RICHTER, DIETER (2002), *Pinocchio, o Il romanzo d'infanzia*, Romë, Edizioni di Storia e Letteratura.

Universiteti i Tiranës. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Përkthimi dhe komunikimi, sfidat dhe përparësitë
në rrafshin ndërkombëtar : konferencë shkencore
ndërkombëtare : 28 prill 2023 : aktet e konferencës /
Universiteti i Tiranës. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.
- Tiranë : Ani Print, 2024.

174 f. ; 17,6 x 25 cm.

ISBN 9789928478054

1.Letërsia evropiane

2.Përkthime

3.Konferenca

81 '25 (062)

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

PËRKTHIMI DHE KOMUNIKIMI
SFIDAT DHE PËRPARËSITË NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR

AKTET E KONFERENCËS
28 PRILL 2023, FGJH, UT